

TEODOR LACQO

854-32
L14

një natë shiu

TREGIME

891. P83-32

S B.

L 14

TEODOR LAÇO

NJË NATË SHIU

(Tregime)

1893.

~~SOFO~~ ✓ 7

MËSUESI I VJETËR I HISTORISË

Në një mbrëmje vjeshte, mësuesi i vjetër i historisë, i strukur nën çadër, hyri në një rrugicë të errët. Mbi çadër murmuronte si i përgjumur një shi i vakët dhe pikë tinzare i spërkatnin pardesynë e gjatë, ngjyrë hiri, të vjetruar nga përdorimi i gjatë, po prapë të paraqitshme si çdo rrobë prej stofi të mirë, që, sipas mendimit të tij, nuk vjetërohej kurrë. Nën sqetull shtrëngonte një send të mbështjellë me dy gazeta dhe, nga mënyra se si i mbështillte gjithënjë një cep, ku gaza ta ishte grisur, kuptohej se nuk i pëlqente që ta hettonin sy kureshtarë.

Qëndroi para një porte dhe shtypi butonin e ziles. Era fishkëlliu nëpër fletët e rralla të kajsisë. Hesh-tja iu duk e gjatë. Ai u shqetësua. I ra ndër mend se një zile mund të prishet kurdoherë dhe e mira ishte të trokiste me grusht, por në heshtje portën e hapi befas i zoti i shtëpisë, një njeri i gjatë, me syze, me një vështrim të hutuar. Posa e njoihu mësuesin, sytë e vegjël nën xhamat lëvizën e shndritën nga kënaqësia.

— O! Ç'ëre e mbarë ju pruri, zoti profesor? Ur-dhëroni!... — Ai kishte vjete që nuk kishte shkelur në atë shtëpi dhe këtë herë iu duk e rehatshme, e mirë, si për të pleqëruar. Nga gjithë rrobaqepësit e qytetit ai çmonte më shumë usta Vasilin. Dikur Vasili kishte rrobaqepësinë «Elegant» në një rrugë kryesore dhe mbante revista mode si asnje tjetër. Mësuesi, ahere fare i ri, nuk e dinte as vetë se kë vlerësonte më shu-



më: usta Vasilin apo burrat elegantë, që i buzëqeshnin nga xhamet, ku ishin ngjitur. Po! Ishte i ri ahere!

Më vonë, kur u krijua kooperativa, Vasili vazhdoi të qepëtë në shtëpi për klientët e vjetër. Mirëpo tashmë kishte vjete që kontrolli i financës për ata që qepnin pa lejë, jashtë orarit, ishte i fortë, prandaj ai s'guxonte më të shkelte në shtëpinë e Vasilit. Por, sot... hm... sot, ishte fjala për një pallto «guben», për diçka të rëndë, të vlefshme! Zgjodhi këtë mbrëmje të errët vjeshte me shi, e mbështolli me kujdes stofin dhe guxoi të trokasë në shtëpinë e Vasilit.

— Mirë se urdhëruat, uluni...! — pëshpériste i zoti i shtëpisë, duke i treguar një kolktuk të veshur lule-lule dhe duke shikuar me bishin e syrit sendin e mbështjellë në gazetë, nga cepi i grisur i së cilës dukej stofi i errët.

— U bënë kaq vjet që nuk keni ardhur — tha me keqardhje rrobaqepësi.

— Po! — pshëretiu mësuesi. — Na ndau puna, Vasil. Na u rrithën fëmija, na u shtuan dhe telashet!

— U shtuan! — përsëriti si jehonë Vasili. — Lëre, mos e pyet se ç'telashe kanë fëmijët e rritur.

Në dhomë hyri me zhurmë gruaja e Vasilit, e shëndoshë dhe e trashë, aq sa plotësonë me tul edhe brinjët e gollganët e dukshëm të të shoqit. Dhoma ishte kredhur në hije të turbullta nga drita e dobët e një llambe të vogël, nën një llampadar të bukur mbi komo.

— Pse nuk e ndez dritën, Vasil? — tha gruaja dhe hapi me forcë çelësin. Që lart, nga tavani, u derdh një dritë e bardhë nën tre poça të një llampadarin të shtrenjtë dhe gruaja picërrroi sytë e kënaqur. Mirëpo mësuesi nuk e vuri re fare llampadarin dhe kjo e mërziti fort gruan. Por... mendoi se burrat janë të gjithë kështu, njëlloj, të pavëmendshëm kundrejt sendeve të bukura dhe ja nisi pyetjeve të rëndomta për shëndetin e përfamiljen e mësuesit, me rrënë e me degë, e qerasi me bombone e me konjak dhe u largua për kafetë! Ata të dy s'kishin më gjë për të thënë. Mësuesi i historisë

u kujtua se kishte shtatë vjet që s'kishte ardhur këtu. Bile edhe usta Vasilin rrallëherë e kishte vënë re në gjithë atë turmë të madhe të qytetit. Secili kishte shqérinë e vet. Mësuesi ishte njeri i qetë, pak i mbyllur, në shtëpi kishte një kopsht të vogël, një pjergull, katër rrënje kajsi në oborr dhe katër pula Lehgorn. Nuk ja kishte ënda të kalonte kohën kafeneve, veçse kur e zinte belaja me kolegët e vet më të rinx zhurmëmëdhenj, disa prej të cilëve i kishte pasur nxënës, që e kthenin në barin e «Turizmit» kundrejt shkollës së tyre.

Në dhomë midis dy të njohurve të vjetër mbeti si perde, po ajo heshtje. Heshtja dhe ndrojtja, që lind pas largimit me vjete midis njerëzve, kush e di sepse dhe që tregon se miqësia ka qenë e rastit, shterpë.

«Nuk është mirë kështu», mendoi mësuesi i vjetër të cilit i rëndonte më shumë kjo heshtje. «Njeriu s'duhet të harrojë miqtë kështu si unë. Ja... sikur të isha ulur nganjëherë me Vasilin për të pirë një kafe, nuk do të më vinte kaq gjyç t'i lutesha për pallton...»

Vasili kundronte fytyrën e shqetësuar të mësuesit. Mësuesi dukej se ishte rënduar e ishte plakur ato vjete; flokët i ishin zbardhur edhe më. Po prapë fytyrën e kishte të freskët, andaj dukej më i ri se ai, megjithëse ishin moshatarë.

— Vasil! — pëshpëriti ai.

— Urdhëro! — kërceu Vasili.

— Hm.. Nuk e di se ç'do të më thuash edhe ti, po unë kuturisa të vij për një punë të vogël — pëshpëriti prapë. Pas kësaj, ashtu siç bënte në mësim, kur donte të theksonte atë më kryesoren, e ngriti zérin: — Ti e di që unë të çmoj si rrobaqepësin më të mirë të qytetit. Këto vjete s'kam qepur gjë të madhe, veç ndonjë palë pantallona. Por tani dua të qep një pallto «Guben». Më kupton? Është fjala për një «Guben» e jo për një palë pantallona, ndaj s'mund ta lë në çdo dorë.

— Aj.. aj.. aj.. zoti profesor! — tha rrobaqepësi.
— Ju kuptoj unë i ziu, po dhe ju duhet ta dini që është punë me zarar të madh kjo...

— E di... e di... — u nxitua të thotë.

— Financa...

— I di të gjitha — psherëtiu. — Po thashë vetëm pér mua, sikur ta kishit pallton tuaj.. si klient i vjetër.. si miq që jemi.. — u ngatërrua mësuesi:

— Gjurmojnë shumë edhe këta të lagjes... aktivistët — psherëtiu Vasili. — E patë fletërrufenë që i vunë Stasit?

— E pashë! — tha ai. — Por unë mendova...

— Nejse! — tha rrobaqepësi. — A ju vuri re njeri kur erdhët?

— Jo! — u gjallërua mësuesi. — Unë prandaj erdha në një kohë të tillë. Po prapë s'dua që të rrezikohesh! Në asnje mënyrë!

— Do të bëjmë si të bëjmë — tha Vasili! — Po të mos jemi pér njëri- tjetrin, lumi që na mori. Ja, dhe unë mund t'ju lutem pér diçka.

Rrobaqepësi e çmbështollti stofin, e hetoi një copë herë atë, astarin prej mëndafshi dhe tha:

— Po! Stof i mirë! I paske marrë të gjitha! Më fal një minutë sa të marr metrin. — Ai mbeti vetëm.

«Përse do të më lutet vallë?» mendoi. «Përse? Ndofta është fjala pér të bijën, që është në klasën IX? Po... ajo s'është nxënëse e keqe!» Vasili u kthye me një blok të vjetër shënim, me metrin e rrobaqepësit në sup dhe me një buzëqeshje të gjerë në fytyrë.

— Ja!. . — tha, sikur kishte zbuluar diçka të vyer.

— E shikoni? — dhe tregoi blokun e zverdhur nga vjetët.

— Çfarë? — tha mësuesi.

— I kam këtu!. . Të gjitha masat tuaja... dhe datën. Më 7/I/1961 keni marrë masë pér kostumin blu. Shikoni? — dhe nisi të marrë masat. — Gjerësia e shpatullave qenka po ajo. Vetëm në bel keni ndryshuar shumë... e shikoni? Jeni shtatë santim më shumë. Keni lëshuar bark, zoti profesor..

— Mos më thuaj gjithnjë «zoti» — qeshi ai. —

Tani s'thonë më kështu!

— He... he! — qeshi Vasili. — Nuk i harrojmë dot të vjetrat ne!

— Njëherë, bile, u bë një diskutim i madh në gazeten «Mësuesi».

— E si mbeti më në fund? — u bë kureshtar rrobaqepësi.

— O!. Ishte qyfyr i madh! U bë një mishmash! Njëri thoshte ashtu, tjetri kështu...

— Po më tej?

— E zgjidhi koha edhe këtë! Vetëm se ne të vjetrit s'mësohami dot aq lehtë — tha mësuesi.

Në katin përdhes fare papritur u dëgjuan të qeshura, guisje, pastaj një këngë me «la.. la.. la..». Mësuesi njoihu zërin e nxënëses së tij, Vjollcës. Rrobaqepësi u zverdh nga inati. Gruaja e trashë seç çuçuriti me zë të ulët. Zëri pushoi menjëherë, ashtu siç kishte filluar. Nëpër shkallë u ngjit gruaja me një disk të bukur, ku ishin vënë filxhanet e kafesë.

«Po!. S'rrojnë keq!» mendoi mësuesi dhe vuri re kolktukët, llampadarët me tre poça, që vareshin në tri steka të përkulura e të shkëlqyera sikur posa ishin larë me sidol.

— Edhe ju, zoti profesor, seç kini vënë ca rregulla të tjera tani dhe na i mbani fëmijët deri natën në shkolë — tha duke u munduar të qeshë me të gjithë tulet e saj gruaja. Kjo qeshje i ngjante shumë ngërdheshjes.

— Kaq vonë u kthyesh?

— Po!

— Do të kenë pasur mbledhjen e rinisë, — tha.

— Jo — tha gruaja. — Ajo është futur në ato të gjimnastikës!

— Ja! Për këtë desha të këshillohem një herë me ju — tha Vasili i pikëlluar.

Gruaja mori filxhanët dhe doli në korridor. Nga dera e hapur ai shihte se si i lëvizte ajo kot së koti porcelanat e bukura të kompletit të çajit në një kontrabufe të re.

«Hm.. Kërkon të duket! S'i kanë shkuar kot ato vjetët e privatizmit këtij», mendoi dhe për herë të parë i bëri pyetjen vetes: «Sa do të më kërkçjë vallë?».

Po mësuesi i vjetër i historisë e mbante veten për njeri galant dhe nuk ja kishte ëndë të merrej me vogëlsira të tilla si pazarllëqet, prandaj s'e vau mendjen më për këtë, aq më shumë sepse e ndjeu që Vasili po i fliste me gjithë shpirt për hallin e vet! Dhe ai e kish humbur fillin e bisedës.

Dhe në përgjithësi ai mbeti i pakënaqur nga vetë-vetja, sepse kohët e fundit po e vinte re më shpesh këtë tē metë që tē harronte fijet e bisedave tē nisura.

— ... unë, s'jam ndonjë fanatik, dreqi e marrtë — thoshte Vasili. — Nuk thosha asgjë, sa ishte më e vogël, në tetëvjeçare! Mirëpo, mik i dashur, tani është në gjimnaz! Puna po bëhet shqetësuese! — pëshpëriti.

— Pse? — pyeti si automat mësuesi.

— Po... sepse tani u rrit!. . Le që nuk i ka hije më kjo gjë, por mua më sëkëlldis më shumë një gjë tjetër... — Çfarë?

— I ka hyrë në gjak! — tha Vasili sikur rrëfente një gjë tē fshehtë. — I ka hyrë në gjak si një pjavicë ky sporti! Një e dy dhe institutin e fiskulturës ka në gojë!

— Siç duket, tē ngjet ty — desh tē bëjë shaka mësuesi. — Se kam dëgjuar që edhe ti je tifoz i madh i futbollit!

Gjithë këtë bisedë ai e shihte si një prej bezdive tē zakonshme, që ish i detyuar tē dëgjonte prej prindërve.

— Tjetër punë jam unë... Se mos është punë shakaje kjo? — tha rrobaqepësi dhe zëri i tij i ngjau aq i përvuajtur mësuesit, sa i erdhì keq.

«I gjoril!» mendoi. «Në këtë gjendje shpirtërore, mos më katranosë pallton time! Pa tē përqëndrohem i një herë!».

Rrobaqepësi vuri re se si u vrenjt ftyra e mësuesit, se si në ballin e lartë e tē bardhë i mbiu një sërë rrudhash dhe iu kënaq shpirti.

— Ja.. pa mendoni sikur t'ju ndodhët kështu me fëmijët tuaj! Si do tē bënët? A nuk kini thurur dhe ju një tok èndrrash për avenirin e fëmijëve tuaj? Unë e desha vajzën doktoreshë! S'jam ndonjë fanatik unë që

ta lë vajzën pa shkollë. Na ruajtë zoti! Ç'është ajo pa shkollë? Mirëpo them, pse të mos vazhdojë pér doktoreshë?

«Doktoreshë? E pse jo?» mendoi mësuesi. «S'është nxënëse e keqe. Edhe unë éndërroj të bëhet Neli mjeke!..» Tani, mësuesit iu lëndua një plagë e vjetër dhe ai do të binte në kujtime, por në dhomë hyri gruaja, që përgjonte bisedën nga korridori.

— S'i ka më lezet të bredhë qyteteve të tjera me shalë jashtë.. S'i ka lezet — tha ajo.

— S'është aty puna, grua — desh të kundërshtojë Vasili. — Puna është te aveniri.. te aveniri.

— Është, që c'ke me të — ja preu fjalën gruaja. — Se në u bëftë mësuese pér gjimnastikë, tërë jetën do të mbetet një femër me shalë jashtë dhe s'do ta zërë njeri pér bishti pér t'u martuar me të! Pse, nuk po i shohim ne se sa pëlqehen ato të sportit sot? «Ç'ta duam?» thonë. «Asaj ja shohin njerëzia shalët të diel më të diel në stadium...»

«Uh! C'grua banale!» mendoi mësuesi.

— Léri këto tani! — tha vrazhdë Vasili.

— Edhe martesa do menduar — tha ajo.

— Do menduar, po unë s'jam nga ata prindër që ta detyroj vajzën jo këtë, po atë! Unë mendoj avenirin..

«Gënjen» tha mësuesi me vete. «Shiko se sa shtiret dreqi! E ka mësuar dhe fjalën «avenir» dhe na shurdhoi me të!»

Gruaja që, pér çudi, s'e zinte dot vendi, në kundërshtim me peshën e tuleve të saj, që duhej të kërkonin prehje, doli jashtë dhe zbriti shkallët me buçimë bum.. bum.. sikur rrukullisej ndonjë vozë.

— Si më këshillon? — pyeti Vasili.

— Në qoftë se i ka lindur një pasion i tillë, ai edhe mund të shuhet. Tani është tamam mosha. Më vonë nxënësi fiton disa tipare të qëndrueshme dhe nga ana pedagogjike nuk është më kaq i lakueshëm se në këtë moshë!

— Ahere? — u bë kureshtar Vasili. — S'mund të bisedoni ju atje në shkollë që ta heqin nga rrëthi i

gjimnastikës? Dhe, ta dini, do t'ju jem mirënjoës përtërë jetën!

— Eh!.. jo! Kështu s'mund të bëhet!

— Po si bëhet ahere?

— Kjo arrihet ngadalë, me dinakëri... Në krye, t'i ftohet asaj vetë gjimnastika, ta kuptoje se kjo e pengon në mësimë... pastaj të kërkojë vetë që të mos marrë pjesë!

— Po... sikur ta bindin, ta detyrojnë?

— Nuk e detyrojnë, jo! Çdo gjë është me vullnet. Në krye do të përpiken t'ja ndërrojnë mendjen. Po kur të shahin se s'ka asnjë dëshirë, do ta lejojnë!

— Po a i flitet asaj, zoti profesor? A i flitet me gojë, thua? Ajo e ka syrin pishë!

— Hm... — hunguroi mësuesi! — Pishë! Pa thi-reni një herë këtu!

Ai e dinte se në shkollë e mbanin për njeri hijerëndë. Në thellësitë e veta, atje ku mund të flasësh ç'të duash, ai krenohej që ishte kështu, hijerëndë! S'para pipëtinte njeri në orën e tij! Për çudi, në një mbledhje kolegët e rind e kritikuani se nuk ishte fort i afruar me nxënësit, se nxënësit kishin frikë nga ai, por ai e përligji veten fort bukur me një ligjëratë fort prekëse; se tashmë ishte vonë të ndërronte natyrën e tij pedagogjike, që ishte selitur në kohëra të tjera, se do të ishte një karagjozillëk i pashpresë që, në vend të maskës së ftohtë, të vinte një tjetër, të embël e të gëzuar. Kjo nuk i përshtatej moshës së tij! Kolegët e rind duhej ta kuptionin këtë! A e kuptonte ai që kjo ishte e vjetër, që kësaj i kishte perënduar ylli? Po si s'e kuptonte? Kolegët e rind pikërisht kështu duhej të bënë! Se kjo jepte përfundime më të mira pedagogjike. Bile, dhe ai mundohej të bënte diçka në ato tre vjet që i mbeteshin derisa të arrinte moshën e pensionit...

Në dhomë hyri Vjollca, e habitur fare nga prania e mësuesit të vjetër të historisë dhe aq më shumë nga buzëqeshja e tij e çuditshme, e butë.

— E? — qeshi ai. — A u preqatite?

— Po — belbëzoi vajza, në mendjen e së cilës nuk

ish zhdukur ende hija e rëndë e mësuesit. — Unë... isha duke u pregetitur... ,

— Shumë vonë — tha mësuesi. — Ti e di që, në orët e mbrëmjes, mësimet përvetëschen me shumë zor!

— Kishim stërvitje... — tha vajza.

— Ku?

— Në palestër.

— Sa herë në javë keni stërvitje?

— Katër herë!

— Ku merr pjesë ti?

— Në gjimnastikë!... — tha vajza dhe mendoi: «Ç'më pyet kështu? Ky sikur nuk jeton në shkollën tonë!»

— Sot në stërvitje ishin pothuaj gjithë mësuesit! Kishim garë kontrolli, përpara garave kombëtare!

— Ashtu? — tha ai dhe nuk i erdhi mirë që ajo tha se në stërvitje paskëshin qenë mësuesit e tjerë. Por si për inat ajo mori dhe më guxim dhe shtoi:

— Ju s'kini ardhur asnjëherë të shihni ekipin tonë, profesor! Ejani të shihni se ç'ekip krijoi profesoresha Liza!

«Ja metoda e buzëqeshjes!» tha ai me vete. «Ju hap syri nga buzëqeshja!»

Gruaja e trashë deshi të bënte ca shenja të fshehta se po llapte shumë dhe ndukte me gishtërinjtë e vet të buhavitur lapuceret e faqeve, po vajza s'e kishte mendjen tek ajo. Gruas më s'i durua dhe tha:

— Bravo.. bravo. ! Bukur folke në sy të profesorit tënd!

— Nuk tha asgjë të keqe — kundërshtoi mësuesi.

— Po unë tani jam i vjetër, bija ime — tha ai dhe u çudit me veten që po përdorte prapë një zë ledhatar. — Vec kësaj, babanë e nënën tënde ka nisur t'i shqetësojë kjo gjë! Ata shqetësohen për përparimin tënd!

— Pse? Unë s'kam marrë nota të këqia! — tha Vjollca.

— Mund të marrësh nesër! — tha ai. — Unë s'jam kundër zhvillimit të prirjeve natyrale të nxënësit, por detyra numër një e nxënësit është... cila? — pyeti sikur ishte në mësim.

— Mësimi — iu përgjegj Vjollca.

— Pikërisht! Mësimi! Prandaj ti duhet të dish, tani, ta përcaktosh mirë kufirin midis mësimit dhe diçkaje tjetër, të jashtme... Asgjë s'duhet ta cënojë përparimin në mësime, apo jo?

— Po!

— Çdo vit që shkon, çdo klasë më lart, sjell vështirësi më të mëdha, apo jo? Ndodh në shkollë edhe kështu: mëson deri në një farë vendi mirë, pastaj bie, bëhesh më i dobët se më i dobëti. Sikur të të ndodhë dhe ty kështu, ç'do të bëje?

— Nuk e di! — pëshpëriti vajza. — Sporti mua s'më pengon. Ai është pasioni im. Unë dua të shkoj në institutin e fiskulturës.

— Kurrë — tha gruaja.

— Pse nguteni kështu? — tha mësuesi. — Kjo është e natyrshme. Në këtë moshë ëndrrat shtohen... Ja, djali im i madhi në atë moshë donte të bëhej shofer! Ë! Çudi, apo jo? Po maqinat i tërheqin fëmijët. Unë, i ati, ëndërroja të bëhej mjek, por ja që s'doli as njëra dhe atë e tërhoqi një romantikë tjetër, ajo e maleve dhe u bë gjeolog! Kështu do të ndodhë dhe me ty, Vjollca. Po të më pyesje mua tani, si mësues, si mikun tuaj, unë nuk do ta përkrahja dëshirën e tepërt që ke për sportin. Gjatë jetës sime të gjatë pedagogjike, kam vënë re se ka një dizarmoni midis zhvillimit të intelektit dhe prirjeve për sportin...

Prindët heshtnin me gojë hapur. Vasili priste diçka të thjeshtë, që ta kuptonte menjëherë, kurse kjo ligjëratë i dukej si shumë e majme. Gruaja nuk priste asgjë. Ajo, thjesht, ishte e pakënaqur dhe pikë! Mësuesi u kujtua që kjo retorikë nuk e kishte këtu auditorin dhe heshti.

— Nuk është ashtu, profesor! — tha befas Vjollca.

— Si? — kërceu ai si i përgjumur, sepse prapë e kish humbur fillin.

— Nuk është e vërtetë që gjithë mësueset e fiskulturës kanë qenë nxënës të dobët. Mësuesja jonë, Liza...

— Sigurisht! — tha ai. — Çdo rregull ka dhe për-

jashtime. Po ti mbaje mend këtë këshillën time: mësimet, dija, para së gjithash. Po u pengove në rrugën e dijes, flake tej pengesën, qoftë sporti ose tjetër gjë. Prijet e tua nuk humbasin. Vjen një kohë dhe mund t'i zhvillosh prapë.

— Mësuesja thotë se sporti do vazhdimësi — tha Vjollca.

— Hm... Mësuesja! U vonova! Tani, natën e mirë — tha dhe u ngrit.

Mbathi galloshet, që i ishin shpuar në majë dhe doli në oborr. Vesonte shi. Hapi çadrën. Nga një brimë, në kulmin e saj, u duk llamba elektrike që ndriçonte në shkallët e gurta.

«Duhet arnuar çadra!» — mendoi.

Para se të mbyllte portën, Vasili që e ndiqte si hije, sec i pëshpëriti, por ai mbajti mend vetëm fjalët e tij të fundit: «Mendoni sikur të ishte fëmija juaj!..»

* * *

...si fëmijët tuaj.. Hm...» Fëmijët e tij! Kish pasur zhgënje mësuesi i vjetër i historisë me fëmijët e tij! Dhe çudia ishte se ai kishte llogaritur prej kohësh të ardhmen e fëmijëve të tij! Po.. po, kish llogaritur gjithshka, si ai pemëshitësi i vjetër, që në fund të ditës llogariste fitimet. Djali i tij, Antoni, duhej të bëhej mjek. Mjek i shquar! Dhe në portën e tyre të ngjitej një pllakë e re tunxhi: «Anton Rado — okulist!» Në krye fati u printe dëshirave të tij. Që në mituri ai e futi në botën e madhe e të çuditshme të librave dhe kështu i ngjalli atë pasion të rrallë për leximin, që ndihmoi pastaj përparimin e tij në mësime. Dhe Antoni përparonte si asnje tjetër! Ç'gjë delikate të jesh mësues dhe të kesh edhe fëmijët e tu nxënës! Dhe ç'kënaqësi e jashtëzakonshme pastaj, kur të gjithë të thonë se janë pikërisht fëmijët e tu më të mirët! Por papritur Antoni kish fituar një pavarësi të çuditshme mendimesh dhe ai e kish nuhatur shumë vonë këtë! Vonë, sepse kishte

qenë i ekzaltuar pas shkëlqimit të tij! Mësuesi i gjorë i pat rregulluar bile edhe të drejtën e studimit për mjekësi, por pa shkuar një muaj kishte marrë letrën më të habitshme në botë! Antoni shkruante se nuk e kish duruar dot erën e kufomave në morgë dhe as pamjen e tyre dhe, meqë thoshin se ai që nuk mësohet dot me morgën që në krye, nuk bëhet dot mjek (e gjitha kjo ishte një budallallëk, sipas mësuesit), e kishte shkëmbyer fakultetin e mjekësisë me gjeologjinë! Dhe tani kërkonte minerale në malet e Kukësit!

Për vajzën e dytë, Koletën, kish patur ëndrra më të varfëra. Ajo ishte e turpshme, pak e ngathët, kishte ngjarë nga eëma dhe dukej që atje tej se ishte prerë për amvisë! Por një fakultet të pedagogjisë mund ta ndiqte ama, në vend që të martohej menjëherë pas mbairimit të shkollës me një ekonomist që, c'është e vërteta, nuk ishte një dhëndër i keq!

Mirëpo tani..tani.. Këto plagë po malcoheshin të gjitha. Ai kishte Nelin! Ëndrrën dhe egon e fundit! Neli e mira, e zgjuara, e urta, e bukura Neli! Tani ishte në klasën e tetë. Ajo, po! Do të bëhej mjeke! Pasionin për mjekësi po ja krijonte prej vitesh. Kishte bërë një bibliotekë të tërë me libra e revista mjekësore dhe i bëhej zemra mal kur shihte që Nelic ja kishte ënda t'i shfletonte! C'kishte këtu të keqe? Bile ai qërtonte veten që nuk e kishte ndjekur këtë metodë dhe për pregatitjen e Antonit.

Dhe ja...sonte i lindën këto mendime të çuditshme... «Sikur të ishte fëmija tuaj!» Po sikur t'i ndodhë dhe atij diçka si kjo e Vasilit? Fundja edhe Vasili kishte thurur ëndrrën e tij për të bijën. Do të thuash që Vasili s'mund ta thurte ashtu si ai, që ishte pedagog, që dinte t'i drejtonte e t'i krijonte dëshirat. Punë e madhe! Le të merrej rasti i Antonit! Po sikur edhe Neli e tij, Neli... e mira... e urta... të kishte më vonë një kokëshkrepje të habitshme për sportin, ose për bujqësinë... ose ku ta di unë?

Në rrugë binte shi. Mësuesin e vjetër e mbytën

mendimet e turbullta dhe prandaj nuk i shihte fare llo-kajat me ujë të turbullt. Uji i hyri nëpër galoshen e çarë. Dikush e përshëndeti, po ai nuk e vuri re se kush ishte. Një pikë uji i kulloi nga brima e çadrës në qafë, një pikë e ftohtë shqetësuese, që i shkau nëpër peshkun e kurrizit.

«Duhet të bisedoj një herë me Nelin, t'ja tregoj këtë rastin e sotëm, ashtu si ndodhi. C'mund të më thotë Neli vallë?»

I mërzitur, u kthye në librarinë që po mbyllej dhe mori me nxitim një libër mbi mjekësinë, të cilën shëtësja ja rekomandoi si shumë inetersant. Posa sosi në shtëpi, hoqi galloshet, pantallonat e spërkatura me baltë, veshi pizhamatë e ngrohta dhe u shtri anës së sobës. Gjella po ziente me zhurmë dhe mbante erë lëng pule. E shoqja, ashtu e urtë, pakëz e ndrojtur, e pyeti me zë të ulët vetëm kaq:

— E?

— E mbajti! — tha ai.

— Sa më gëzove! Se kisha një parandjenjë që nuk do të bëhej gjë!

— Ku është Neli?

— Në dhomën e saj! Po mëson.

— Le të vijë këtu! Atje është ftohtë!

Neli, një vajzë e gjatë, e dobët po me tipare të bukurë, hyri në dhomë, me një libër në dorë. Libri ishte mbështjellë me një gazetë dhe ai, që nga larg, pa në gazetë një fotografi të zbetë. Nja tre-katër njerëz kishin kërcyer për të kapur një top!

— Ç'është ajo gazetë? — pyeti i shqetësuar.

— Cila? — tha vajza e habitur.

— Ajo.. që ke mbëshjtellë librin..

— Ah!.. Është «Sporti» — tha vajza. — Ma dha një shok në klasë...

— Sille këtu — tha ai. E mori librin dhe e kundroi një copë herë fotografinë, ku djelmoshat kishin kërcyer për të kapur topin. Atij s'i kishte pëlqyer kurrë sporti. C'dreq pati Neli që e kishte mbështjellë kapakun e

librit pikërisht me atë gazetë? Apo mos ndofta.?

— Fotografinë e basketbollisteve shikon? — tha Neli.

— Po! Një lojë e mërzitshme, apo jo?

— Shumë e bukur — tha Neli. — A e di, baba?

Mësuesja e fiskulturës thotë se me shtatin që kam unë, mund të bëhesha një basketbolliste e mirë!

— Profka! — tha ai i vrejtur. — Ajo mësuesja juaj, Liza, më duket se s'është në vete fare! Kam dëgjuar se edhe në shkollë ka qenë pykë më diell! Dhe, në përgjithësi, ka një kontradiktë midis zhvillimit të intelektit dhe sportit, e di? Por le ta lëmë këtë. A e gjen dot se ç'të kam sjellë? — i tha duke e vështruar ashtu siç e vështron te kur ishte shumë e vogël.

— Jo, baba, — tha vajza.

— Një libër! Një libër të mrekullueshëm për mje-kësinë! Është aq interesant sa do të të thithë si magnet dhe kam frikë se do të gdhihesh duke e lexuar, si atëherë, mban mend me «Mjekun e tre kontinenteve»? — Vajza u bë kuteshtare dhe ai ja shtoi më shumë kër-shërinë, duke e detyruar ta gjejë se ku e kishte fshehur; pastaj u ul në një skaj të divanit, mbuloi gjunjët me fustanin, që i ishte shkurtuar dhe u zhyt në një lexim aq të vëmendshëm, saqë mësuesit të gjorë i shkriu gjaku.

«Po!.. ajo do të bëhet mjeke! Mjeke!»

* * *

Kurrë s'ishte bërë një mbledhje e tillë e jashtë-zakonshme, e shqetësuar si det me dallgë. E re, e qu-ditshme dukej dhe njëra nga pikat e rendit të ditës: akuza e mësueses së fiskulturës për mësuesin e vjetër të historisë!

Mësuesi ishte ulur në një karrige, që e bezdiste shumë, në tavolinën e fundit të laboratorit të biologjisë, ku bëheshin gjithnjë mbledhjet e këshillit pedagogjik. Përkrah i rrinte një nga mësuesit e matematikës, Stefani, një njeri pedant, me të cilin ai s'kishte pasur ku-

rrë miqësi. Mësuesi i matematikës vërtiste në dorë një stilolaps të ri, sikur donte të mburrej me të dhe kjo ja cingriste nervat më keq.

«Si ndodhi kështu?» mendoi mësuesi i vjetër i historisë. «Si është e mundur që unë të jem objekt i një mbledhjeje?»

Ah! Po! Gjithshka filloi një ditë vjeshte me shi. Dhe kjo ishte të nesërmen e asaj mbrëmjeje, kur shpuri pallton për ta qepur te Vasili... të nesërmen e asaj mbrëmjeje kur iu kujtua se duhej arnuar çadra dhe kur i lindi mendimi i bezdissħem: «Sikur të më ndodhte kështu me fëmijët e mi?», kur u shqetësua se Neli kish mbështjellë librin e gjeometrisë me një gazetë «Sporti» dhe kur ishte qetësuar pastaj kur e pa të zhytej në botën e madhe të mjekësisë!

Po! Të nesërmen!...

Ishte ndofta dita e parë e dimrit. Qëmtonte dëborë dhe ai mbërdhinte nën pardesynë e vjetër.

«Si nuk i thashë të ma qepte pallton sa më parë?» kishte menduar ai, kur në rrugë kishte parë figurën e zhđervjellët të mësueses së fiskulturës. Ajo e kishte përhëndetur me zë të lartë dhe e kishte kaluar. Ai e kishte vënë re se si i kishin ngrirë mbi flokët e saj të verdhë fije të dëborës së parë, pastaj vështrimi i kishte shkuar në pulpët e zhveshura e të përskuqura, ku lëvizni muskujt. «Si dreqin nuk ngrin kjo?» kish menduar ai. Mësuesja sikur qe kujtar diçka, i kishte ngadalësuar hapat dhe e kishte pritur.

— Profesor... — i pat pëshpëritur ajo.

— Ç'është kolege? Atij i pëlgente t'u thoshte të gjithëve «kolegë». I dukej sikur kjo fjalë e bekuar e shpëtonte nga bezdia që i krijohej kur mendonte se si duhej t'u drejtohej më të rinxve, disa prej të cilëve kishin qenë nxënësit e tij.

— Desha të bisedoj pak me ju, për vajzën tuaj — i kishte thënë ajo.

— Si kështu? — kishte pyetur ai me shpoti. — Nuk shkon mirë në lëndën tuaj? Mos ja vini re, kolege,

e dini, dikush ka prirje për sportin, dikush për diçka tjetër...

— Pikërisht, këtë doja t'ju thosha — i qe përgjigjur Liza. — Ajo ka prirje të mira, një elasticitet të habitshëm. Unë shpresoj se mund të bëhet ose basketboliste ose atlete e garave të kërcimit.

— Si kështu? Gjithë nxënësit synoni t'i bëni atletë ju, kolege?

— Pse jo? Pregatitja fizike...

— O!.. këtë e di... e di... — i kishte thënë mësuesi i vjetër. — Po sikur të jenë të gjithë atletë, kush do të jetë pastaj mjek, për shemboll, ose aktor ose... — kish vazhduar ai shpotinë e vet. Me bishtin e syrit kishte hetuar ftyrën e habitur të Lizës. «Tallet apo vërtet nuk kuption se po tregohet naiv?» thoshte vështrimi i saj. «Hë.. gjeje de...» thoshte vështrimi i tij shpotitës. Dhe, për çudi, naive u tregua mësuesja, e cila kish zënë t'i shpjegojë:

— Atletika nuk është një profesion... çdo njeri duhet të merret me të dhe në çdo moshë...

— C'thuas, në çdo moshë? — kish thënë ai. — Ja, këtë **nuk e dija!** Por për vajzën time ju jeni gabuar. Nuk ka prirje ose dëshirë të tillë ajo, këtë e di më mirë se kushdo, unë! Dhe më duket, kolege, se edhe nga ana anatomi-fiziologjike është herët për të. Ju duhet ta dini më mirë se unë këtë...

— Por... — deshi të kundërshtojë ajo... — ne i përshtatim ushtrimet me kërkesat e moshës.

Këtu ai i kërkoi të falur dhe u kthye të pijë **kafe**.

Pastaj? Po... Kishte pasur mësim në klasën e nënëtë, ku mësonte Vjollca. Ishte në humor të mirë, në humor, siç i ndodhte rrallëherë, kur vinte dikë në lojë dhe shpotia e tij kish sukses! E kish këtë ves të shkretë, të vjetër. Në klasë i shkrepi të pyesë pikërisht Vjollcën.

— Eja, moj gjimnaste e famshme... — qeshi ai. Edhe klasa si rrallëherë qeshi, po nuk u ngrit askush.

— Hë, pra! — tha me padurim ai. — Apo nuk je preqatitur?

— Ne jemi katër gjimnaste — tha një vajzë tjetër...

— Po kush éshtë më e zonja?

— Vjollca! Mësuesja e fiskulturës thotë se ajo mund të konkurojë për ushtrimet e kategorisë së parë!

— Atëhere, le të vijë kategoria e parë! — tha ai. Klasa nuk e kishte parë kurrë mësuesin kaq të këndshëm.

Dhe, si për çudi, i lindi dëshira ta ngatërrojë medoemos. Ja preu fillin që në fjalët e para dhe nisi t'i bëjë disa pyetje të turbullta, të tërthorta, siç e dinte vetëm ai të pyeste. Dhe vajza ishte hutuar, nuk dinte të shpjegonte më asgjë të saktë. Sytë iu mbushën me lot, po ajo i fshiu me inat. Ai e vuri re në çast dhe tha me vete: «Qenka e prekshme! Nuk duron dot të rrijë si hu gardhi përpara klasës.. Aq më mirë, pra» dhe buzëqeshi duke mërmëritur:

— S'prish punë... Në gjimnastikë sot je kategoria e parë, në histori kategoria e katërt... Le të shpresojmë se nesër do të ndërrohen kategoritë! — Dhe ndoshta nuk do të kishte vepruar më ashtu siç veproi, sikur ajo mësuesja e bezdissħme e fiskulturës të mos i ishte qepur si rrodhja për Nelin. Apo kush e di? Ndofta e tēr-hoqi shumë kjo lojë? Pse atëhere vazhdoi ta hutojë Vjollcën, megjithëse e rregulloi me drejtorin që Neli i tij të mos futej në ato rrethe sporti? Nganjëherë një zë i çuditshëm i vëngonte që thellë dhe e qortonte! «Ç'bën kështu? Pse e hutove kështu këtë vajzë? Ç'faj ka ajo?» Po ky qortim ishte i rrallë, i dobët e tretej përpara një dëshire të habitshme, që i kishte lindur: «Mendo sikur Vjollca éshtë Neli! Dhe ti s'do që ajo të bredhë e të bëhet gjimnaste. Ti do ta bësh mjeke. Si do t'ja thyesh këtë dëshirë të marrë për sportin?» Kështu vazhduan dhe nota të tjera të këqia për Vjollcën. Një trishtim i çuditshëm i mbiu në sytë e shkruar, një trishtim që donte të thoshte diçka, që pyeste e që s'merrte kurrë përgjegje. Ajo nisi të marrë nota të dobëta edhe në matematikë, në lëndën e kolegut që kishte pranë. Ngadalë trishtimi u shndërrua në apati e mosbesim, që rritej çdo ditë. Dhe mësuesi i vjetër i historisë ngazëllonte me vete me metodën e tij, me thyerjen që po bënte, me frutin e metodës së vet, me stu-

dimin e hollë pedagogjik që bëri. Dëgjoi se ajo nuk po vinte në rregull në stërvitje, se ndofta nuk do të konkurronte fare në kampionat... Kështu iu shtua bindja se po vepronte mirë... se ai prapë kishte në dorë edhe gurin edhe arrën, dhe tremujorin tjetër do ta ngrinte prapë!

Atëherë lindi dy diskutim me kolegët e vet. Në krye ishte një pëshpëritje, pastaj u ngrit zëri i fortë i mësueses, që tha se Vjollcën e pengonte të merrte pjesë në gara pikërisht trajtimi i padrejtë në mësimë, që i bënte mësuesi i historisë... Derisa erdhi kjo mbledhje e këshillit pedagogjik, sot... Erdhi kjo mbledhje e çuditshme që të thyente monotoninë e mbledhjeve të vjetra, ku viheshin në kandar ata që do të kalonin e do të mbeteshin!

Drejtori kish kohë që po lexonte një qarkore të seksionit, po s'kish dëgjuar asgjë. Si i përgjumur, ngriti sytë, mbi të cilët i rëndonin qepallat sikur s'ishin më të tijat dhe pa mbi krye, prapa xhamave të dollapëve, një bust njeriu me kafkë të hequr, ku dukeshin përdredhjet e truve; pa ftyrën e shëmtuar të kangurit australian me xhepin è vet për të fshehur fëmijët. Busti dhe kanguri kishin ngrirë në një palëvizshmëri të ftohtë. Mbi ta, në mur, ishte fotografia e Linneut, që e vështronte me mospërfillje. Zëri i ngjirur i drejtorit tha:

- Tani kalojmë në pikën tjetër...
- Ky është një paradoks! — i pëshpëriti Stefani.
- Çfarë? — tha ai.

— Them: kjo pika e dytë është një teoremë e pagzjidhshme... — Ai nuk foli. Dëgjoi se si krisi një karriqe. Në tryezat e para u ngrit figura flokëverdhë e Lizës. Për çudinë e madhe të mësuesit, zëri i saj ishte i dobët, i ndrojtur. Por ngurrimi ishte i shkurtër dhe zëri iu bë më i fortë, vetëm se një dridhmë e herëpas-hershme tregonte se ajo ishte e tronditur.

— Unë kam respekt për mësuesin e vjetër të historisë... — tha ajo.

- Mos e pyet!... — pëshpëriti Stefani.
- Më lini rehat, ju lutem! — tha ai.

— Unë e kam pasur të vështirë të ngre këtë akuzë!
— tha Liza,

«Akuzë! Pikërisht akuzë!» mendoi mësuesi dhe, ngaqë nuk donte të shihte valavitjen e flokëve të verdhë para tij, vështroi prapë stendat e biologjisë. Dhe prapë i mbinë në sy njeriu me kafkë të hequr dhe kanguari me trastën në fund të barkut.

— ...por unë tani jam e bindur — vazhdonte ajo, — se mësuesi ynë, duke e vështruar fiskulturën si një konservator, po kështu sheh edhe çdo nxënës që merrët me sport. Ju e kini dëgjuar dhe shprehjen e tij «mbi kontradiktën midis zhvillimit të intelektit dhe prirjeve për sport». Prandaj sjellja e tij me nxënësen Vjollcë më shtyu mua të mendoj se ai ka menduar... ka menduar...

Mësuesja nuk po e gjente dot shprehjen e duhur.

«Po ngatërrrohet!» mendoi mësuesi. «Po ngatërrrohet që në fjalët e para. Dhe dashka të lexojë mendimet e mia sikur unë të jem ky busti me kafkë të hequr!» Mësuesi i vjetër vetëtimthi hetoi kolegët e vet. Të gjithë rrinin në një ngurtësi të habitshme, si nxënës të disiplinuar dhe nuk e shihnin fare! Vetëm në tavolinën e kreut, drejtori dhe mësuesja e gjuhës, Vilma, që ishte sekretare e organizatës, seç pëshpërisnin me gjallëri. Drejtori dukej sikur e kundërshtonte. Vështrimi i drejtorit ishte i menduar. Atij iu duk sikur drejtori mendonte pikërisht kështu: «Ku na mbiu pikërisht në këshillin tonë pedagogjik një problem i tillë?» Ky vështrim sikur ja përtériu kurajën dhe ai e vështroi me sy të pulitur, me shpoti mësuesen e fiskulturës, që po heshtte. Drejtori që e kapi këtë heshtje në çast, tha:

— Dëgjoni, shoqja Liza! Ju po merreni shumë këtu me mendime, me supozime, me deduksionet e këtyre mendimeve. Nuk jemi në mësimin e vjetër të psikologjisë! Ju duhet t'i faktoni thënjet tuaja, që kanë tronditur këshillin tonë pedagogjik...

— Po ju lëreni të mbarojë, shoku drejtor — tha Vilma.

— Po mbaroj! — tha befas Liza. — Unë si mësuese dhe si trainere, kam shumë kohë që bisedoj me Vjollcën

për këtë. Ajo ngurroi gjatë. Dhe vetëm para disa ditësh më tregovi për një bisedë që kanë bërë prindërit e saj me mësuesin e e historisë. Dua të pyes shokun Sterjo në është e vërtetë. — Ra heshtje. Dëgjohej fryshtimarrja e vështirë, azmatike, e mësuesit të vizatimit. Ai nuk deshi të fliste. Kundroi njeriun me kokë të hapur, pastaj kangurin.

«Dreqi e marrtë kangurin! — mendoi dhe tha:

— Unë do të flas pér të gjitha, në fund...

— Mirë, atëhere — tha Liza. — Unë po vazhdoj.

Në atë bisedë prindërit e Vjollcës i janë lutur shokut Sterjo që t'i ndihmojë ta shkëpusin vajzën nga sporti. Kështu? — Po askush nuk u përgjegj!

— Atëhere, ai i tha Vjollcës se duhej të mos merrjet aq shumë me sport sa të pengonte përparimin e vet në mësimet.

— Bukur i paska thënë. Ç'të keqe gjen ti këtu? — tha Stefani. — Këtë e themi të gjithë: aktivitetet jastë shkollore s'duhet të pengojnë përparimin!

— Po, e themi dhe kështu duhet — tha Liza. — Deri atë ditë Vjollcën nuk e kishin penguar këto aktivitete që të merrte nota të kënaqshme.

— Po ja që u bënë njëherë pengesë, apo jo? Gjëra që ndodhin! — tha Stefani.

— Ndodhin... po jo ama pér të provuar një tezë të tillë, të nisim t'i ngatërrojmë nxënësit me qëllim, t'i hutojmë deri në atë masë sa të humbin bësimin në forcat e veta. Ju mund të pyesni klasën se si e ngatërronte dhe e sorollaste mësuesi i historisë Vjollcën.

— Ju s'kuptoni gjë nga këto. — kundërshtoi Stefani.

— Po ti ç'ke? Kush të vuri avokat mbrojtës? — u nxeh mësuesi i vjetër i historisë.

— Oh! Unë mbroj pikëpamjen time!

— Pikërisht këtu e shoh unë gabimin e mësuesit — tha Liza. — Nuk e di nëse ai e kishte menduar gjithshka që më parë, apo ky qëndrim është vetëm refleksi i konservatorizmit të tij, por më në fund desha të shtoj se një qëndrim të tillë konservator ai mban dhe karshi vajzës së tij, që ka të dhëna shumë të mira pér bas-

ketbollin dhe ai nuk e lë të luaj me ekipin e shkollës... megjithëse... ajo, ndofta pa dijeninë e tij... është stërvitur me ekipin!

— «Si? Qysh?» — i shkrepi në kokë atij. «Pa dijeninë time? Neli? E mira, e urta? Si është e mundur? Dhe a është e mundur kjo në përgjithësi? Apo nuk dëgjova mirë? Apo kjo gënjen?»

Ky shqetësim i ri i papritur dhe tepër i fortë nuk e la të dëgjojë më me vëmendje. E kuptonte që gjithshka ishte kundër tij, kundër tij... bile edhe njeriu me kafkë!. . Dikush tha që kjo mbledhje duhej të qe bërë bashkë me klasën; dikush, ndofta drejtori, tha se të gjitha ishin hamendje dhe se për këshillin e tyre pedagogjik ishte më mirë që kjo çështje të mbyllej. Por Vilma e kundërshtoi. Pastaj drejtori tha prapë se mësuesi i nderuar i historisë duhej ta shihte një herë me sy kritik qëndrimin e tij karshi nxënëses Vjollca dhe puna të mbyllej, sepse nuk e nderonte këshillin pedagogjik; po përsëri zëri i mprehtë i Vilmas tha se ky diskutim përkundrazi e nderonte shkollën e tyre dhe lavdëroi Lizën.

Dhe befas gjithshka heshti... heshti... Vetëm kanguri e përqeshte me atë fytyrë të përcmuar.

«A thua kanë mbaruar të gjithë e presin fjalën time? — mendoi ai. Ngriți kokën. Ishte zhdukur ngurtësia e kolegëve dhe të gjithë vështronin atë. Sy kureshtarë, indiferentë, të ngrohtë, premtues, të butë... Pastaj sytë e ftohtë të dikujt sikur u shuan dhe ai shihte vetëm një valë vështrimesh të ngrohta, që prisnin diçka prej tij.

«Jo... jo...» mendoi. «Është ende herët për të kuptuar e për të thënë diçka. Do të jetë e shtirur, e keqe... Unë duhet t'i mendoj edhe një herë të gjitha. Të bisedoj edhe me Nelin...»

U ngrit më këmbë, i zbetë, i lodhur. Në krye i dukej sikur i zhuzhitnin një tufë mizash. Nga stenda e vështronte kanguri.

«Sa i neveritshëm ky kanguri, me atë trastë!..» mendoi dhe foli duke pëshpëritur me një zë të ngadalshëm.

— Kolegë... Më kuptoni... Unë tanë s'mund të them asgjë. Jo, më lejoni të largohem nga mbledhja. Më

lejoni t'i mendoj dhe një herë të gjitha e të flas një ditë tjetër. A kam leje të largohem?

Dhe papritur përgjegje, mësuesi i vjetër i historisë eci drejt derës. E hapi. Mbi shpinë e ndjente akoma valën e ngrohtë të vështrimeve. Iu bë sikur drejtori i pëshpëriti «Qetësohuni disa çaste pastaj ejani prapë», por nuk ishte i sigurt për këtë. Dhe as që i duhej. Zbriti shkallët me një hap të pasigurt e që i dukej sikur gjëmonte në gjithë korridoret e shkollës dhe doli në oborr. Nga çatia rridhnin pikat e shkrira të dëborës. Po vinte një pranverë e hershme.

Bëri të dilte në rrugë. Por në xhade kalonin me shpejtësi maqina të mëdha me buçima e thirrje të zgjatura borijash,

Mbeti një copë herë në trotuar duke pritur të reshtte lëvizja e të gjente shteg për të dalë.

«C'bëhet kështu?» mendoi.

Befas ndjeu një dorë të lehtë, të butë, që e preku në sup. Ktheu kokën dhe pa Nelin me një rrjetë, ku dukej një fanellë e kuqe me një numër, që s'e dallonte dot se ç'ishte.

— Baba! Shkojmë? — tha vajza.

— Po ti?... — bëlbëzoi. — Ku ishe?

— Unë hyra në ekipin e shkollës, baba, — tha ajo.

— Dhe jam lojtare e qendrës! Sot morëm uniformën.

Ai e ndjeu dorën e vet të madhe në pëllëmbën e vogël të dorës së Nelit dhe pastaj kjo dorë e tërhoqi në xhade, ku kalonin me zhurmë maqina të rënda.

PIKOJNË KOKRRAT E KRIMBURA

Në mbrëmje, brigadierja po kthehej nga mbledhja e kryesisë në fshatin e vet, të fshehur në mes të kopshteve me mollë. Oh, ç'mbrëmje dhe ç'fushë e çuditshme ishte kjo, që shtrihej sonte përpara syve të saj! Nëpër ajrin e vakët, grykave e përrenjve endeshin muzgjet e mbrëmjes si valë gushpëllumbi. Një tufë drite shponte perden e trashë të reve dhe mbi fushë lundronin gjurma të bardha. Dita sikur ishte bërë papritur më e gjatë dhe fusha sikur nuk donte të kridhej në valët e muzgjeve, që shtyheshin më nga era drejt malit si tufa të zeza dhensh. Shirat kishin thërmuar me gishtat e tyre të lagur plisat e murme të dherave të lëruara. Nga shkorretat ngrihej e ikte një tufë e trembur turtujsh.

Ç'i gufonte kështu zemra në këtë mbrëmje të panjohur për nëntëmbëdhjetë vjetët e saj? Dhe pse i buisen vallë mendime kaq të huaja për njëri-tjetrin, mendime leshatare dhe të trishtuara, të këndishme dhe të mërzitshme? Shkelte mbi gjurmët e bardha të drithës dhe ndjente flladin, që i përkëdhelte fytyrën e përskuqur nga udha. Në gji, afër zemrës, i fërgëllonte diçka dhe i pëshpëriste me fjalë të ndrojtura letra e parë: letra e Agimit. Por gjurmët e drithës mbaronin dhe mbi shpinë i rëndonin muzgjet. Dhe në krye niste e i rëndonte një mendim tjetër: i zhuzhurinin si brumbuj qortimet e tërthorta që kishte dëgjuar në mbledhje.

«Ah!.. baba!..» psherëtiu. «Më duket se për shkakun tënd po turpërohem që në fillim të punës sime si

brigadiere! Si tha ashtu kryetari? Dhe a e kishte vetëm me mua?» Ja turbullojnë mendimet fjalët e kryetarit, që i janë ngulur në tru si gozhdë: «Që thoni ju, shkuan e vanë ato kohë, kur njerëzit kënaqeshin duke të parë vetëm gunën; demek, dua të them, se tani s'ka aq duk fjalë, sado e majme të qenkësh, po ka duk vetëm puna! Bjeri teneqesë ti sa të duash; po nuk dole vetë në krye, s'ta var torbën njeri. Mirëpo kemi, që thua ti, shokë kryesie dhe kuadro në kooperativën tonë, që duan të fshihen akoma pas gunës, po që u qan syri t'i kenë edhe më tej ato metra të tepërt personale ose ato dy-tri dhen mbi statut!»

«Mirë e ka kryetari» mendon ajo. «Po eja e i mbush mendjen babait, pa! Do të thotë: Pse del gjithnjë si kërrri përpara gomarit?»

Mbrëmja u bë më e dendur. Kapulet e misrit, deri tej rrëzë kodrës, dukeshin si tumba. Një qerre rropatej të dilte nga baltovina e udhishtës së arës. Qerrja, e ngarkuar me misërishta, dukej sikur do të përmbysej, megjithatë shkonte përpara, drejt xhadesë. Ajo e njoju qerrtarin, xha Qenamin, dhe në gji i fërgëlloi prapë letra e Agimit. Nxitoi të arrijë qerrtarin që rrugën deri në fshat të mos e bënte vetëm me mendimet e saj. Nata do të ishte e ftohtë. Në lindje varej një perde shiu, që binte në mal. Larg, një majë mali shkëmbor, ishte praruar nga rrezet e fundit. Në xhade e arriti qerrtarin.

«Ky është babai i Gimit!» tha me vete. «Si duhet t'i flas vallë?»

Xha Qenami, një nga ata pleqtë që s'bien në sy, sepse janë më shumë të heshtur se sa të gojës, si gjithë ata që jetën e tyre e kanë shkuar me qetë e buta dhe me marramendjen që sjell ecja pas tyre në brazdë, atë mbrëmje ishte i ngrysur. Apo kështu iu duk asaj dhe vështrimi i tij ishte vërtet i zymtë?

— Mirë mbrëma! — pëshpëriti ajo.

— Mirë mbrëma!

U nisën. Errësira i fshiu kapulet e misrit nga syri. Dukej vetëm qerrja që lëkundej, qetë dhe figura e kërrusur e plakut, që ishte një hap para saj.

— Ra shi këtu? — deshi të nisë fjalë ajo.

— Shi i mallëkuar... — turfulloj plaku. — Kur duhet, futet në bri të buallit; kur s'duhet, bie me gjyme!.. Ho! Hoa, Kuqo!

— Paske mbetur i fundit — tha ajo, kot së koti.

— I fundit! — tha plaku me inat. — Nuk thua të kishte edhe ca të tjerë pas meje, se po kalbet misri! Po i trembi një vesë shiu!

— Po!.. Kemi akoma misër në arë!

— Mbeti atje dhe kalbet atje, që të çuditesh! Po edhe ti, si brigadiere që je, ku vete e humbet gjithë ditën?

— Kishim mbledhje!

— S'kanë të mbaruar këto mbledhje, a? Do të bëheni dembelë, duke ndenjur tërë ditën më bythë!

— Dëgjo, xha Qenam! Mbledhjet nganjëherë bëjnë punë të madhe! — tha ajo. — Ja, ku mund t'i qanim hallet e t'i bisedonim të gjitha si fshat, veç në mbledhje?

Plaku e shikoi me bishtin e syrit. Po... ishte e zgjuar, shejtani vetë, kjo çupë e Shametit të Shaqos! Dhe tjetër pamje të kishte marrë që kur e kishin vënë brigadiere! «De, or, del» ish çuditur ahore Qenami. ««Çupa e Shametit në krye të brigadës! Në krye të fshatit, thuaj! Të ishte në krye të skuadrës së rinisë, hajde de, do t'i kishte hije! Ose të ishte në krye të valles, që ma dridhje si qëmoti, hajde de! Prapë do t'i kishte hije shtati, se vjetët po e selitnin me merak të madh dhe shtati i kish hovur përpjetë si bilonjë, si vajzë mali. Dhe më të kishte një fytyrëz të qeshur vëtëvetiu, si behari vetë! Por...»

Ja, një nuse të tillë i donte zemra për Gimini e tij, që ishte tanë ushtar në marinë! Apo s'ishte edhe Gimi, dërdëng si i ngjeshur me brumë të mirë. I qante syri, po ku u dihej rinokeve sot, o xhan i vëllait? Sos do të pyesin pleqërinë? Pastaj, e kishte ushtrinë të gjatë Gimi, si jo tjetërkush, kurse çupa e Shametit zbukurohej dita me ditë!

Dhe ku ta dinte xha Qenami se Esmasë tani i zhuriste gjirin, jo tjetër, po letra e marinarit? Dhe ky Gimi tani kishte gjetur të bëhej i guximshëm, që shkoi ushtar! «Shiko, Esma, unë dhe që më parë, që atëhere kur poqëm misra në arë... të kujtohet..? që na zuri një vesë shi dhe ne, gjithë skuadra e rinisë, u futëm nën shelgjet, anës së lumit... Çudi, si binte shiu ashtu atë mbrëmje! Mbi fshat derdhej si me gjyme, me zemërim të madh, kurse në arë sa kaloi një vesë! Dhe ne e shihnim shiun që binte dhe nuk deshëm të futeshim nën retë e zeza, që mbulonin fshatin, prandaj mbetëm në arë deri në mbrëmje.. Dhe ti ahere the: — Pse s'na bën një zjarr, o Gimi, dhe të na pjekësh misra nga të personales, apo të vjen keq?

Dhe unë e bëra zjarrin, pastaj u ulëm të gjithë rrëth tij. Sa i bukur dukej zjarri në errësirë! Na u kujtuan lodrat e fëminisë. Dhe ti the: — Lozim me «mizë çalë»?

Dhe kur ktheheshim, rrugës, ti kishe ruajtur një misër të pjekur, të mbështjellë me lëpushka, në gji... E nxore, e theve më dysh dhe gjysmën ma dhe mua! Mban mend? Ja, që atë ditë, unë... Mirëpo, pastaj, ti u bëre brigadiere dhe mua budallait m'u duk sikur u rrite shumë...»

— Ç'mendohesh ashtu? — pyeti plaku.

— Hiç! Po Gimi ç'thotë? A ju shkruan?

— Jo, o i harruari! Një letër në muaj!

Hynë në rrugët e fshatit. Ajri ishte i lehtë... i lehta sa e ndjeje në flegrat e hundëve, bashkë me erën e mollëve. Kopshtet njëri pas tjetrit, të rrëthuar me shkorreta trëndaflesh të egra, dukeshin si grumbuj errësire. Pikonin kokrrat e krimbura dhe gërvishjes së ngjirrur të rrotave të qerres, që ishte e vetmja zhurmë e natës deri atje, iu shtua refreni fëshfërítës i kokrrave që pikonin «fësht.. puk.. fësht.. puk! «Nëpër rrugët u ndezën llambat, që dukej sikur dridheshin nga era e ftohtë e mbrëmjes.

«... Tani, po të shkruaj, Esma, se unë të dua! Po ndofta ti e kishe kuptuar! Se thonë që vajzat i njohin menjëherë djemtë që bien në dashuri me to! A është e vërtetë?..»

Xha Qenami habitej me heshtjen e brigadieres, që në mbledhje i priste goja brisk! Hetoi fytyrën e rru-mbullaktë të vajzës, po ishte errët, sytë i kishte të dobët nga pleqëria dhe nuk e kuptoi në kishte një brengë apo gjëzim.

«Nuk e di se si do të më shkruash ti! Unë e di që ti s'ja ke dhënë fjalën askujt, se ndryshe unë do ta dija! Po si ja çoni në brigadë? Babai më shkruan që gruri dha mirë. Këtu, në marinë, kemi një shoqëri që ju atje në fshat nuk e merrni dot me mend se si është. Them nganjëherë që ne në fshat, me grindjet tona të vogla, pëshpëritjet dhe sidomos me atë interesin e mëllékuar personal, nuk jemi tamam një kolektiv! Tjetër gjë ushtria! S'ka pësh-pëshe këtu! Unë kam mësuar shumë këtu, po ndofta më shumë se çdo gjë kam mësuar se çështë shoqëria, si duhet të mos e shohësh atë pronën tënde me synë e lakmitarit... Më shkruaj sa më parë. Shoku yt, Agimi».

— Pse s'flet, moj bijë?

— Ç'të them, xha Qenam?

— Mirë...mirë...si të duash. Prapë misrin do mbajmë nesër ne qerrtarët?

— Po!

— Unë po kthehem tani. Natën e mirë — tha plaku dhe hetoi prapë fytyrën e saj. Dëgjoi një pëshpëritje të butë, po prapë nuk e kuptoi dot ç'e mundonte ashtu vallë, gjëzimi apo brenga.

* * *

Po...ajo kishte atë mbrëmje gjëzime dhe brenga. Po lumtëria ishte aq e papritur, aq tronditëse, saqë e kishte zbuar brengën diku thellë, gjatë rrugës që bëri me plakun. Por, posa u duk tjetëpia e saj, prapa kopshtit të mollëve, dhe u dëgjua zëri i vrazhdë i babait nga ahuret, brenga ngriti kokën dhe e tulati lumtërinë e papritur. Shameti i hoqi samarin mushkës, e futi në ahur dhe i hodhi një vështrim të ngrysur së bijës.

— Shumë vonë u ktheve! Vetëm ishe?

— Vetëm!

— Si udhëtoke kështu natën? T'i kishe thënë Neshipit të vinte të të merrte!

— Nata më zuri afër arave, baba. Atje gjeta Qenamin me një qerre.

Nga qymezi i pulave u dha zëri i nënës, që e vështron:

— Pse nuk vishesh më trashë? Njëmijë herë të kam thënë!

— Dale, kur të marrë ndonjë të ftohur, do kujtohet!

— Pse, budallaqe ishim ne që mbanim tumane?

— Oh, nënë! Ç'e kujton kohën e baba Qemos! — tha ajo. — Po ti, baba, ku punove sot?

— Asgjëkundi. Më ngiste reumatizmi nga lagësira, ndaj mbajta ca plehë për pemët...

Esmaja nuk foli më. Babai hapi lesën e udhishtës dhe mori shtegun që të shpinte në pemëtore. Kishte daldisur kaq shumë pas pemëve tanë, sa më shumë plakej, sa të thoshe se férë dhemshurinë që nuk e derdhët dot gjetkë, se fëmijët i ishin rritur dhe nuk mund t'i përkëdhelte më, e kish shtirë në pemët. Ishte njeri krenar. Nuk e bënte veten, po i vinte shumë mirë që tamam Esmaja e tij dhe jo një tjetër ish bërë brigadiere. Mirë i vinte, dreqi ta hajë, le t'i urdhëronte të tjerët, po me babanë e saj.. hm.. duhej të sillej ndryshe, jo t'ja thoshte ashtu në sy, copë. Se fundja ai i kishte bërë kokën! Esmaja hyri në shtëpi. Vëllai, Neshipi, ishte shtrirë, kishte mbështetur këmbët pas sobsës dhe lexonte gazeten. Nuk i kishte nxjerrë çorapet e leshta që i kish gjithë këllirë nga balta e arës, prandaj në dhomë binte një erë e thartë.

— Nexho! — u inatos ajo! — Hiqi ato çorape!

— Hë, moj ti! Gjithnjë rregulla do të na vesh!

— Turp të kesh! Më je shtrirë si derrat në batak! Kështu bëhet higjienizimi a?

— Nise tanë si në konferencë? — qeshi vëllai dhe u ngriti.

— Dhe shko te pusi e lahu mirë, se ndryshe nuk

të qas në dhomë — iu kërcenua ajo. Në sobë kërciti një patate e pjekur. Padashur dora dhe sytë i vajtën në gji, ku ishte letra e Gimit. Nga djersa boja ishte shkrirë dhe ca shenjëza gushpellumbi i kishin mbetur mbi gjitë. Tërë gaz u vërvit nëpër dhomë, shkoi te shtrati i vet dhe e futi letrën nën jastëk. «Se mos ma gjen Nexhua dhe prit e dëgjo rrumuze pastaj!» — tha dhe e fshehu përséri në gjoks.

«Sonte do t'i shkruaj. Sonte! Kur këtu të kenë fjetur të gjithë». Vëllai, që ishte një vit më i vogël se ajo, u kthyte nga pusi, duke u dredhur nga të ftohtit!

— Br... Më fute plevitin... me rregullat e tua! Ku lahash dot me këtë të ftohtë? — Esmaja mori gjymtin me ujë të ngrohtë dhe vuri çorapet në legen.

— A e di, Nexho, — tha sikur i fliste vetes së vet.

— Sot, në kryesi folën prapë për bagëtitë e tepërtë. Duhet ta bindim babanë, se unë s'kam më sy e faqe të dal!

— Ke parë kokë Shameti ti, apo jo? Kollaj të duket a? Ja, sot më drekë, kish marrë mushkën dhe e hodhi gjithë plehun në pemëtore. Se kush i kish thënë që në Vrithas paskan marrë nisiativë t'ja falin plehun kooperativës dhe «o burra!» thotë me vete, «ta hedh në pemët e mia, sa pa ardhur këtu kjo remë!»

Ky shqetësim i ri, i papritur, e turbulloj më keq Esmanë.

«Dhe kur e bën babai këtë se! Një ditë më parë se ta bisedojmë në mbledhje të brigadës këtë nisiativë! Uh, baba! Nuk bën kështu!» tha me vete, sikur e qortonte.

— I lamë duart nga plehu — tha Nexhipi. — Më ta ka nxirë dheun me togje plehu që s'ke ku të shkelësh!

— Si nuk e ndalove ti?

— Le që unë vonë e mora vesh se ç'po bënte, po a ndalet ai a?

— Dëgjo! — tha Esmaja. — Deri nesër në mëngjez plehun duhet ta sjellim në plehrishten tonë! S'ka tjetër udhë kjo punë!

— Hm.. po eja e merru vesh me babanë.

— Do ta bindim!

— Demek, paskemi konferencë sonte?

— Ç'më qesh ashtu si viç i palëpirë? Për një vit shkon ushtar! Ti sonte të më bëhesh krah mua!

— Mirë, o mirë... — tha vëllai. — Që kur u bëre brigadiere, të hipin shpejt xhindet. Po s'kemi për t'ja kthyer mendjen, jo!

— Po ne plehun do ta sjellim! Ç'do të bëjë?

Darka shkoi në heshtje. Shameti dukej i mërzitur, i lodhur. Esmaja ishte e heshtur. Vetëm Nexhua seç murmuriste një këngë derisa iu shkreh Shameti: «Hë.. o bukën, o këngën!»

Dëgjoheshin trokitjet e lugëve pas misurëve.

— Ç'është kjo bukë e zezë? — u qa Shameti. — Do të urdhërosh të mos i hedhin më thekër të valosur, apo jo?

— Nuk urdhëroj unë për çdo gjë, baba!

— Po ahene pse je në kryesi? Populli ankohet. Pse i bëni ato mbledhje tërkuzë, kur nuk shihni ankesat e popullit?

— Nuk kam më sy e faqe të kritikoj njeri, në daç për bukën, në daç për gjë tjetër, baba. Sepse ne, familja jonë, s'jemi vetë në rregull me statutin.

— Hë, moj, se mos janë të tjerët më mirë! Lëri këto tani dhe shtrona të flemë! .

U shtri në këndin mbrapa sobës dhe dremiti. Esmaja kundroi fytyrën e menduar të tet. Një rrudhë e thellë i çante ballin më dysh. Flokët i kish të përhimë, sikur kishte mbetur mbi to hiri i zjarrit. Seç kishte një brengë të përhershme në fytyrën e babait, saqë ajo ndjente t'i ngrihej një ngashërim i mbytur nga gjoksi dhe atëhere nuk kishte më guxim ta qortonte! Po... kishte vuajtur shumë më parë babai. Dhe tani në i dhimbaj aq shumë çdo gjë e tij, kjo ndofta vinte se tërë jetën s'kishte pasur asgjë, veç dy krahëve! Dhe a i kishte hije vallë që ajo të qortonte babanë? Po sikur të bisedonte nesër me ndonjë shok të kryesisë dhe pastaj.. ata.. t'i flisin babait? Ë?

«Jo...» tha me vete Esmaja. «Çdo ditë që shkon, bëhet vonë.. Pse dashkam të m'i nxjerrin të tjerët

gështenjat nga zjarri? Babai do të më kuptojë.. Sot më pak, nesër më shumë...»

— E, pse nuk fol? — pëshpëriti vëllai.

— Ja, tani... — tha ajo. — Po nuk është aq lehtë..

— Ç'pëshpërisni ashtu? — pyeti nëna.

— Asgjë, nënë! Flasim pér plehun që hodhi babai sot! Si thua ti? Bëri mirë apo keq?

— Mirë a keq, është puna e tij. Ç'të duhet ty që përzjehesh?

— E, nënë! Sa prapa je! — tha Nexhua.

— Hesht, aty! Malukat! — u sha nëna.

— Baba... — tha Esmaja me një zë të ulët, të butë dhe mbështeti dorën e saj mbi grushtin e ashpër të tet...

— Ç'ke? — u përmend Shameti. — Na shtruat për të fjetur?

— Ja... tani — tha nëna.

— Unë desha të këshillohem me ty pér diçka — tha Esmaja.

— Tani e gjete ti, që po më ngjet reumatizmi? — tha ai, por kuptohej se i ardhi mirë dhe u përshkund si pér të hedhur tej gjumin.

— Hajde, nëma një cigare të mirë ti! — i tha Nexhos.

«Si t'ja filloj vallë!» pyeste vështrimi i shqetësuar i Esmasë. Babai e ndezi cigaretën dhe e thithi tymin thellë, si i babëzitur.

— A kanë nga duhani ynë këto cigare?

— Ku e di unë!

— Në fabrikë përzjejnë shumë lloje — tha Esmaja.

— Ashtu, ë? Ngreje zërin në kryesi të bëjnë një hangar në sektorin tonë!

— E thashë sot — tha Esmaja.

— Më të lumtë! Unë ta shtira në vesh, ama!

— Ti!

— Hë!. . — u krenua Shameti.

— Baba!. . Sot u diskutuan prapë shkeljet e statutit pér bagëtinë e tepert!

— Hë!. . S'paski punë tjetër ju, vetëm me këtë merreni?

— Nuk është mirë, baba, që në çdo mbledhje të më zënë në gojë për dy krerë dhen!

— Hë!.. Tani më s'më zënkan në gojë mua, që jam kreu këtu, po ty! Sikur të tjerët s'kanë!

— Ne duhet të japim shembullin, që të na pasojnë edhe të tjerët, baba! Se ka njerëz që mjafton të shohin një qime në shokët e kryesisë dhe pas saj të fshehin trarin e tyre!

— Pse nget larg? — tha vëllai. — S'të kujtohet pardje kur kritikonin Xhezon? Një, dy dhe: «O po ju ç'm'u qepët mua? Pse nuk shini nënkyetarin, ose shoqkën brigadiere?»

— Ku ka gojë Xhezua, more!

— Kishte, dhe brisk fare, bile!

— Rrini, more! Më plasët buzën për natë, për dy të shuara. Ja, t'i japidh të tjerët, pa do t'i japidh edhe unë!

— Ja, edhe sot me plehun...

— Ç'ke për të thënë për plehun, ti? — dhe i flaku paketën e cigareve.

— Nuk bëre mirë, baba, — tha Esmaja. — Ty të pëshpëritën për nisiativën dhe ti, hop, ja hodhe kopshtit! Ty të dhimbset shumë prona jote, të duket sikur kush e di se ç'do të humbësh, baba. A nuk do të hidhëj ky pleh në tokat tonë?

— Pse, mos bëra gjë të ndaluar a? Jo.. Plehun e kafshëve të mia e hodha në pemët e mia! Kaq!

— E keqja është se ti e hodhe meqë dëgjove se do të dorëzohej falas. Dhe hodhe aq shumë, sa nesër do të çuditën të gjithë...

— Demek ti, baba, përpëra interesit tënd, s'vë gjë tjetër!... —tha Nexhipi.

— Ama llafe, o! Them dhe unë llafe, një thes e një torbë. Po, kur vjen puna dhe shikon që të tjerët s'bëjnë si ty, a e ke provuar se si të djeg?

— Si do të pëshpërisin nesër, baba? «Ja, Shameti e mori vesh nga e bija dhe ja gjeti vendin plehut! E nxiu fare kopshtin e vet, se i vinte keq ta jepte për të mirën e të gjithëve!»

— Gjer aty qëparë, flisje bukur e mirë, tani po e bën beli që je aguridhe! Po doemos, s'të ka pikuar ndonjëherë shtëpia ty, se është babai këtu! Pse, ne do të jemi të parët në çdo gjë? Kështu u hodhe ti edhe për kopshtet, po kur u bë matja, na mbeten njëqind e ca metra më pak!

— Po të mos jemi të parët ne, që na ka zgjedhur populli të drejtojmë, kush të jetë, baba?

— Rri, moj aguridhe! Se mos bëjnë të gjithë si ty a? A nuk the aty më parë për nënkyretarin?

— Edhe ai shtrembër vepron.

— Shtrembër...shtrembër, po qumështi i rrjedh, ama!

Esmaja heshti. Nexhipi rrahu ajrin me shuplakë sikur deshi të thosh: «Është e kotë!»

«Po...» mendoi ajo. «Vështirë t'i kuptojnë menjëherë këta të vjetrit! Por do ta bindim... S'ka!»

— Shkoni të flini! — urdhëroi babai.

— Sonte nuk flemë! — tha duke qeshur Esmaja.

— Do të sjellim prapë plehun...

— Mos roitet gjë nga mendtë?

— A nuk u mendove se si do të thonë nesër në mbledhje?

Shameti u mbështet prapë. Dukej sikur dremiste. Po në të vërtetë në kokë i zienin mendimet:

«Do të thonë.. dreqi e mori.. Ca si Xhezua, halë duan...»

— Si thua, baba? A ta marrim mushkën?

— Mushka është e lodhur. Edhe ju shkoni flini, se di unë si të përgjigjem në mbledhje.

— S'ka gjë! — tha Esmaja. — Do ta sjellim në shpinë!

— Ah, më ju marrtë dreqi! Ç'më ndezi belaja me ca të krisur si ju! — tha babai. — Unë po shtrihem të fle... le që më ngat edhe reumatizmi! — dhe u ngrit rëndë-rëndë e shkoi nga dhoma.

Esmaja dhe Nexhipi veshën rrobat e punës e dolën jashtë. Morën koshat e plehut dhe gjembin e zbritën udhishtën për në kopsht.

Nata ish e zezë. Shushurinin fletët e mollëve. Mban-te erë mollë, erë tokë të lagur dhe pleh. Togjet e plehut si ca tumba varresh, ishin shpërndarë deri te gardhi.

— Shiko! — tha Nexhua. — Shiko se si duket kopshti, si varrezë!

— Mos folë marrëzira — tha Esmaja. — Eja të mbushim koshat. Deri në mëngjez duhet të kemi mbaruar.

— Mos i mbush kaq shumë se na dërmovë kurrizin — tha Nexhua.

— Ç'bën vallë babai tan? — tha Esmaja.

— Ç'të bëjë? Është kthyer në krahun tjetër dhe gérhet!

— Jo, s'është ashtu! Unë e di që është i shqetësuar!

— Ç'e pyet? Nuk e zë gjumi pér ne! Të bëhej merak ai, na jepte mushkën.

Nata mezi kalonte, e plogët, e gjatë. Koshat me plehë vozitnin mbi shpinat nëpër udhishtën drejt ahureve.

— Ah! O baba! Kërdinë paske bërë! — qahej Nexhua.

Afër mesnatës në udhishtën e kopshtit u duk një hije e gjatë.

— Shiko! — pëshpëriti Nexhua. — Babai!

— Shët..! Bëj sikur nuk e ke vënë re — tha Esmaja.

— Pse ashtu?

— Ndofta i vjen rëndë. Nuk e sheh se si fshihet nën errësirën e pemëve?

Hija e babait u afrua edhe më në heshtje, qëndroi një copë herë duke parë se si i mbushnin koshat, pastaj u kthye.

— Pse erdhi vallë? — pyeti Nexhua.

— Nuk i besohej se mund ta mbartnim gjithë plehun mbi shpinë!

— Po pse iku vallë?

— Ku ta dish? Mund të sjellë mushkën!

— Si thua, Esma? A i ndryshoi ndonjë fije mendja?

— Po! — tha Esmaja. — E di? Këta të vjetrit, si babai, janë shumë të ngatërruar. Ja, ndofta janë si ky druri i mollës. Shumicën e kokravë i ka të mira, po

ka edhe të krimbura. Vetëm se të krimburat i rrëzon më shpejt era... Kur të shkosh ushtar, atëhere do të të rrëzohen edhe ty disa kokrra të krimbura që ke! — qeshi ajo.

— Po ti ku e di?

— E di! — qeshi Esmaja. — Më shkruan i dashuri!

— Hy! s'ke turp! — tha Nexhua. Esmaja guisi nga kënaqësia dhe e qëlloi me një mollë të pikuar.

— A, o të humburit e derrit! — u dëgjua zëri i babait te gardhi. — Hem jeni fëmijë, hem ma kini këk si kjo mushka ime... — dhe ngriti koshin me duart e forta, mbi samarin e mushkës.

«KONTRABANDISTI»

Rrinin mbi tri arka të mëdha, të vjetra, që kishin zënë gjithë truallin e qilarit.

— Atëhere, duhet të thérresim «kontrabandistin» — tha «Rrobulli». Ky ishte pseudonimi i njërit prej udhëheqësve të njësiteve guerilje në qytet

— Nuk e kemi parë! — tha njëri prej korrierëve.

— Pas ngarkesës së fundit me cigare dhe proqë për partizanët grekë, s'ka nxjerrë gjë tjetër nga qyteti — tha tjetri.

— Kërkojeni në fshatrat malore, afër kufirit — tha «Rrobulli». Këto mund t'i nxjerrë jashtë vetëm ai — dhe tregoi me dorë të tri arkat.

Natën korrierët dolën nga qyteti i heshtur e i errët. Pas dy netësh, më të gdhirë, tre veta hynë në qytet. «Kontrabandisti» fjeti në një shtëpi të vogël, në një dhomë përdhese. Ishte një natë pranvere. Dhe pranvera e vakët ishte derdhur nëpër rrugicat e vjetra të qytetit si një shushurimë. Nëpër dritaren e ngushtë futtej era e ëmbël e junapit me gjethë të përhime si të vyshkura nga harxhimi i paprerë i aromës së luleve, që fëshférinin mbi tjegullat e çatisë të nxira nga vjetët. Nata ishte e qetë, sikur gjithshka e huaj dhe e potershme e luftës kish mbetur larg, diku, në një vend të harruar. Megjithëse ishte i lodhur, nuk i flihej. Junapi me erën e tij e shqetësonte. Edhe qyteti i dukej më i ndrydhur, i tulatur nën ankthin e pushtimit. Ai kishte ndenjur dy muaj maleve, me partizanët. Në male

kishte shkrirë dëbora e ftohtë... Posa hynë në qytet, kërkoi të mbetej vetëm. Vetëmia ishte e jashtëzakonshme për natyrën e tij të bujshme. Por... ai kishte ndejur dy muaj në male. Kishte parë shkrirjen e dëborës, nuk donte të shihte tani se si shkrihej e rëkellehej gurmazeve «kumeli» në kafe «Kristal», që ishte qendra e tij në qytet.

Ndofta për këtë arësy ai zgjodhi për të fjetur këtë shtëpizë të vjetër e të qetë. Muajt e fundit ishte lodhur shumë. Kishte bërë disa udhëtime që nga qyteti e deri në malet e ftohta të Gramozit dhe disa herë mendja e tij kishte trilluar truke, të pira të potershme, ahengje, ryshfete, deri sa malli kalonte në zonën e lirë.

... Po! Kjo kishte qenë detyra e tij në këtë luftë të madhe! Detyrë e çuditshme! Të vërtitej si një snob i gjëzuar e i shkujdesur midis armiqve! Dhe gjithshka kishte filluar papritur. Atëhere në qytet posa ishin dukur traktet e para, kurse në male, krismat e para të çetave. Ai s'pat menduar fare për luftën. Puna e tij e gjatë, si shegert në tregëtarë të mëdhenj, i solli lakinë e fitimit, të tregëtisë. Në fund fë fundit të gjithë përpara tij. E nisi me kontrabandë. Por në rrugën e dytë, duke shpënë grurë në kalibet e vllahve në Gramoz për ta këmbyer me djathë — punë që do t'i sillte fitime, — hasi partizanët. Kështu nisi një përbysje e madhe në gjithshka kishte besuar. Lufta ja shëmbi të gjitha ato që kish krijuar fantazia e tij e rrudhosur si një basmë e lirë.

Tani ishte prapë «kontrabandist»! Një «kontrabandist» i luftës së madhe qërimtare. Në qytet, të njojurit e tij të shumtë, me të cilët ai pinte e këndonte këngë të vjetra të përmallshme me një kitarë të madhe, që gjëmonte si xhaz, as që dyshonin kurrë se ky njeri ishte pikërisht ai ilegali misterioz, që kishte kaluar nën hundën e postbloqeve mallra nga më të rrezikshmet. Shkujhej se ishte një njeri, të cilil po i ecë tregëtia e jashtëzakonshme e sendeve të qmuara, me të cilën thoshte

se merrej prej disa vjetësh. E gjithë tregëtia e tij ishte në xhepet e mëdha të një kostumi sportiv bojë kaki. Mbante një kasketë me strehë të gjatë, këpucë lustrina të verdha dhe çorape me rombe të verdha, të kuqe, bojë hiri. Dukej sikur posa kishte dalë nga faqet e revistave të modës. I ri, i shëndetshëm, i pashëm, me flokë të zez dhe me vetulla të dendura, të rëna përmby dy sy bojë ulliri, me çehren e njeriut të kënaqur ngajeta, me humorin e mirë të gjithë njerëzve të qejfit dhe me zotësinë për të pirë shumë e pér të mos u dehur, ai ishte bërë shpirti i kafesë «Kristal». Zhdukjet mistérioze pér punë tregëtie dhe pastaj kthimet e tij me bujë ishin shumë të njoitura.

Hoqi rrrobat fshatare dhe veshi kostumin kaki.

«E ndërrova lëkurën» psherëtiu. «Tani duhet të ndërroj edhe gjuhën!» — dhe doli në rrugën, që të shpinte drejt qendrës së qytetit. Fshikulloi pulpët e veta, që ravizoheshin të plota e të forta nën çorapet, me një stap lajthie, të cilit i kishte gdhendur lëkurën me merak dhe nisi të vërvshëllejë një këngë të re. Doli në bulevard. Një femër, nga ato të shtëpisë publike, që kishte mbetur pa punë, e hëngri me sy një copë herë bukuroshin e panjohur. Ai pështyu. Femra gagariti si patë. U kthyte në «Kristal», që në atë orë mëngjezi ishte pothuaj i shkretë, piu një «kumel» dhe hyri prapë në-pér rrugicat tërthore.

* * *

U fut në një shtëpi të vogël, në një lagje të jashtme të qytetit. Rrugica ishte e shkretë. Plaku që i hapi derën, e shikoi me dyshim njeriun e pispillosur, por ai e tha mirë parullën. E zbritën nëpér një palë shkallë të ngushta në një qilar të shtruar me plloça të mëdha. Ishte ftohtë. Ai s'kishte pasur të bënte më parë me shokun «Rrobulli». E kishte parë vetëm një herë këtë burrë të zbetë ngajeta e nëndheshme e qilareve, ku kishte fjetur net të tëra.

— Prit këtu! — tha plaku.

«Do të jetë një punë e madhe, posa që më kërkon ai» — mendoi. Në bodrum zbriti një njeri. Ai u çua. — Vdekje fashizmit, «kontrabandist», — tha ai. Dukë edhe më i zbetë në dritën e një qiriri të vënë në një shandan.

— Liri popullit, shoku «Rrobulli»! — tha ai dhe u ngrit në këmbë.

— Ulu... ulu... — foli tjetri dhe afroi një karrigë pranë shtratit, ku ish ulur ai. Paske pirë «kumel»!

— Kështu e ka puna ime! — u turbullua «kontrabandisti».

— E di... — pshërëtiu ai. — Një punë prej... artisti. Gjithnjë duhet të vësh nga një maskë.

— Nuk e kam aq të zorshme! Kam punuar shegert nëpër tregëtarë unë!

— Pas çlirimt, ti ndofta do të bëhesh aktor. Do të kemi shumë nevojë për njerëz të artit, atëhere. Ku mund të gjenin rrugë talentet në këtë botë të mykur që po përmbysim?

«Kontrabandisti» qeshi. Ai s'para i mendonte këto. Rronte me të sotmen dhe s'kish menduar kurrë se ç'do të bënte nesër, kur të kish ardhur dita e madhe e lirisë!

«Çudi! Pse mendon kështu ai? Ë? Po sikur... sikur... shoku «Rrobulli» të kishte të drejtë?», thoshte me vete.

Jashtë ishte po ajo qetësi e vakët e lagjeve të varfëra dhe derdhej po ajo erë junapi.

— Kemi një detyrë të re për ty — tha «Rrobulli» me zë të ulët. — Nuk është puna as për shollë, as për proqe. Kjo ndofta do të jetë puna më e madhe që mund të bësh ti për luftën tanë! Një detyrë të tillë ti nuk e ke pasur kurrë dhe s'besoj ta kesh më tej. Gjermanët po gremisen!

Ai vështroi fytyrën e zbetë të «Rrobullet». Një ngërç i mërzitshëm i kish pushtuar këmbët nga ftotësia e qilarit!

«Si ka mundur të jetojë kaq kohë qilareve?» mendoi.

— Do tē nxjerrësh jashtë qytetit, deri nē katundin B., tri arka tē mëdha. Brenda tyre është e gjithë shtypshkronja e vogël «Teuta». Ti ke dëgjuar pér këtë?

— Po!

— Ajo tani është jona. Shtypshkronja i duhet shtabit. Ke një ditë kohë tē mendohesh e tē bësh planin. Nësër, nē orën 11, nē kafe «Berlin», do t'ju takojë një shok, që do tē thotë: «Keni një seri fotografi tē Greta Garbos?». Ju do ta ndiqni pas dhe ai do t'ju sjellë tek unë nē një bazë tjetër. Atje do më tregoni planin tuaj — tha «Rroballi». Ai heshti. «Kontrabandistit» nuk po i shkonte ngërçi.

— A nuk keni pér tē thënë diçka?

— Jo — tha ai. — Nesër mbrëma! — dhe u ngrit me mundim nga shtrati. E, posa u ngrit, edhe ngërçi sikur mbeti nē qilarin e vjetër. Nxitoi.

Zuri një dhomë nē hotelin «Venecia» dhe u shtri nē shtratin e gjerë. Mbylli sytë dhe përfytyroi gjithë jetën e tij.

«Tri arka tē rënda... tri arka tē rënda deri nē B. Kjo punë ndryshon nga tē tjerat».

E solli ndër mend këtë fshat. Fshati B. dukej si-kur nuk i interesonte askujt. Ai ishte atje, rrëzë kodrës dhe kundrejt qytetit, si një njollë e blerët nē sfondin e përhimë tē skërkave shterpë. Një rrugë automobili e ngushtë dhe gati e braktisur, ku nuk shkonin pothuajse fare maqinat, ndahet nga xhadeja e K. Një shteg tjetër, më i afërt, dredhonte nëpër grunore rrëzë kodrës.

«Tri arka tē rënda... tri arka tē rënda deri nē B.» i rrihte nē krye si çekan ky mendim, që kur kishte dalë nga shtëpia e vajisur nē periferi. «Kafshët këtu s'më hyjnë më nē punë. Duhet një maqinë... një maqinë!»

Përfytyroi edhe një herë gjithë rrugën deri nē B. «Dymbëdhjetë kilometra. Shtatë prej tyre kalojnë nē xhadënë e madhe. Në kilometrin 2 është postbloku. Pesëqind metra pas tij kthehet shtegu rrëzë kodrës. Në kilometrin 7 kthehet rruga drejt B. Vështirë tē kalojnë dy maqina nē atë rrugë!.. Në kilometrin 2 postbloku. Në

kilometrin 7 rruga. Si janë pesë kilometrat e tjera? Po sikur të ketë ura të rrëzuara?»

Me ngulm truri i tij po e kthjellonte amullinë. Kështu i ndodhët gjithmonë. Duhej të gjente fillin e punës, pastaj bishtin. Ja, tani, mendimi i tij u përqëndrua vetëm te kontrolli i rrugës. Duhej zgjidhur më parë kjo e panjohur. Të tjerat më vonë.

Një orë më vonë, bashkë me dy fshatarë, kaloi postblokun i hipur në një mushkë. Roja vërejti një copë herë se si lëkundëj mbi mushkë në mënyrë qesharake fshatari i fundit, një alamet djali korrozi. Tringëllima e zileve të vogla nuk iu nda nga ndëgjimi. Roja shau. Ata të tre u zhdukën prapa kthesës. Një veturë e zezë i kaloi me zhurmë. Duke u kthyer pas dy orësh nëpër shtegun rrëzë kodrës, ai nisi të mendojë pér maqinën. Shkoi nëpër mendje të gjitha kamionçinat e shoqërive private. Dhe të gjitha truri i tij i rrëzonët si të pamundshme. Më në fund mbeti ajo e Xhavit Dokut. Po edhe ky kishte bërë ortak një ballist me damkë, Daut Qosen.

Po afrohej mbrëmja. Ai nxitoi nëpër rrugicat e qytetit, veshi kostumin kaki dhe u drejtua pér në «Kristal». Në «Kristal» s'kishe ku të hidhje mollën. Hetoi një copë herë me sy, por nuk e pa Xhavitin. Pa orën. «Kam ardhur shumë shpejt» mendoi dhe kërkoi një tryezë të lirë. Ca të njobur e ftuan të ulej me ta, duke shpresuar gjësendi nga ai si dorëshpuar me nam; po këtë herë ai i gostiti vetëm me nga një buzëqeshje. Hyri në rruginën, ku pronari kishte ndarë me perde ca llozha pér dashnorët dhe bisedat që s'ishin pér veshë të huaja. Nëpër hapësirën që lejonin perdet, pa një kokë të shogët. Ishte koka e Xhavitit. Zboku i bardhë mbi jakën e zezë të xhaketës dukej si një grumbull thëria.

— Mirëmbërëma, o sipërmarrës i madh! — tha ai duke vënë dorën në zemër me një përkulje teatrale.

— Mos pret ndonjë dashnore në këtë vend të fshehtë?

— Ah!... — psherëtiu Xhaviti. — Urdhëro, zoti Ramadan. Unë pres ortakun, Dautin. — Ai u ul në një

kolltuk. Fytyra e Xhavitit iu duk e prishur, sikur i rëndonte mbi faqet buçka një brengë e një mërzitje e gjatë.

— Ç'do të pish?

— «Kumel».

— Unë pi vetëm «Kianti» — tha Xhaviti. — Po sonte po e kthej një herë për hatrin tënd.

— Nuk të kanë shkuar punët mirë?

— Për dreq! Pér dreq!

— Sipërmarrja juaj ishte me famë! Si kështu?

— Ah!. Sipërmarrja! Më mori më qafë Dauti. E shkriva kapitalin. Tani puna u myll. Gjermanët pa-guajnë pak!

— Ku e ke ortakun?

— Kush dreqi e di? Me ata trimat e vet të Ballit.

Pinin në heshtje. Në përgjithësi në gjithë lokalin sikur sundonte një heshtje e vrenjtur, si një qetësi para furtunës. Gjermanët nuk para vinin këtu. Ramadani ngriti perden nga ana e rrugës dhe vështroi në bulevard. Nxitonin kalimtarë me fytyra të ngrysura. Gjithshka nxitohej. Vetëm këtu brendajeta kishte mbe-tur pezull, si e varur në pendulin e orës së prishur të murit. Befas në hyrje u bë potere. Hynë gjashtë a shtatë ballistë të dehur. Në krye fare shquhej fytyra e gjerë si prej demi e Dautit.

— Të erdhi ortaku! — tha Danka.

Xhaviti psherëtiu i murrëtyer. Njeriu me fytyrë prej demi, të nxirë e të fryrë nga të pirët, me dy sy të vegjël si të shpuar me bosht nën ballin e gjerë, po bënte potere duke kërkuar një tryezë të lirë. Sytë i vërtiteshin si në ethe. Qeleshja e bardhë me një shkabë të madhe i kishte vajtur shtrembër, kurse nën kostumin prj kazmiri të zi dukej një gjerdan me fishekë.

«Këtë gomar të ngjallur duhet ta heqim nga skena!» mendoi ai.

Dauti hyri në rruginën ku ishin llozhat për çifte. Sytë i panë këmbët e ndërthurura të një burri e të një gruaje.

— Shih!.. shih! — thirri. — Janë kokolepsur!

Këmbët u larguan me zhurmë. Dauti ngriti perden. Djaloshi, një thatuq mustaqespicë, seç cuçuriti dhe u tulat në qoshe të llozhës, kurse femra, një nga ato të shtëpisë publike, shpalosi një gojë të gjerë, që dinte të buzëqeshte me dashamirësi.

— Hy... gremisuni që këtu... kurvarë! — bërtiti Dauti.

— Pse nuk e fton? — pyeti Ramadani.

Xhaviti nuk foli, po hapi perden dhe i bëri një shenjë. Dauti hyri. Vështrimi i tij, që të shponte si tryelë, u ndesh me vështrimin e qetë dhe hokatar të Ramadanit. Ky u ngrit, i hodhi dy duart në qafë dhe e puthi me zhurmë në të dy faqet. Një erë e rëndë parfumi dhe alkooli i mbeti në buzë.

— Paske marrë huqet e atyre zuzarëve — tha Dauti. — Ç'më nduk kështu?

— Oj? Miku i vjetër! Unë të kërkoja në qzell dhe të gjeta këtu! Kam kaq kohë pa pirë një gotë me ty. Po eja, eja!

Ortakët i ndenjën njëri-tjetrit si njerëz të zemëruar. Dauti ishte një njeri i vrazhdë, krenar kundrejt Xhavittit të shkretë, që ishte fare i rënë shpirtërisht dhe e shihte ortakun e vet me një farë lutje të fshehur, sikur e pyeste:

«Si do të bëjmë më tej?»

— Ah! Ore miq! psherëtiu Ramadani. të cilit po i ngjitej gjendja e tyre e zymtë. — Ju jeni më të vjetër se unë në moshë, po më të rinj në tregëti. Nuk duhet të dëshpëroheni kështu...

— Kollaj e ke ti, se i ke xhepet të ngrohta... — tha Xhaviti.

— Xhaviti deshi të fitonte me thes! — tha Dauti.

— Pse nuk merrni sipërmarrje rrugët e tjera?

— I kanë marrë të tjérë!

— He... he... — qeshi Ramadani. — Juve tanë ju leverdis që partizanët të prishin ndonjë urë që të hapet punë për sipërmarrjen tuaj.

— Ta pret mendja!

— Pse s'u bëni një letër? — qeshi ai duke hetuar fytyrën e madhe të Dautit. Por në atë fytyrë s'kuptohej asgjë. Xhaviti dukej i përgjumur, sikur s'dëgjonte fare. Por ishte pikërisht ai që pëshpëriti:

— Mos bëni shakara të tilla, ju lutem. Këto janë me zarar!

— Nuk pjerdhim ne prej këtyre gjërave — tha Dauti. — Ata derra kanë nisur të mos i ngasin më rru-gët dhe urat.

— Ndofta i ruajnë për vete. Siç duken bathët, gjermanët mund të ikin dhe ata do të fitojnë!

— Do të fitojnë andej nga qenefi! Do të mbetemi zotër ne... More vesh? — tha me nxitim Dauti.

— Sikur mua m'u dogj barku të fitojnë komunistët. Thonë se ata nuk lënë asgjë private.

— Zotérinj! — pëshpëriti Xhaviti. — Unë s'mund të dëgjoj më. Do të largohem!

— Rri, pordhaman! — tha Dauti. — Po largohem unë se më presin shokët.

— Mund të kisha një punë tregëtie me ty — tha Ramadani.

— Hë! — tha Dauti dhe nga gjoksi i doli një zë i çjerrë si gajde.

— Sa i nxituar je! Është fjala për pasnesër, në mbrëmje, në orën shtatë. Duhet të jesh i përpiktë.

— Zor të jem i përpiktë — tha Dauti. — Këtij roskopit tim i ka perënduar ylli me kohë — tha dhe lakoimi me sy orën «Omega», që dukej në dorën e Ramadanit.

— Po të jap një nga «Omegat» e mia, që i kam për të shitur. Atë ditë ma kthe!

— Mos u bëj merak! — tha Dauti dhe u largua.

— Pse ja dhe orën? Ta treti ai! — pëshpëriti Xhaviti.

— Ç'thua?

— Ta treti! Ndonjë javë s'ka për të të dalë në sy. Pastaj do të bëhet si budalla ose do të të kërcënojë. Sonte ti fole shumë gjëra të rrezikshme, zoti Ramadan!

— Ndofta. Unë nuk jam frikacak, zoti Xhavit.

— As unë!

— Al!.. Ti je! Pse u bëre ortak me një njeri të tillë?

— E dini edhe këtë?

— E di! Dikur, kur shitje vogëlsira, bëre një dallavere të vogël dhe këtë e dinte Dauti, që atëhere ishte milic. Pastaj, kur u ngrite, t'u qep pas si shushunjë. Unë di shumë gjëra!

— Jo nga frika për vete... jo! Unë kam gjashtë fëmijë. Nga kjo luftë duhet të shkas si ngjalë nëpër shumë ujëra, që të shpëtoj, qoftë edhe sikur të jem lidhur me dreqin vetë!

— Edhe të tjerët kanë fëmijë. Mos harro se, pas luftës, të kërkojnë hesap, sikur të fitojnë ata.

— E di...

— Ti s'duhej të ishe lidhur me Dautin. Ai është me damkë!

— Të thashë, zoti Ramadan. Nga e keqja.

— Kam për ty një punë. Një punë me fitim!

— Për mua?

— Po! Më duhet kamioni yt deri në qytetin K.

— Ç'do të shpriesh?

— Nja tri arka. Proqe, gozhdë, shollë. Atje ja shes një mikut tim!

— Hm... Punë me kokë në torbë! — belbëzoi Xhaviti.

— Po të zunë me to!..

— Ti nuk do të vish!

— Po kamioni do të vijë, ama! E ç'i do ai miku proqet?

— Nuk e di. Ç'më hyn mua në qese kjo?

— Se ndofta bën allishverish me partizanët grekë!

— Mundet. Tregëtia s'ka të bëjë me politikën...

— Eh... S'është tamam ashtu. Po eja të dalim që këtu, zoti Ramadan. Këtu kanë edhe muret veshë!

Jashtë po errej fare. Kalimtarët e rrallë nxitonin të futeshin nëpër dyer. U afroan te hoteli «Venecia». Në xhade kërcitën hapat e rënda të patrullave.

— Ti je një njeri i çuditshëm, që di shumë gjëra!

— tha Xhaviti. — A vjen ta kalosh natën në shtëpinë time?

— Jo!.. A tē kontrollojnë ty nē postblok?

— Kontollojnë nganjëherë... megjithëse e dinë se punojmë pér ta dhe mbartim qereste ose zhavorr.

— Mendohu. Nesër ti do tē vish nē «Venecia» — tha Ramadani.

— Medoemos?

— Po! Ti e the vetë! Unë di shumë gjëra pér ty. E di bile që, njëherë, nga frika ke dhënë ndihmë pér partizanët!...

— Do tē vij!... — pshëretiu Xhaviti.

* * *

Dukej sikur gjithshka ishte menduar deri nē hollësitë më tē vogla. Xhaviti, i trembur deri nē kockë, pranoi tē japë kamionin, duke kujtar se shpinte një ngarkesë tregëtare. Një korriger duhej tē shpinte një urdhër pér prishjen e dy urave tē vogla nē rrugën e K. Pas prishjes së urave kamionci i sipërmarrjes «Shpre-sa» do tē ngarkohej me trarë e me dërrasa. Nën trarët do tē ishin tri arkat. Duheshin gjetur edhe një gjashtë punëtorë. Në kthesën e xhadesë pér nē fshatin B., nē kilometrin 7, «kontrabandisti» do ta detyronte Xhavit Dokun që duhej marrë me çdo kusht nē kamion, që tē kthehej nga rruga kryesore. Arkat do tē shkarkoheshin nē B. dhe do tē merreshin nga njësiti territorial.

«Rrobulli» u mendua.

— Po... e rrezikshme, si çdo gjë tjetër nē këtë luftë! — tha.

«Kontrabandisti» nuk foli.

— Po sikur tē bëjnë një kontroll tē imtë nē post-blok? — pyeti «Rrobulli».

— Atëhere... — tha «kontrabandisti» — do tē ishte vdekje. Ne e kemi atë kurdoherë pranë shtratatit, që kur nisëm këtë luftë.

— Jo! — tha «Rrobulli». — Nuk duhet tē vdesim tan! Me ty do tē vijnë edhe gjashtë shokë, punëtorë, që

do tē t'i jap unë. Ju duhet tē çani medoemos këtë herë!

Të nesërmen herët ai u paraqit pér kamionin. Shoferi, një njeri i gjatë, që dukej sikur nuk do ta nxinte kabina, e futi me shpejtësi maqinën nëpër rrugicë, deri te shtëpia e vogël në periferi. Arkat u ngarkuan. Pastaj kamioni dredhoi deri në depon e shoqërisë «Shpresa», ku do tē ngarkohej me dërrasa. Nja gjashtë punëtorë, vashkë me dy ustallarët e shoqërisë, ngarkuan trarët e dërrasat dhe i mbuluan arkat me to. Xhaviti vërtitej mbi dy këmbët e trasha si fugë dhe këqyrte përtej derës me frikë. Më në fund maqina u ngarkua dhe punëtorët, djem tē rinj, tē çuditshëm që ai s'i kishte parë kurrë, morën nga depua kazma e lopata dhe u ulën tē shkujdesur mbi dogramatë. Edhe tē dy ustallarët, që ishin mësuar tē punojnë me punëtorë tē tjerë, ishin tē shqetësuar nga fytyrat e reja e tē panjohura.

— Ku na i mblodhe këta punëtorë, zoti Ramadan? Unë nuk i njoh! — tha Xhaviti.

— I njoh unë — tha prerë ai. — Tani, eja tē hipim përpara tē dy dhe tē nisemi.

— Ç'thua kështu, zoti Ramadan? Unë s'vij sikur me kanxhë tē më heqësh! Nuk e kemi kështu fjalën.

— Dëgjo, tē marrtë dreqi! — tha me zë tē ashpër ai. — Tani e kemi çdo minutë tē shtrenjtë dhe s'kemi kohë pér dokrra. Ti do tē vish me ne sepse në postblok tē njojin dhe tē kanë parë shumë herë. Kështu, besoj se nuk do tē kontrollojnë!

— Po sikur tē kontrollojnë?

— E kam menduar edhe këtë, po hip!

— Jo, unë dua tē kem siguri! Në i gjecin proqet, mos tē tē gënjejë mendja se gjermanët do ta hanë sapunin pér djathë! Atëhere unë i pari e kam plumbin në kokë!

— Në luftë tē gjithë e kanë kokën në torbë — tha ai.

Njëri prej punëtorëve, një burrë si nja tridhjetë vjeç, shpatullgjerë, seç bëri një shenjë nervoze dhe Xhaviti e ndjeu se Ramadani pothuaj po e shtynte me pahir në kabinë.

Kamioni u nis me uturimë e duke nxjerrë një re

të zezë tymi, dhe doli në xhade. Qyteti mbeti prapa. Fërpara shtrihej xhadeja e gjerë, e zhveshur. Ja, u duk edhe druri i ngritur i postblokut, si një gojë e hapur, që do të kafshonte xhadënë, u duk edhe ndërtesa e vogël përbri me muret e lyera me bojën e zhabave. Maqina frenoi. «Kontrabandisti» pa në pasqyrë fytyrën e zverdhur të Xhavitit, si fytyrë meiti. Shoferi i gjatë vërtiste nëpër gojë një cigare të shuar prej kohe duke e thithur me gulçimë.

— Mblidhe veten! — tha Ramadani. — Dhe dil nga kabina që të të shohë roja.

Lart punëtorët bënin potere me kazmat, që i përplasnin nëpër dërrasa. Xhaviti nxori trupin përgjysmë. Roja futi kokën në kabinë, pastaj hipi mbi rrotë menagadalë, vështroi punëtorët, që kishin pushuar së rënë dërrasave të hedhura pa kujdes. Xhaviti belbëzoi duke rrahuar ajrin si epileptik, mezi e gjeti dhe mezi e nxori lejen e komandës gjermane për shoqërinë «Shpresa». Roja e vërejti, sikur e lexonte gërmë përgjysmë shkresën, ku thuhej se lejohej sipërmarrja të ndreqte rrugët e urat, pastaj zbriti dhe i bëri një shenjë rojës, që qëndronte te druri. Goja e drunjë e rrugës u hap dhe kampioni kaloi në të, duke lënë pas një fjollë të bardhë tymi, që u vërtit një copë herë mbi ndërtesën bojë zhabe.

Postbloku mbeti prapa një kthese, xhadeja ra në një vend të pjerrët dhe për një çast qyteti hymbi nga sytë.


«Kontrabandisti» pshëreti si i lehtësuar nga një barrë e rëndë. Rrugës i kaluan dy motoçikleta. Në largësi u duk kthesa. Rruga e ngushtë e B. ndahej nga xhadeja si një degëz e mjerë e një lumi të madh. Xhavtit iu kthyte të kuqtë e fytyrës.

— Ti më the se do të shkarkosh rrugës, apo jo? Se në K. ka një postblok tjetër — tha ai.

— Mos ki dert! Do të shkarkojmë në një vend të sigurt, afër! Tani do të kthehem i në rrugën e B.

— Si? — tha Xhaviti. — Këtë rrugë nuk e njoh! S'e kemi kështu fjalën!

— Këtu urdhëroj unë — tha «Kontrabandisti». — Kthehu!



Kontrabandisti

— Nuk e dimë as se si është rruga — tha shoferi, indiferent, duke vërtitur në gojë po atë bisht të shuar cigareje.

— Rruga është e mirë!

— Po sikur të ketë ndonjë urëz të prishur?

— Nuk ka!

— Kjo është e rrezikshme, zoti Ramadan. E panojhura është gjithnjë e rrezikshme! — belbëzoi Xhaviti.

— Kthehuni tani dhe lërini fjalët! — tha ai.

Maqina u kthyte në xhadënë tërë gropat e fshatit B. Pas gjysmë ore maqina qëndroi. Njëri prej punëtorëve, ai më i vjetri, që hiqej si carpenter, tregoi vendin ku duhej shkarkuar. Se nga doli një grup njerëzish të armatosur. Xhaviti u pa yjet e kuq mbi kapelë dhe u drodh.

— Zoti Ramadan! — tha. — Nuk më thua, sikur të na zbulonin, c'do të bëje atëhere?

— Do të sulmonim! — qeshi ai.

— C'janë këto shakara.

— Mund të ndodhët edhe ashtu. Punëtorët janë njerëzit tanë. Duhej të çanim medoemos.

— Kaq të rëndësishme janë këto proqe?

— Shumë!

Xhaviti heshti dhe vështroi shkarkimin e arkave. Arkat po shkallmoheshin. Pastaj ngarkesa, në shpinë, u nis drejt maleve.

— Dëgjo — tha befas Ramadani. — Sot, ti, padashur, me kokë e me këmbë hyre në luftën tonë. Tani s'ka më rrugë të mesme për ty... S'ka më tregëti. Ose do të na shërbesh neve... ose... Ngarkesa që sollëm bashkë, ishte shtypshkronja «Teuta»!

— Si? — klithi me tmerr Xhaviti. — Më paske marrë më qafë, zoti Ramadan!

— Jo! Të shpëtova — tha ai. — Ti po bije në një greminë dhe unë, nga një rastësi, të shpëtova. Paskëtaj, ndofta, do të bëjmë edhe punë të tjera me kamionin tënd. Tani, eja të kthehemë në qytet!

NJË NATË SHIU

Më kujtohet një natë. Duhet të ketë qenë vjeshta e viti 1952. Ishim në tokat e ish-kënetës. Në mes të tokave të zeza ngrihej një barakë e madhe, që natën ngjante me një pëlburë të bardhë të nderur në mes të hapësirës së murme. Përpara saj vendi ishte i zbrazët. Deri në këmbë të kodrave toka e zezë kishte hapur gjinë dhe lahej nën shiun e ngrohtë të vjeshtës së parë. Mbrapa saj regëtinin dritat e mekura të llambave në shtëpitë e vogla të fermës, të mbështetura në kurriz të njëra-tjetrës, si për t'u mbrojtur nga erërat e kënetës. Në brinjët e lagura e të zhveshura të Malit të Thatë, që shtrihej si brez i murmë përtej fushës, ca zjarre të natës lëpinin me gjuhët e tyre shkrumbin e natës, që po binte: Një si mjegull dridhej mbi mal e mbi ziarret dhe sepse të dukej se kjo mjegull s'ishte gjë tjetër veç avulli i gunave të barinjve, që thaheshin pas zjarreve.

Shiu posa pushoi. Shiu i lau zhurmat dhe mugëtira solli me vete një heshtje të gjatë, ashtu sic mund të jetë heshtja vetëm në një hapësirë të gjerë fushe.

Baraka, që ishte fjetorja jonë, një sallë e hallakatur; në të cilën kishim shtruar kashtë, gumëzhinte saqë dridheshin xhamet dhe binin pezhishkat e merimangave që mbulonin tavanin. Një çangë, me një vrazhdësi metlike, e ndërpren zhurmën brenda fjetores, ku na kishte mbyllur shiu.

— Ej! Dilni! Shiu ka pushuar!

— Do të ndahet gjella!

Nga dera rrëshqitën në errësirë, si hije, trupat që

e hodhën poshtë plogështinë posa dëgjuan çangën e bukës. Lëvizëm me ngut, duke shtyrë e duke qeshur. Kush i jetoi ditët e vrullshme të aksioneve, të mëdha ose fare të vogla, si ky ku ishim ne, dhe nuk e kujton atë goditje çange që thërriste për darkë?

Megjithëse ne kishim ardhur këtu vetëm për një javë, për të ndihmuar fermën në mbledhjen e paxharit dhe megjithëse kishim pas edhe të gjithë profesorët (ashtu u thoshim ne atëhere, në vitin jo aq të largët 1952), tingujt e saj i prisnim si zilen e xha Gaqit në orën e matematikës.

Në krye të grumbullit me gaveta në duar, doli një djalë i gjatë kaçurrel. Fliste ngadalë, sa të mërziste dhe dukej që ishte fshatar. Shtyu dikë me bërryl, u mundua të vërë rregull dhe tha:

— Mbani radhën! Pse kërkon të marrësh gjithnjë i pari ti, Ilia?

Ky ishte Tahiri. Më i madhi në moshë në klasat tona të dyta. Bile ai ishte më i madh edhe se maturantët, sepse e kishte lënë shkollën disa vjet. Ishte edhe nga të paktët fshatarë në shkollën tonë. Ndofta sepse ishte më i madh ose sepse dinte më shumë se të gjithë nga bujqësia, na e patën vënë komandant. Ai edhe Ilia, që ne i thoshim «Grande», (se, kush nuk pati njënofkë në Korçë?) ish'n të vetmit që rruhesh'in.

U mbështetëm të gjithë pas murit, nën strehët e gjera të fjetores, e filluam të hamë. Qielli ishte dyndur më poshtë, i rëndë e i mërzitur sikur donte të shkundte supet e lagura mbi kodrat përtëj. Në xhade shkisnin mbi asfalt dritat e verdha të maqinave. Ai që përtonte të shkonte të lante gavetën, e fshinte me bukë.

— Kush nuk e ka marrë darkën? — pyeti Tahiri.

— Vetëm Sigfridi. Ka shkuar në fermë.

— Do të blente dicka në dyqan!

— Djalë doktori ai! S'e kapërcen dot çajin me bukë të zezë!

— I ka dhënë babaka para kur u nisëm!

— Sikur do të tretej në një javë!

— Pse merrni nëpër gojë të tjerët? I kini zili a? — tha Grandeja.

— Hajde! Grande — shoqëria! I doli krah!

— Si të mos i dalë? I jep biskota Sigfridi!

— Qelepirxhiu i djallit! Shiko sa tu rrit barku këto ditë nga biskotat e Sigfridit!

— Çaj kokën unë pér biskota! Unë, si të thuash, e mbroj pér hatër të shoqërisë që kam pasur me të që kur ishim të vegjël!

Ra heshtje. U dëgjua fëshfërima e kallmeve të ngjeshura pas tokës. Dikur ato ishin të vetmet bimë të kënetës.

— Eh! Sikur të bjerë edhe nesër, të shpëtojmë! Pastaj edhe një ditë na mbetet!

— Dembel i madh je, o Grande! Pse erdhe këtu atëhere?

— Tjetër punë ajo! Kur vjen e gjithë shkolla, bile edhe profesorët, unë veç të rri? Të më merrte me sy të lig drejtoria?

— Unë nuk u ngopa!

— Më mirë! Do të flesh lehtë. Natën s'duhet të hash shumë!

— S'të paskemi ditur që je edhe si punë mjekut! Mësim do të na bësh?

— Kush nuk u ngop, ore? Maqua? Ai do një furre! Le t'i janë Grandeja diathin e Sigfridit!

— Po vien Sigfridi! Mos ja merrni racionin!

Hija e Sigfridit u afrua ngadalë. Ishte errët, prandaj dukej i bëshëm e shpatullgjerë, kurse në të vërtetë ishte i dobët sikur ushqehei me cironka. Pantallonat i kish përveshur dhe kish mbuluar qafën me jakën e xhakaventos.

— Kush ma mori giellën mua? — pyeti Sigfridi.

— Sa një kërpudhë është dreqi, po mendjen në të ngrënë e ka!

— Ka vrilokokun në bark!

— Ja gaveta jote — tha Grandeja. — E mora nga fjetorja.

U err fare. Zjarret atje larg i hapën edhe më sytë e tyre dhe në lindje u shqua një brez i tërë drithash, Ishte vezullimi i qytetit. Nga dhoma e vogël përbri fje-

tores sonë dolën mësuesit. Në krye ecte kujdestari ynë, që pengohej shpesh. Me siguri vazhdonte bisedën e përditshme me profesorin e shkurtër të biologjisë mbi Shekspirin. Mësuesi i biologjisë çmon më shumë Gëten se ishte edhe naturalist dhe kjo e inatos gjithnjë kujdestarin tonë.

— Dëgjo! tha kujdestari. — Po të recitoj nga «Mekbet»: (Eh! C'hoqëm gjersa e mësuam ta lexojmë «Mekbet» dhe jo «Makbeth»).

«Mekbet! Mekbet! Mekbet!..»

« Jam vesh i tërë dhe të dëgjoj!... e kuption sa e fuqishme, sa e pakrahasueshme, sa e....

Zëri i tij humbi nga basi i thellë i mësuesit të biologjisë. Erdhi nga kuzhina edhe Sigfridi e ja nisi të njomë biskotat me çaj.

— Ku shkoi Ilua? — pyeti.

— Në kuzhinë, se mos mbetej ndopak çaj. Na porositi t'i lesh biskota!

— Ore! Po ku e ke marmalatën ti? — tha Tahiri. Dikush bëri të qeshë, po Tahiri e shpoi me bërryl dhe gazi i mbeti në buzë.

— Nuk më dha! Pse, kishte? — tha Sigfridi dhe sytë i shkëlqyen në errësirë.

— Kishte!

— Do të ketë harruar!

— Ta hodhi kuzhinieri, o i gjorë! Të di ty që të ka dhënë babaka para dhe e ha vetë!

— Kjo është padrejtësi — tha Tahiri. — Duhet t'ja kërkosh, ndryshe do të të heqë për leshko! Sigfridi u nis me nxitim drejt kuzhinës, kurse ne, pas tij.

— Zoti kuzhinier! Po mua marmalatën? — tha duke trashur zënë.

— C'thua ti, more?

— Mos bëj sikur s'di gjë, de! Se të di unë!

— Ikë, or, tej! Me kë do të tallesh ti?

Por më tej nuk u mbajt gazi. Diku ndritën syzet e profesorit të gjeografisë, që kish ngritur kokën, si gjith-

një kur habitej. Sigfridi duroi vetëm sa u larguan profesorët, pastaj iu shkreh Tahirit tërë mllef.

— E di unë pse m'i bën këto gjëra ti, fshatarak!
Më ke zili! Po që sot e tutje s'dua të më flasësh më!. .
— Sikfrik! — tha Tahiri, që kurrë nuk e thoshte dot këtë emër të përdhunshëm.

— Tallesh se je më i madh a? Aga je! Fshatarak je!. .
— Sikfrik! Mos e merr kaq ters, de!
— Mos më folë!

— Shumë po të merr nëpër këmbë! — e ngacmoi dikush.

— A nuk i vërtiti një herë me gjithë Granden!
S'ka ç'tju bëjë të dyve!

— Pse e ke Grandenë ti? Vetëm për biskota?

— Dëgjo, Sikfrik! Nuk e dija se do ta merrje kaq ters! Të mos bëjmë asnje shaka, thua ti? Po të erdhë rëndë, më fal!..

— Nuk dua të më flasësh më! Fshatarak!

Kështu u zu atë natë Sigfridi me Tahirin. Tahiri u largua ngadalë për në fjetore. Kush e di sa ishte pënduar që u zu me një shok të klasës! Kurse Sigfridi mendonte se kishte bërë një punë të mirë që ja kishte i shkurt hesapin atij fshataraku me opinga, të cilit i dukeшин thembrat e këmbëve si vezë nga çorapet e grisura. «Ç'mund të presësh nga një njeri me thembra të grisura? Apo nuk i përpjek buzët kur ha bukë, sa të vjen ndoht!» mendoi Sigfridi.

Shiu nisi të rrjedhë prapë nga qelli i turbullt. Toka u ngop, nuk pinte më. Nisen të bëhen pellgje dhe dheu ngjizej si brumë. Shiu, si një pelenë, i fshehu zjarret në Mal të Thatë dhe dritat e fermës u mjegulluan.

Sigfridi u shtri në kashtën e bezdissëhme dhe ja nisi bisedës me Granden për një brengë të fshehtë. Ca më tej, Tahirin e këputi një gjumë i rëndë. Gjumë fshatari! Në punë nuk e arrin njeri, nuk e arrin as në gjumë. Kujdestari ynë, ai që thotë «Mekbet» dhe që ka dëshirë që klasa jonë ta mbajë gjithnjë flamurin, i thotë: «Hajde, lokomotivë! Sikur të ishe kaq i mirë edhe në mësimë!

«Por Tahiri, është një nxënës i mesëm. Ka shumë vjet që ka lënë shkollën!!

Sigfridi nuhati një erë të rëndë këmbësh, myku e kalbësire. Mendimet iu topitën dhe e zuri gjumi.

* * *

Mesnatë. Shi. Pikit breronin mbi xhamë e të dukej sikur një bisht kali i fshikullonte ato pa pushim. Dikush gérhistë, nëpër èndërr u ndie një llomotitje pa lidhje, që të bënte të qeshje. Një fener rrinte varur mbi derë, por drita e tij nuk e dëbonte dot errësirën nga qoshet. Në muret prej tulle luhateshin hijet si të trembura nga brerimi i pafund i shiut në xhamet. Diku filloi të pikojë; por në atë përgjumje të rëndë askush s'e ndjeu. Pastaj një pikë tinzare gjeti udhë dhe ra mbi një dorë, që kish dalë jashtë batanieve.

— Petrit! Shko më tutje! Këtu filloi të pikojë!

— Merre edhe batanien tënde të mbulohemi!

Përsëri në fjetore ra një heshtie e thellë. Dukej sikur vetë qelli kish zbritur aq poshtë sa rëndonte me peshën e tii të padukur. Pas mesnate dera u hap me kërkëllimë dhe në fjetore hyri një njeri me mushama të zezë, deri në thembra të giatë. Kullonte ujë dhe nën dritën e fenerit dukej i verdhë si meit.

— Kë kërkon? — pyeti dezhurni me një zë të përgjumur.

— Të gjithëve — tha ai. — Zgjohuni, djema!

Dikush u kthyte përbys, fërkoi sytë dhe fjeti prapë. Njeriu me nushama të zezë mori fenerin dhe nxitoi nëpër korridorin e krijuar nga kashta, duke hedhur dritën mbi fytyrat e atyre që flin.

— Ei! Diema! Ngreuni!

— Ç'ka ndodhur?

— Kush na prish gjumin kështu në mesnë?

— Më duket se është një brigadier i fermës!

Tahiri u ngrit me nxitim nga kashta. I zhveshur, dukej tërë muskuj.



Një natë shiu

- Djema! Ka vërshuar kanali. Togjet me panxhar që mblohdët këto ditë, mund t'i rrëmbejë uji. Kush do të vijë, le të ngrihet!
- Do të vijmë të gjithë! — tha Tahiri.
 — Kush të vë të flasësh edhe pér ne?
 — Kush llap aty, more?
 — Grandeja!
 — S'kini turp! Djema mamakash!
 — Djema!. . drejtoria e fermës.
 — C'na bën konferencë? Do të vijmë të gjithë!
 — Duhen veglat?
 — More, ky brigadier i ka mirë me atë mushama, po halli ynë!
 — Hedhim bataniet mbi kokë.
 — Hajde, fëmijë, hajde!
 — Vishuni shpejt. Kush ka pér të ardhur, le të dalë jashtë! — tha Tahiri. Sigfridi ishte në mëdyshje. Fliste me Ilon me zë të ulët e s'dinte si të bënte. Por e pa që po mbetej vetëm, u ngrit dhe u nis pas të tjerëve. Vargani nisi udhën nëpër një shteg të fortë në mezhdë. Retë e mbarsura me shi kullonin si shpërgjenj, që shtrydhen pa pushim, me një ngadalësi e moskokëcarje ritimike. Në krye të kolonës njeriu me fener e mushama të zezë zgjidhët udhën e fortë. Dhe kënete ai, i butë dhe i lëvizshëm sa të dukej sikur shkelje mbi një dysheme me trarë të rrallë. Pas tij, ecte Tahiri, i veshur me bluzën e tij të përhershme prej leshi. Uji i rridhte në kurriz dhe i bashkohej në një curril të hollë. Herë-herë ndalej, hapte udhën dhe u ndriçonte atyre që ishin më pas. E kaluan të gjithë. I dukeshin më të vegjël e të dobët, sikur reshja u dërmonte supet e ajthme. Shkonin nëpër baltë, rrëzoheshin, ngriheshin. Profesorit të letërsisë i ndrisnin syzet si një vizion makbetian. Askush nuk fliste. Të gjithë e kishin mendjen te mezhdë. Një hap më tej dhe ngjesheshe në baltën e zezë të kënetës, që të thithët si llum.

«Kush mbeti në barakë?» — mendoi Tahiri.» Ndofta Sigfridi? Ah, ja ku qenka, bashkë me Ilon!»
 Sigfridi mundohej të mos mbetej prapa varganit.

Pantallonat i ishin ngjitur pas shalëve. Po më keq e kishte me këpucët. Sa të bukura ishin, aq të këqia e rrëfyen veten atje në fermë! Ju bymyen dhe i dilnin pllaq-plluq nga këmbët, si lëpitka.

«Sikur ta dijë babai!» mendoi. «Do mendojë me siguri se sonte unë e mora plevitin!» Shtegu u bë më i gjerë, por tërë baltë. Shkrepën bisedat.

— Ju të fundit! Mos mbeti prapa, ore!

Errësirë. Këmbët gatuanin baltën si brumë. Një shkrepse shkrepit në mës, aty ku ishin më të rriturit.

— Kujdes! Prapa ke profesorët! Do të të shohin me cigare!

— Ku merret vesh tanë se kush pi?

— Turp të kini! Përfitonit nga errësira dhe pini duhan.

— Do një ti?

— Prisni... — thirri një zë nga fundi. — Më humbi këpuca! Ilo! Pritmë!

— Kush ka mbetur? — pyeti Tahiri.

— Ishte zëri i Sigfridit!

— Pse nuk e prite ti, Ilo?

— Që të mbetesha edhe unë në baltë, ë?

— Hajde, Grande — shoqëria! Vetëm për të ngrë-në biskota, o?

— Më prisni — u ndie zëri. — Nuk shoh asgjë!.. Tahiri u nda nga të tjerët dhe u kthyte prapa, drejt zërit.

— Ku je, Sikfrik?

— Nuk eci dot! Më humbi këpuca në baltë dhe s'po e gjej!

Tahiri nxitoi hapat drejt zërit, në errësirë. Fësh-férinin kallmet. Feneri po largohej si një sy i verdhë, i djallëzuar, që të ndillte me fshehtësinë e tij. U përkul; futi duart në baltë. Sigfridi rrinte në këmbë.

— Kërko edhe ti! Mos më rri si hu gardhi! — tha ai.

— Do të jetë më tutje — psherëtiu Sigfridi. — Se unë bëra nja dy hapa zbathur.

Balta u ngjitej pas gishtave.

— E gjeta! — tha Tahiri. Sigfridi mbështeti njérën.

dorë në supin e tij, e mbathi dhe u nisën të dy. Po këpucët e bymyera i dolën prapë nga këmbët.

— Po tani? — pyeti me një zë të pikëlluar.

Tahirit iu duk sikur po qante. Kush e di? Ndofta edhe po qante. Por ishte errësirë dhe rriddhët shi; lotët s'mund të kuptoheshin.

— Zbathi këpucët dhe merri në dorë.

— Si? Zbathur? Që të marr ndonjë plevit?

— Na! Mbath opingat e mia ahere!

— Opingat?

— Po! Zbathur ti merr plevit!

— Po ti? Këpucët e mia nuk të bëjnë?

— Eh! Fshatarak unë, o vëlla! Mund të eci edhe zbathur. Jam mësuar.

Sigfridi s'mënoi më, shtrëngoi në të errët rripat e opingave, po prapë iu dukën të mëdha.

— Lidhi me këtë copë tel! — tha Tahir i dhe nxori nga xhepet e tij, që gjithmonë ishin plot hekurishte, një tel telefon.

Kështu u nisën. Përpara tyre mezi shquhej syri i verdhë i fenerit, që përpëlitez. Sigfridi pati përsëri një topitje të mendimeve, por u mundua të mos mbetej prapa tij. I arritën shokët kur kishte filluar puna. Dorë më dorë, kokrra të mëdha panxhari, të lara nga shiu, mbarteshin nga togjet deri te qerret në udhë. Qerret niseshin me kërkëllimë nëpër udhën plot baltë. Ujërat e turbullta të kanalit vërshonin me gulçe të dobëta dhe u afrohesin tinëzisht togjeve të panxharit, duke rrëmbyer nga ndonjë kokërr. Por dhjetëra duar vazhdonin t'u rrëmbenin ujërave kokrrat dhe t'i dërgonin nëpër qerre. Kështu, gjithë natën. Dhe, papritur, një dorë e padukshme e grisi pelerinë e përhime të shiut. U dukën përsëri zjarret në brinjët shkëmbore të Malit të Thatë. Pastaj zjarret sikur u zbehën dhe, në majë të malit, u ndez një zjarr tjetër i madh, që përfaku gjithë horizontin. Ishte dielli. Një re e braktisur u tulat pas malit e deshi të fshihej, po qielli i thellë e treti dhe e piu me gotën e tij blu...

NDERRUESI I ÇATIVE

E njihni zanatin e ndërruesit të çative? Është një zanat më vete, ndofta është më i vështirë se sa ai i muratorit. Të pikon çatia diku? Në qytet të shërben komunalja. Po në fshat? Ka edhe në fshat zanatçinj të pikave.

Në fshatin malor S. usta i pikave ishte Metja. Bujk, si të tjerët. Po edhe murator. Kishe një pikë në çati? Vinte Metja e ta zinte dhe të kërkonte, sipas rastit, dhjetë lekë, ... më shumë, ... më pak. ... sepse: «A ka punë që nuk shpërblehet?» thoshte Metja.

Në dimër e qortuan nga dy-tri herë në kryesi, se punonte privat. Metja nga inati nuk shkoi më gjökundi. Oh, sa mirë e dinte Metja se do të vinte prapë një pranverë e butë, se dëbora e çative do të shkrinte! Dhe pranvera erdhi. Dëbora nisi të shkrijë, ujërat rrodhën nga strehët, por gjetën edhe shtigjet e vjetra nëpër plloça. Tavanët u mbufatën nga pikat, u zverdhën, suvaja nisi të bjerë. Nën pikat vunë kova, tepsi. Por pikat rriddhnin dhe askush nuk guxoi të hipte t'i zinte vetë. Se nuk është njëlloj si të hash bukë me djathë dhe të zësh një pikë! Duke dashur ta zësh, mund të hapësh edhe dy të tjera. Ca më keq e patën ata që kishin pika afër oxhakut. Të pikonte uji në vatër dhe hajde të ndizje zjarr.

Kështu u kujtuan prapë për Meten dhe filluan t'i luten. Kryesia bëri një sy të verbër. Sepse, fundja, edhe shokët e kryesisë kanë çati, apo jo? Deri sa kanë çati, kanë edhe pika! U duhej edhe atyre Metja. Kështu ja

nisi prapë ushtë Metja të hipte çative. Zë një pikë këtu dhe, për çudi, hapet një tjetër, në anën e kundërt të çatisë. Gojët e liga pëshpërisnin se Metja çoku lëshonte vetë ngandonjë pikë që të mos i mbyllej burimi. Por aq i bënte Metes për këto pëshpëritje. Ojhaku i tij e conte tymin drejt!

Dhe papritur Metes i doli një shemër. Një shemër i zoti dhe që për çudi i zinte pikat pa para! Bile, i zinte më mirë se Metja, se kur vinte dorë ai, kishin mbaruar një herë e mirë pikat në çati!

Kush ishte ky njeri?

Një muaj para se të mbushte moshën e pensionit, gjeomeirit Isa Vrapi i ndodhi një fatkeqësi. Po kontrollonte asfaltimin e një rrugice anësore në qytet. Një maqinë riportabël po vinte me shpejtësi nga larg. Dhe befas nga kthesa i doli përpara një Skodë e ngarkuar me shtylla të centrifuguara. «Zissi», që kishte një grua të sëmurë brenda, u kthyte në rrugicën që asfaltohej, që të mos përplasej. Parakolpi e goditi Isanë dhe e hodhi tej, rrëzë kanalit. Tri brinjë të thyera, plagë... kontuzione. Për qime shpëtoi nga vdekja. Dhe ai njeri që s'kish menduar kurrë për pensionin, doli në pension nga halli.

Cili ishte ky njeri?

Bashkëfshatarët e tij në fshatin S., ku ai s'kishte shkelur prej vjetësh, mendonin se i kishte prirë fati. Kish qenë në njësitë territoriale. Pas lufte kishte zënë punë «pas rrugëve», siç i thoshin ahene. Njeri pa shkollë, po i zgjuar e me prirje të natyrshme për ndërtimë, i mësoi me ngulm gjithë zanatet e ndërtimit, kreuz vjet shkollë, u bë asistent-gjeometër, pastaj edhe gjeometër. Kish drejtuar ndërtimin e objekteve të vështira në qytet.

Dhe, për çudi, vitet dhe bredhjet nëpër shumë kantiere ndërtimi nuk ja thelluan aspak rrudhat. Flokët i kishte ende të zës, fytyrën të kuqërrreme si të një njeriu të shëndetshëm. Ishte njeri hokatar. Njëherë ishte në lulishtë me një moshatar të tijin, njeri që kish punuar gjithnjë nëpër zyra dhe s'e kish vrarë kurrë

kockën, por ishte rrudhur e ishte plakur aq shumë, sa të thoshje se i mungonte vetëm shkopi. Në tavolinë erdhë edhe drejtori i ndërmarrjes së tij.

— Shoku drejtor! Njihu me babanë tim! — i tha Isai.

— Babai? Gëzohem shumë! Duket që edhe ti i ke ngjarë nga tiparet! — tha drejtori.

Dhe këtë histori ja kish ëndë ta ritregonte derisa u bë si barceletë. E kishte këtë dobësi. I pëlqente të dukej i ri — dhe dukej vërtet — e të pyeste të njohurit e rinj: «Sa vjet të dukem unë ty?»

Dhe ja! Ky njeri që e mendonte larg pensionin dhe pleqérinë, pasi u dergj disa muaj në spital, doli që andej i sakatuar në trup. Vendet e shembura i dhimbnin dhe nuk flinte dot në krahun ku kish brinjët e thyera. Por... më tepër i sëmbonte shpirti. Kish një tronditje të atillë, sa nisi ta urrejë edhe trupin e vet, dikur muskuloz e tani të flashkët e të ngjallur nga të ndenjurit, me tule të bardha. Nuk i pëlqente të shihte fytyrën e vet, dikur ngjyrë bronxi, të ashpër e të rreshkët dhe tani me faqe buçka e me qime, që i mbinin shpejt mbi lëkurën e zbetë.

Kish një brengë të fshehtë, një dhimbje të habitshme diku, as ai s'e dinte se ku, brenda tij. Punëtorët vinin e vizitonin. Dhe kjo s'i pëlqente, por nuk kish se si të shpëtonte. Nuk i pëlqente që ata e shihnin ashtu, të flashkët, të ngadalshëm e të ngjallur, duke ndenjur në kolltukun e kuq, delikat si një vazo kristali, që mund të thyhej nga një goditje.

Dhe atëhere e zuri malli për fshatin e tij të largët e të bukur në mes të maleve. Oh, ai e quante fshatin e vet ndryshe nga çdo fshat tjeter! Koria e aheve vinte deri në prak të shtëpive dhe shushurinte gjithë natën me dhimbje nga erërat. Ajri ishte i rrallë, por pishat dhe bredhat e pyjeve të vjetër dhe kurora e dendur e aheve e kishin situr dhe e kishin mbushur me aroma. Dhe pastaj burimet, burime mali të fshehura në mes të fletëve në pyll, kroje me shurupuqë guri, që kishin zënë myshk të blertë nga vitet, kroje të mbuluar me

çati të pjerrëta dhe me postafe prej druri. Të gjitha këto i erdhën ndër mend si një vegim i vjetër, që të trishton dhe të bën të dridhesh nga malli. U shkroi kushërinje të vet nëse mund t'i lëshonin një dhomë me qira për nja dy muaj. Ata u fyen dhe i shkrojtën se e paskish harruar mikpritjen e fshatit; kështu, në fillim të majtit erdhi në këtë fshat të largët. Dhe e ndjeu se po ndodhët një mrekulli me organizmin e tij: plagët iu shëruan, lëvizte e shëtiste sikur s'kish ndodhur asgjë!

«Po të kisha mbetur në atë kolltukun e kuq, ku më përgjonin që të mos lëvizja sikur isha një fëmijë në djep, do të isha bërë ulok me siguri» mendoi.

Po e kuptonte se çdo gjë që kish të bënte me ak-sidentin, kish marrë fund! E brente pendimi. «Pse u nxitova, xhanëm, të dalë në pension!» Oh, q'inat të madh që bluanët me vete kundër gjithë atyre që e bindën të dalë në pension!

Filloi të punojë rrëth shtëpisë, ku banonte. Ngriti një avlli, që ishte rrëzuar. Pastaj ranë shira të nxituara, siç bien vetëm në verë, shira që lénë gjurma të potershme, po që avullon po aq shpejt sa edhe vesa. Pylli ndillte gjithmonë shira të tillë. Njerëzit e ndjenë trokitjen e vjeshtës në portë. U hapën plagët që linte pa shëruar Metja! Dhe u hap përsëri punë për Meten. Posa e pa Meten hipur mbi çatinë e murme dhe mori vesh për çmimet e tij, Isai u murrëtye. I tha të kushuririt:

— Ti mos u mërzit. Meten mos e thirrë, se çatinë do të ta ndreq unë!

— Ti? — u çudit kushërirri. — Si dashke të hipësh në çati pas gjithë atyre që pësove? Si do t'i ngresh e do t'i lëvizësh plloçat e rënda? Jo, për besë, nuk të lë kurrrë!

— Ti nuk je doktor, apo jo? I zoti e di më mirë se ku i pikon çatia! Nuk do ta lëmë Meten të majmë zverkun mbi çatitë tuaja!

Dhe hipët në çati. Shtëpia e kushërit ishte e fortë, sa një katana, në rrëpirë. Të merrte frika të vështroje poshtë nga strehet e saj. Usta Metja për këto çati kërkonte si frëngu pulën, se: «Pa shko e hipë zotrote aty»



— thoshte. «Që poshtë dukesh sa një harabel, po edhe atje sipër të duket vetja sikur je harabel dhe ja... do të fluturosh!..»

Të dielën në klub, ku mblidheshin gjithë burrat, Isai tha:

— Kjo që ndodh tek ju është turp! Unë i them shfrytëzim këtij, or tungjatjeta! Si, ore, e lënki Meten të trashë qafën me paratë tuaja? E pse? Për një pikë! Në s'qenka e zonja kooperativa të bëjë këtë punë e të ngrerë një skuadër muratore, le ta zgjidhë këtë punë pas një viti, se këtë vit pikat do t'jua zë unë. Dhe në i zënça më keq se Metja, të më pështyni të gjithë. Do t'i shpallim luftë shfrytëzimit privat apo jo? — tha duke qeshur. — Sot, po hapet ndërmarrja për zënjen e pikave falas!

Kështu usta Metja mbeti këtë vjeshtë pa punë. Vitin tjetër, po të mos ketë ngritur akoma kooperativa një skuadër muratorësh, shëndoshë Isai, që e shkon gjysmën e vitit në fshatin e lindjes.

ZBRITJA NË BAZË

O pëshpëritje të mallëkuara! Ju jeni si ato erërat e veriut, që trazojnë ujërat e pellgjeve në vjeshtë.

Ekonomisti, Xhafer Sabriu, u ngrit vonë pas një nate të gjatë. Nuk e kuptonte dot në kishte fjetur apo kishte qenë zgjuar, vetëm se koka i rëndonte shumë sikur i ishte mbushur plot me pëshpëritje të pafund. Aty nga ora gjashtë e gjysmë mbylli derën e apartamentit të vet dhe doli jashtë, në rrugë. Qielli e vështronë me të gjithë sytë e vet të kaltër dhe kjo s'premtonte asgjë të mirë veç zhegut. Ndofta do të ishte më nxehjtë se sa ditën e kaluar, kur ai, i mbytur në djersë, kish bërë një udhëtim të shkurtër në një rrugë plot pluhur deri në minierë: Në rrugë lëvizte një turmë njerëzish drejt zonës industriale.

Mbi suvanë e verdhë të ndërtesës rridhëtë një spërËkë uji nga vazot e ballkonit të tij dhe binte pastaj në tro-tuar duke formuar një njollë lagësie. S'kishte ndodhur kurrë kështu: sot ishte ngutur. Ishte ngutur, sepse i kishte dalë gjumi vonë dhe në përgjithësi sepse i ishte prishur përpikmëria e vjetër, pasi gruaja me fëmijët i kishte ikur për pushime te prindët e saj.

Ballkoni i tij dallonte midis ballkoneve të tjera të pallatit, ashtu siç dallonte, të themi, shkrimi i tij i bukur midis shkrimeve të tjera. Lulevathët e kuqe varnin kryet si të turpëruara deri afër buzëve të poçes prej balte, sikur nuk rronin dot pa aromën e përherëshme të livandinave dhe të borzilokut. I ardhi keq që

sot ishte treguar i pakujdeshëm dhe vendosi se kjo s'do të ndodhë kurrë më, aq më tepër sepse halle të paritura i kishin rënë tanë mbi krye. Shikoi orën. Kishte edhe një çerek ore deri sa të fillonte gjimnastika e mëngjezit, kurse rruga s'ishte më shumë se dhjetë minuta. Kishte pesë minuta kohë. Pesë minuta janë hiçgjë për një njeri të rëndomtë, mund të thuash janë zero me bisht, mirëpo për Xhafën nuk janë pak, sepse, fundi, ai është ekonomist — planovik. Ai tanë mund të mendojë.

«Njeriu» mendon ai, «duhet t'i hedhë vështrim edhe jetës së vet të shkuar. Sigurisht, asgjë s'mund të kthehet prapë, pendimet janë të kota». Por në situata të tillë, sipas tij, njeriu ndjen me forcë nevojën e sintezës, që përbën bilancin e jetës... bilancin e sukseseve dhe të gabimeve. Aq më shumë në situata të tillë të shqetësuara, ankthi e pasigurie si këto që po kalonte tanë. «Në mos më shërbeftë sot ky bilanc, kur do të shërbejë vallë?» mendoi.

Ja.. ta nisim jetën analistiksh që nga viti 1956, viti kur mbaroi studimet dhe mori diplomën e ekonomistit. Dhe ishte nga ekonomistët e parë të vendit! Dhe po atë vit filloi punën këtu, në këtë zyrë, në seksionin e planit. Oh! S'janë pak dymbëdhjetë vjet në një vend; në një qytet të këndshëm. Këtu u martua, mori apartamentin, lindën fëmijët!

Nja tre vjet më parë njëri prej ekonomistëve të seksionit duhej të transferohej për shkurtim vendi. Dhe ky që transferohej nuk do të ishte ai, deh, sepse ai kishte stazhin. Ai po hynte në gardën e veteranëve të komitetit. U transferua një djalosh, një ekonomist tjetër. Si i thoshin... è... po... Nuriu! Shkoi shef plani në minierë.

Hija e errët e shqetësimit i kish mbuluar fytyrën e bardhë me një shenjëz të vogël të prerë prej briskut atë ditë në mëngjez. Prapë nga ajo ngutje e nga ai nervozitet i mallékuar. E kishte fajin ngutja apo nervoziteti i tij? Ç'rëndësi ka? Hapat e ngadalshme mbi trotuar i tingëllonin në kokë me forcë si një kakofoni, si-

kur nën pllakat e trotuarit të kishte kazanë tunxhi. Dielli i korrikut kish filluar të digjte. Ç'mund të premtojë një ditë e tillë zagushie veç mungesës së dëshirës për të menduar kthjellët dhe dëshirës për të dremitur?

Arriti nja dy minuta para kohe. Në shkallët e gurta ishin ulur nëpunës të tjerë. Ai i përshëndeti me krye, vështroi lulishten përkarshi, ku vapa kish përcëlluar barin dhe lulet, që ishin si pa jetë. Nëpër vllaja kishin mbirë luleshurdha dhe askush nuk kujtohej t'i hiqte.

— Kot së koti i paguan komunalja këta lulishtarë! — iu drejtua ai Tefikut, një ekonomisti tjetër. — Shiko si qenka tharë bari!

Nëpunësit bisedonin me gjallëri midis tyre. Xhafa kujtoi se mos bisedonin për diçka të aférme me hallin e tij, për ndonjë lajm të ri... prandaj u fut në mes të tyre. Po bisedohej për Vietnamin dhe ai, që nuk i kishte dëgjuar në mëngjez lajmet, u bë kureshtar. Por sot i dukej sikur s'mund të kuptonte kthjellët asgjë. Ajo pëshpëritje që kish dëgjuar para dy netësh, përsëri e shqetësoi njësoj si zhegu, që po rritej më shumë.

— E lexova në gazetë informacionin tënd — i tha Tefiku.

— E? Si t'u duk? — u përshkund Xhafa, i hutuar. Iu duk sikur sytë e vegjël të Tefikut diçka fshinin brenda bebzave të tyre të gjelbëra.

— Gjëra të përgjithshme. Po prapë mirë që shkruan!

— Kjo eshtë kryesore!

Tefiku heshti. Xhafës iu duk prapë sikur sytë e tij të gjelbër fshinin diçka të pikëlluar.

— Nuk më thua, ç'flitet poshtë e lart?

— Përse?

— Për temën e ditës! Qarkullimin! A ka ndonjë ndryshim në kuadër nëpër ndërmarrjet ekonomike? — dhe e përkëdheli fytyrën e gjerë me nofulla si prej kali të Tefikut me një vështrim të çuditshëm të syvet të vet të thellë e të butë si prej viçi.

— Thonë se pas kritikës së gazetës, do ta heqin drejtorin e konsumit!

— Kjo pritej, xhamën! Pritej!.. Shkeli në dërrasë të kalbur ai! Po gjë tjetër?

— Nuk di! — tha Tefiku.

— Me këtë qarkullim, jemi të gjithë si mbi ujë!

— psherëtiu Xhafa.

— Po mbi një ujë që rrjedh ama! Uji, kur rrjedh, stohet, se po ndenji në vend shumë kohë, ngrohet e mund të qelbet pastaj!

— C'krahasime naivë bën ti. ore!.. — tha Xhafa.

— Eja! Mos e mundo veten! Vëru në rrjesht për gjimnastikën e mëngjezit.

* * *

Në zyrë. Ngriti receptorin e telefonit dhe rrotulloi numrin zero. I pëlqente ky telefoni i ri, që posa kishin vënë. I bardhë, rrezellenjës, sikur qeshte vetëvetiu në tryezë. Kurse ai i vjetri, i ziu, ishte një rangallë e mërzitshme! U dëgjua zëri me hundë i centralistes. Me këtë zë ai argëtohej shpesh... disa vjet më parë, sepse dëgjohej sikur nuk thoshte «alo» po «ano»!. Vitet e para... Atëhere nuk ishte martuar dhe ishte një djalë hollak dhe sqimatar, bënte një copë herë shaka me të duke i përsëritur edhe ai «ano... anol». Përtej telit, atëhere, dëgjohej një gugurisje e gjatë, përkëdhelëse. Kur u martua, nuk e bëri më atë shaka, bile edhe një herë, kur e përdori gabimisht, iu përgjigj një zë i vrazhdët dhe një: «Mos na vono, shok!», me ton urdhërues, si s'e pati dëgjuar kurrë më parë. Por shkuan shumë vjet! Ai u bë lakonik në bisedë. Ja, tani i tha vetëm një fjalë: «Lokalitetet!» As numrin e vet, asgjë fare! Por zëri i tij ishte aq i njohur në çentral sa edhe zilja e karrocës së plehrave në mëngjez!

«O pëshpëritje të mallëkuara! Ç'dreq pasigurie mbillni ju kështu?» A thua vërtet, atë Xhafë ekonomistin me stazh mund ta qarkullonin nga komiteti?

«Pa të mendohemi një herë! Të llogarisim!» tha Xhafa. «Le të bëjmë bilancin e të gjithave. Një herë, që të qarkullosh, duhet të kesh një farë kleçke, them

unë! Ç'kleçkë, thua ti? Po ja... si të të them?! Të jesh bërë i padurueshmë si... si... ajri në një dhomë me dritare të mbyllura, ose të jesh si një ujë, që ka ndejur shumë... Ku dreqin e kam dëgjuar këtë krahasim? Nga Tefiku? Ah! Po! Edhe kryetari në mbledhjen e aparatit, kur i kritikoi disa herë, se janë mbyllur në zyrat e tyre dhe kanë humbur kontaktin me masën... me punonjësit, u tha po kështu! Bile kryetari tha edhe se nëpunësi, që humbet lidhjet me popullin, kur kthehet pastaj në mes të tij, në fillim mund të duket edhe si qesharak. Por kjo i bën mirë. «Lëvizje, shokë!» pat thënë. «Lëvizje! Jo ujë që fle, po ujë që rrjedh!..»

Cudi! Kur mund të duket njeriu qesharak? Dhe, në përgjithësi, a mund të ishte bërë ndonjëherë ai qesharak në sy të të tjerëve? Bah! Me siguri një gjë e tillë s'kishte ndodhur dhe s'kishte për të ndodhur kurrën e kurrës. Se mos ishte ai, Xhafë Sabriu, si ai zootekniku i rrethit, që nuk shumëzonte dot menjëherë me 2000, po radhiste nën vijën e shumëzimit tri rrjeshta me zero? Pa dyshim, ky ishte një nga ato rastet kur njeriu duket qesharak në sy të të tjerëve!

«O pëshpëritje të mallëkuara! Ju jeni si një borxhi vjetër, që të murmurit me shpoti therëse në çdo cap!» mendonte me vete.

Kështu, ekonomisti Xhafer Spahiu detyrohej tani të bënte bilancin e dymbëdhjetë vjetëve të jetës! Një bilanc i vërtetë: me debi dhe kredi. Ç'merita të rëndësishme kish pasur që të mund t'i shënonë në aktivin e vet? Kur ishte shquar mbi të tjerët dhe ishte lavdëruar? Ja, kjo ishte njëra anë e bilancit.

Ana tjetër ishte e kundërt, pasivi i tij: kur ishte kritikuar nga eprorët? Kur ishte kritikuar në mbledhje të aparatit ose në kryesi?

«Pikërisht ky bilanc ka, tani, rëndësinë më të madhe!» mendoi Xhafa. «Pozitiviteti ose negativiteti i tij do të përcaktojnë zgjedhjen e këtyre pëshpëritjeve të mallëkuara!»

Telefoni i bardhë mbi tryezë e kundronte me ftohësi, indiferent, si çdo gjë e bardhë!

Ç'bilanc i vështirë!

I vështirë, sepse, nga gjithëjeta e tij, nuk i kujtohej asgjë e jashtëzakonshme që të kishte bërë bujë. Xhafa nuk ishte si ai inspektori i çuditshëm i arësimit, që ishte i njohur për karakterin e tij të bujshëm, për ndërhyrjen e këmbënguljen e tij kur edhe vetë shefi jepte një urdhër të shtrembër. Ky inspektor, pastaj, ishte bërë shef i seksionit nga ndonjë prej atyre rastësive, që vijnë rrallëherë, sipas tij.

Një ngërdheshje, që ndofta ishte buzëqeshje, iu end nëpër gjithë fytyrën e vogël e të këndshme. Po. Sigurisht. Mund të llogaritej në «aktiv» fakti që ai ishte zgjedhur dy herë n/kryetar i komitetit profesional. Pastaj edhe fakti që ishte lavdëruar kohët e fundit në një raport, si një nga shokët e përparuar, që i ndihmojnë mirë gratë e tyre, që e ka kuptuar drejt emancipimin!

Kjo, po! Kishte peshë, sepse, fundja, lidhej me emancipimin.

S'mundi të kujtonte asgjë tjetër. Dalëngadalë iu tret edhe ajo ngërdheshje, që i ngjante qeshjes dhe dy rrudha nervoziteti iu qepën në gojën e vogël. E po, në s'kishte më asgjë në «aktiv», aq më pak mund të kishte në «pasiv». Veç, ndofta, faktit që dikur e kishte kritikuar kryetari i vjetër dhe e kishte quajtur njeri pa inisiativë. Por kjo s'ngrinte fort peshë, e para, sepse ishte çështje vezësh dhe dhish. Ai kishte rënë në bella me zooteknikun e rrethit që nuk e njihte metodologjinë e planifikimit dhe kish guxuar të ndryshonte disa qindra vezë nga shifra e dërguar prej komisionit të planit, dhe nuk kish dashur që kooperativës së Vërrisë t'i planifikoheshin pesëqind krerë dhi, sepse ajo nuk e kishte bazën për një tufë të tillë; meqë militenca kish skartuar shumë dhi dhe tufa na qenkej pakësuar aq shumë saqë të arrinte këtë shifër, kooperativa duhej të blente nja katërqind krerë. Ai, ahore, bile edhe pat bërtitur, siç nuk i kish ndodhur kurrë, sepse ç'i hynte metodologjisë më qese se sa dhi duhej të blente Verria? Dhe, fundja, a s'ishte kjo një shkelje e metodologjisë?

Por kryetari i vjetër kishte marrë anën e zooteknikut dhe e kish quajtur pa iniciativë, të ngurtë. Mirëpo kjo.. or tungjatjeta, kishte shumë vjet, atëherë kur zbatohesh metodologjia e vjetër. Dhe kryesorja ishte se kryetari ishte transferuar.

Tjétër?.. Tjetër?..

Ah.., po; para nja tre vjetësh, kur ishte n/kryetar i komitetit profesional, Mustafa e kishte kritikuar, se pse kur ndante detyrat e anëtarëve për festën e një majit, për vete pat caktuar ca detyra të tillë pa bukë si: të lajmëroheshin punonjësit të vinin në orën e caktuar dhe me rroba të reja, të sigurohej pjesëmarrja në festë. Mustafa e kishte quajtur këtë detyrë qesharake!

Dhe fjalë e çuditshme «qesharake» i doli prapë përpëra si një mace e zezë. C'ishte kështu? Dhe kë vështronë vallë në atë çast të paharrueshiem kryetari, kur pat thënë se njeriu, që shkëputet nga populli, bëhet qesharak?

«Po ku ngrenë gjë peshë këto në bilanc?» mendoi. Ja, a mund të ngrerë peshë tanë në «aktiv» fakti më i freskët që ai kishte shkruar dy artikuj në gazeten lokale? Ngrinte, patjetër. Bile, i përbyste të gjitha ato të pasivit!

Dielli i verdhë, si një lulledielli, rrrotulloi kokën e vet dhe e futi nëpër dritaren e zyrës. Një tufë drite i vrael sytë. Telefoni i bardhë shkëlqeu, sikur e la mënjanë ftohtësinë e tij të zakonshme. Ajri i dhomës u bë i thatë, djegës, dhe ai ndjeu se, për çudi, kishte djersirë dhe nuk e kishte kuptuar. Pse kishte djersë vallë? Nga dielli që pat futur kryet në dritare, apo nga pesha e mendimeve të zymta? Ë?

O pëshpëritje të mallëkuara!!

* * *

Një hartë e re e rrëthit varej në mur, mbi kokën e tij. Ai hetoi edhe një herë afërsinë e dy shenjave të rrumbullakta rrëzë malit, që tregonin fshatrat

fqinjë, Plepas dhe Sheras. Pastaj picërroi sytë sikur ja vriste drita dhe i rilexoi të katër fletët e letrës. Në rrjeshtin e parë gëрма «a» ishte shtypur gabim «q». Ai e dreqi me kujdes me penë. Më poshtë nuk gjeti asnjë gabim dhe s'i mbeti gjë tjetër vecse të shkruante emrin e vet. Diku, mbi tryezë, kishte mbetur evidenca e fundit. Ja, kjo ishte punë, ja! Çudi si janë njerëzit! Një ditë më parë ishte ngrënë prapë me Tefikun, që thoshte se nuk është aq e lehtë të shkruash një artikull. Oh, për Tefikun, kjo mund të ishte një mal i lartë, po jo edhe për Xhafën, që po ja merrte dorën dita-ditës kësaj pune. Dhe pastaj kësaj here kishte bërë një shkrim të fortë, të fortë, sepse kishte brenda edhe kritikë. Kritika e tij e parë publike, kritikë tro-nditëse. Kurse Tefiku kish pasur paturpësinë t'i quante shkrimet e tij të thata, që as të ngrohin, as të ftohin! Ç'do të thoshte Tefiku kur të botohej ky shkrim në një gazetë qendrore? Dhe pas botimit të këtij shkrimi dikush duhej të vinte gishtin në krye kur të mendonte për qarkullimin e tij, sepse, fundja, Xha-fer Sabriu nuk ishte çanak me dhallë.

Kërkoi midis shkresave evidencën e fundit të bujqësisë dhe e gjetti të rrëzuar nën tryezë. Tani nuk i hynte më në punë. Ajo e kishte bërë tani detyrën e saj. Dhe ç'punë kishte bërë se! Ja, për shembull, në evidencë ai mundi të shohë fare qartë se si shkonte fushata e korrjeve, se si i ishte përveshur fshatarësia kooperativiste fushatës. Këtë e tregonin përqindjet. Plepasi e Kuqani ishin mbi 50%. Po Sherasi pse të ishte vetëm 10%? Ç'i pengonte shokët e Sherasit që të korrnin, veç javashllékut të tyre? Kështu, ai shkroi për Plepasin që printe në ballë dhe për shokët e Sherasit, që ishin në bisht të gjendjes. Lavdëroi dhe kritikoi. Titulli i rrodhi si vaj, oh, si i rrodhi menjëherë!

«Shokët e Plepasit në ballë të emulacionit. Ç'presin shokët e Sherasit?»

Dita e gjatë e korrikut po mbaronte. Muzgjet hyjnë nëpër dritare dhe ai u kujtua se u bë vonë. Korri-

dori i gjatë i komitetit kishte rënë në heshtje. Hapat e tij kumbonin me një gamë të lartë, sikur dridheshtin muret. Nëpunësit kishin ikur dhe zyrat ishin mbyllur. Ai ndenji nja dy minuta te dezhurni, i tha se posa kishte përfunduar një artikull me rëndësi dhe se tanë do ta hidhte në postë dhe doli jashtë. Ishte errur. Në lulishten e vogël lëviznin hijet e drurëve dhe të njerëzve. Shkoi në postë, e hodhi letrën dhe kërkoi gruan në telefon.

... Dhe më kot priti nja gjashtë ditë që të bo-tohej artikulli. E lexonte çdo ditë kopjen e artikullit për të gjetur se mos kishte gabuar diku, se mos, i tërhequr nga magjia e kritikës, kishte hedhur më shumë piper se sa duhej, se mos... kush dreqin e di se ç'gabime sjell ai entuziazmi i parë i krijimit — siç thonë! Por, asgjë nuk iu duk e tepërt dhe e re. Bile edhe kritika e tij iu duk si një gjë që rrrotullohej e rrumbullakosej nga meraku për të mos cënuar fort njeri. Fundja, dreqi i mori edhe ata të gazetës qendrore! Le ta botonin me shkurtimë dhe ndryshime si ata të gazetës lokale, le të bënin si të donin. Vetëm në fund të shkruanin emrin Xhafer Sabriu! Artikullit po i humte aktualiteti! Evidenca e mëpasme mund të tre-gonte se edhe shokët e Sherasit ishin zgjuar! Ç'mbetej pastaj nga kritika?

Të enjten e thirri n/kryetari në Zyrë.

~~reshenje~~ të mallkuara! Ky ndoshta ishte çasti i kurorëzimit tuaj! Ai ngurroi një hop para derës, pastaj hyri. Për çudi n/kryetari e ngarkoi të bëjë një studim në zoniën e Plepasit. Xhafën s'para e zinte plumbi i ekipeve, vetë detyra e tij si ekonomist e ruante në një farë mase. Studimi iu duk i çuditshëm, i pakuptueshëm, por u nis me një farë dëshire, me shpresë se mos i dilte edhe gjë për të shkruar. Po atë ditë hipi në autobus. Pranë kishte një fshatar të shkurtër me qafë si të demit, llafazan.

Maqina uturonte nëpër pluhur. Ishte një zagushi e madhe, sa të merrej fryma. Korriku kish hapur bar-

kun e tij tē nxehëtë dhe përvëlonte si furrë dhe dreqi e dinte se kur do tē mbaronte kjo zagushi. Një shtullungë pluhuri e ndiqte pas karrocerinë e verdhë tē autobusit dhe futej nëpër tē çarat. Ai e ndjente në gojë shijën e hidhur si hithër tē pluhurit.

Kështu ai zbriste për disa ditë në bazë. Tani kjo i dukej si një ogur i mbarë, sepse, po tē qe se kishin ndër mend ta qarkullonin së shpejti, pse ta dërgonin atë për tē bërë studimin?

Dy fshatarë ja morën shtruar një kënge tē vjetër. Fshatari me qafë demi ja ktheu me një iso tē vrazhdë e gurgulluese. Ky zë, që i gjëmoi mu në vesh, e shkundi nga mendimet.

— Di t'ja mbash ti, t'ja them unë një herë: «O ju male me dëborë?» — pyeti me baballëk fshatari.

— Jo! — tha Xhafa.

— Ku e ke udhën ti?

— Në Sheras!

— Qenkemi bashkudhëtarë. Unë quhem Xamë — tha fshatari. Xhafa i tha emrin e tij.

— Larg është fshati nga xhadeja? — pyeti ai.

— Jo... një vrap pele!

— Dreqi e di atë pelën tuaj! — qeshi Xhafa.

— Po ti s'paske shkelur kësaj ane a?

— Është një nga zonat e vetme ku s'më sjell puna. Unë jam ekonomist në komitet.

Autobuzi qëndroi në xhade. Ata zbritën.

«Mund tē dalë një përshkrim letrar nga kjo rru-gë» mendoi ai. «Autobusi, pluhuri, autokombajnat, ky fshatari pak i trashë që quhet Xamë.. Do ta provoj!»

— E? — tha Xama. — Ti sikur po i përtyp me vete fjalët!

— Jo... mendohem. Se, sido që ekonomist, unë shkruaj nganjëherë edhe në gazetë.

— Ç'më thua, o derëbardhë! Ti më gjëzove! Po ne qenkemi tē dy tē një pune — tha Xama.

— S'kuptoj! — u habit Xhafa.

— Edhe unë jam korrespondent vullnetar. A e lexove një kritikë pér baxhen e Plepasit?

— Po!

— Unë ua ngjesha! Po të ngjeshur, ama! Or, po ishte bërë ai si teqe! Ha Muço, pi Muço! Të kumbiseshin të gjithë të mëdhenjtë e fshatit si në shtëpi të tyre! Mirëpo ke parë ti që edhe redaksia dërgoi një njeri që ta shihte punën në vend? Ore, nuk është njësoj si të hash qyl në baxhe dhe të kritikosh në gazetë, se gazeta ta provon çdo gjë deri në qime, demek e ke parë vetë. Apo je nga ata që e bëjnë qimen tra?

— E... he — buzëqeshi Xhafa. — Mirë e ke ti, se redaksia verifikon shkrimet e bashkpunëtorëve pak të njohur. Pastaj kjo varet edhe nga posti që ke! Ja, unë, ta zëmë, s'kam nevojë që ta shoh çdo gjë me sytë e mi pa të shkruaj. Se posti im më vë në kontakt me realizimet, me përqindjet, me...

Xama e ktheu me zor qafën e trashë. Vuri re një shqetësim të çuditshëm në fytyrën e vogël të ekonomistit. Tani e kishte radhën Xama të habitej.

— Nuk të kuptoj! — tha.

— He... he... — qeshi Xhafa. — Puna është se duhet të të shkojë ndër mend. Ja, ti je nga Sherasi. Kështu? Fqinjët tuaj të Plepasit janë në ballë të emulacionit të korrjeve, kurse ju në bisht. Pse nuk ua ngjesh edhe një kritikë? Se nuk e di rezultatin me shifra, siç e di unë... Po ta dije, ti mund të bëje një farë kritike!

— Se mos ke ndër mend të shkruash një gjë të tillë? — qeshi Xama.

— Ndofta! — tha Xhafa.

— Do të bëje një vrimë në ujë. Se ne vërtet nuk jemi aq larg me Plepasin, por ata e kanë gjithë tokën përpëra, në fushë. Gruri u poq. Kurse ne ato njëzet hektarë që kemi në fushë, i korrëm; grurin tjetër e kemi në mal. Që thua ti, ai jeshilon akoma si jonxhë dhe i do nja dhjetë ditë të marrë faqe.

Xhafa ktheu kokën rrëmbimthi drejt qafës së

shkurtër të Xamës. Mos donte të tallej ky fshatar, që atypari i ish dukur bille pak i trashë? Sytë gjysmë të mbyllur e si të vëngër të fshatarit e vështronin në mënyrë të pakuptueshme.

Mirëpo shtegu që ngjitej përpjetë, freskia që vinte nga pylli, kufiri i çuditshëm që po sajohej në çdo çap midis të verdhës së fushës dhe të gjelbrës së kodrinës, të gjitha këto dëshmonin se korrra nuk kishte trokitur akoma në Sheras.

«Kurse unë shkrojta që Sherasi ka mbetur në bisht të emulacionit!» mendoi i tmerruar.

— Pse i përtyp fjalët? — e ngacmoi prapë Xama.

— E? — u përmend ai. — Unë, hiç... asgjë...

— Tani edhe një vrap pele na mbeti deri në fshat!

«Po në hartën e rrëthit, pse janë kaq afér këta dy fshatra? Apo nuk e pata ndër mend mirë shkallën e zvogëlimit?»

— Ama për të gajasur do të ishte sikur të shkruaje një marrëzi si ajo që the aty më parë! Le që s'ta botonte njeri, se, siç të thashë; ata të redaksive nuk e hanë sapunin për djathë, po merre me mend se si do të qeshnin, ë? Ore, do të gajasej së qeshuri ai buçkoja që e ka të qeshurën majë gjuhës!

«Si mund të bëhet njeriu qesharak? Ndofta këtij Xamës i dukem unë tamam qesharak? Dhe ç'dreqin më mbeti në gojë kjo fjalë e kryetarit? Tani, duhet të kthehem! Të telefonoj në redaksi. Si ta gënjej këtë Xamën e mërzitshëm? T'i them që kam harruar prizën e furnellës pa hequr?»

— Shiko, shoku Xame! Më doli fare nga mendja se unë duhet të vete më parë në Plepas! — i polli mendja atij. — Si dreqin më doli nga mendja?

— Shko nesër, o derëbardhë!

— Jo... duhet të shkoj!

— E, po udhë e mbarë! — Kthehu! — tha Xama indiferent dhe e vështroi në po atë mënyrë të çuditshme.

Xhafa u kthye me rrëmbim. Ktheu një herë ko-

kën mbrapa. Edhe ai Xama me qafën si të demit, për çudi, e pat kthyer kokën mbrapa e vështronte me ata sy të vegjël. Pastaj Xama mori shtegun përpjetë, kurse ai vazhdoi të zgresë drejt xhadesë.

Gjeti një maqinë dhe pas një ore e gjysmë ishte në qytet. U sul rrëmbimthi në komitet. Kishte edhe një cerek ore që të mbylleshin zyrat.

— Sa mirë paske bërë që s'paske iku — tha shefi. — Se të kërkon kryetari. Veç kësaj ke edhe një letër nga gazeta.

Xhafa e hapi zarfin me duart që i dridheshin. Vështrimi i përpiu menjëherë disa rrjeshta:

«Siç duket, artikullin e kini shkruar pa parë as gjë me sytë tuaj. Kështu ndodh vetëm kur bazohesh në një letër me shifra të thata...»

U plas në karrigë. Telefoni i bardhë rrinte gjithnjë aty mbi tryezë, i ftohtë, indiferent.

USHTARI KTHEHET ME LEJE

Ushtari kaptoi qafën e malit. Mali ishte i vrahë, i rrudhur dhe drurët e tij ishin të rrallë e të gjymtuar nga rrufetë. Drurët e gjymtuar kishin mbetur si çataj të rrallë e të nxirë, por në çdo kërçep të shëndoshë po hazdisej një mori filizash të rinj.

Posta e kufirit mbeti larg si një pikë e bardhë në mes të pyllit, atje mbetën edhe shokët.

Ja! Ndofta tanë Kadriu në pikën e vrojtimit e ka hequr një çast vështrimin nga toka e huaj dhe po e kërkon figurën e tij në qafën e malit. Sa herë e ka parë edhe ai me dylbi tokën e tij, këtë mal të rrudhur nga përrrenjtë dhe arat e gjelbëra!

«Ndofta më kot më kërkon Kadriu!» mendoi ai. «Më kot, se ai e di që gjer në qafën e malit duhen dy orë rrugë, kurse sot unë ngutem dhe rrugën e kam bërë një orë e gjysmë! Ngutem!...» qeshi me vete. «E përse vallë? Ndofta mund të gjej një maqinë të rastit deri në krahinën time!»

Ai edhe Kadriu janë nga një krahinë. Në fshatrat e tyre ka shumë toka në fushë. Kurse kodrinat e ulëta me ullinj janë më larg, në skaj të fushës. Pastaj prapa kodrinave ka prapë fushë...

Ushtari e kishte herën e parë që kthehej me leje në shtëpi. Në gjoks kishte letrat e saj... letra të përmallshme, të rrudhura nga leximi i shpeshtë. Dhe tanë

ai do ta takonte. Mund të shpallnin fejesën. Pse jo? Apo ndofta ishte shpejt? E pse të ishte shpejt?

Ushtari e braktisi shtegun që kishte zgjedhur dhe i ra pjerrësisë drejt, duke kapërcyer shkurret e bushit e duke shkarë nëpër guralecët. Çanta i hidhej mbi shpinë dhe kutia e konservës e godiste. Ngjiti edhe një bregore tjetër dhe ja... përparrë syve i doli fushëza e shtrydhur midis një morie kodrash dhe e çarë nga një vazhdë e përdredhur, që ndriste nga dielli sa të merrte sytë. Ky ishte lumi. Një lumë i çuditshëm, i kaltër, i rrëmbyer, i egër. Kurse degët e tij ishin ujëplotë, të qetë, po të turbull gjithmonë! Ujërat e këtij lumi të vogël, pas rrjedhjes së rrëmbyer nëpër gryka, dremisin një hop në fushëz, sikur çlodheshin për rrugën tjetër, që ishte edhe ajo e rrëmbyer. Në këmbë të kodrave shtriheshin fshatra të vegjël, me shtëpi shumë të larta e me çati të murme, me kopshte mollësh, me erën e veçantë e të dashur të fshatit.

Udhëtari u ul mbi një gur të bardhë. Pjerrësia ishte mbushur me bedunicë, që kundërmonte një erë të rëndë, që ishte si një afsh i pakuptueshëm. E gjithë kjo rrëpirë ishte vendi i bedunicës. Fshiu djersët. Ndjehej aq i gëzuar e i lumtur dhe nuk e kuptonte dot nga buronte gjithë kjo lumtëri: nga qielli i thellë e i kaltër i qershorit, nga shkëlqimi i ujërave të lumit që të merrte sytë, nga mali, nga tokat e gjelbëra me misër, ku lëkundeshin si në një valle të largët shamitë e bardha të nuseve dhe kapelat prej kashte të çupave, nga era e bedunicës, apo nga ajo kreshtë e bardhë e Tomorrit, si në mjegull, prapa së cilës ishte fusha e madhe ku lumenjtë janë të gjatë e të qetë... ku tani ajo ndofta ka hyrë me drapër në grunore?

Ushtari ja mori një këngë.

«Sa i madh është vendi ynë!» mendoi ushtari. «Ja... kësaj bime këtu i thonë bedunicë, më poshtë i thonë cfagë, ne i themi sherbelë!..»

Në rrëpirë i zuri syri tre djem të vegjël, që mblidhnin bedunicë. Ai u ngrit dhe u nis drejt tyre.

— Ej! ushtar! — tha njëri nga fëmijët, koka tu-lle e të cilit nuk e fshihet dot që ishte kuqo. Fytyrën e kishte tërë prenka, si shumica e kuqove. U afruan edhe dy djemtë e tjerë. Nuk ishin më shumë se dymbë-dhjetëvjeçarë.

— Ku e ke automatikun? — pyeti kuqua.

— S'kam! — tha ushtari. — Unë shkoj me leje!

— Nga posta vjen?

— Ç'të duhet ty? — qeshi ushtari.

— Léri ato! Sikur nuk e di që kjo më duhet edhe mua! Apo s'ta mbushim syrin ne të tre?

— Jam me leje! — qeshi ushtari. — Nga posta po vij.

— Ik, or kuqua i dreqit! — tha tjetri, i pakët, flokëzi. — Pse, po të ishte ashtu siç mendon ti, do të bridhët në mes të ditës duke kënduar?

— Ik, or cmingo! Se mos di ti nga dinakërítë! — tha kuqua.

Ushtari u shkul së qeshuri. Ndenji me ta, bile i tregoi kuqos lejnë.

— Për vete e mblidhni bedunicën?

— Ik, or, tej!.. Pse, privatë jemi ne? — tha kuqua.

— Mbledhim pér kooperativën dhe marrim pika...

— E sa pika?

— Djemtë ulën kokën.

— E kanë vënë normën shumë të madhe! — tha i treti.

— Ç't'ju bëj këtyre të dyve që janë frikaçë e kllën-gjë — tha kuqua, — pa ngjitesha në shpellën e Boz-jakut unë dhe të shihje ç'bedunicë të blidhja!

— Ku është kjo shpellë? — pyeti ushtari.

— Oh! A! je nuk hipet kollaj. Pastaj ka edhe një guvë të tmerrshme. Asnjieri nuk ka hyrë brenda saj!

— Pse s'ka hyrë?

— Nuk e di!

— E di unë! — tha kuqua. — Hedhin gurë bren-

da dhe dëgjohet sikur bien në pus, humbasin dhe vjen një tringëllimë e fortë sikur gjëmon moti.

— Timotheu, që ishte psallt, thotë se është guvë e shenjtë, brenda ka ikona...

— Ik, or kllëngjë! — tha kuqua. — Unë do të hyj ndonjë ditë dhe do t'ja nxjerr në shesh gënjeshtat atij Timotheut!...

— Lamtumirë djema! — tha ushtari. — Mos u bëni frikacakë!

U ngrit, rregulloi rripin e çantës së shpinës dhe, me një kërcim të madh, kapérxeu një shkurre. Prapa shpinës dëgjoi zërin e fortë të kuqos.

— E dëgjuat ushtarin, ë? Kllëngjot e dreqit!
Ushtari buzëqeshi.

Ishte duke dalë në xhade kur befas dëgjoi nga rrëpира me bedunicë një zë të dridhshëm e të trembur.
— Ushtaaaar! ... ushta... a... ar!

Ai ktheu këkën. Fëmijët nuk dukeshin më. Vetëm rrëpира bojë hiri ngrihej mbi krye. Pastaj zëri i dridhshëm, i këputur përsëri:

— Ushtaaaar!

Një maqinë po vinte në xhade.

«Të hipja këtu, pas një ore isha në qytet» — mendoi ushtari. Por përsëri zëri i fëmijës iu drodh në vesh si një trumbetë alarmi.

«C'kanë fëmijët vallë?» mendoi. «Dhe pse i dri-dhet zëri kështu?»

Ushtari vërejti maqinën që po frenonte. Dhe, përcudi, maqina kishte targën e rrethit të tij.

Ushtari i ktheu shpinën xhadesë dhe u nis me vrap përpjetë. Zëri i fëmijës, që tanë nuk e thërriste më atë, u drodh në ajër. Qëndroi një çast që të shihte se ku ishin, vuri duart në gojë si hinkë dhe thirri: «Erdha...»

* * *

— Ushtar... — pëshpëriti djali flokëzi me sytë e zmadhuar nga frika. — Kuqua u zhduk!. . Humbi në guvë!..

— Si humbi? — pyeti ushtari i shqetësuar.

— Ne... hipëm këtu... në shkëmb. Ai tha: «Unë po e fut një herë kokën në guvë». Futi gjysmën e trupit dhe doli. «S'ka asgjë! tha. «Brenda është errë-sirë e madhe dhe mban erë dhe. Unë do të futem i téri!» Hyri brenda pastaj klithi dhe nuk po del më!..

Ushtari hetoi shpellën. Kjo ishte një e çarë në shkëmb, sa mezi të nxinte.

— Ti vrapo në fshat — i tha ushtari djalit tjetër, që nuk kishte hipur në shkëmb. — U thuaj të sjellin qumë... shumë litarë. Edhe një elektrik dore! Mos harrosh gjë, é?

Djali vrapoi tatëpjetë.

— Si e ka emrin ai? — tha ushtari.

— Nuni!

Ushtari mbështeti duart pas shkëmbit dhe futi koken në të çarën e shpellës.

— O Nuniii! — bërtiti.

Një përplasje e tmerrshme ajri u përpëlit nëpër faqet e shkëmbit, në brendësi, gjëmoi si këmbanë dhe nga thellësia u ngjitën mijëra tinguj të çuditshëm, sikur rrukulliseshin gurë.

«Qënka thellë» mendoi ushtari dhe një shkumë e ftohtë iu derdh nëpër peshkun e kurrizit, sikur i hohën ujë.

— Të hedh një gur? — tha flokëziu.

— Jo! — tha ushtari dhe hoqi çantën nga shpina.

Preu një shkop thane dhe e futi në të çarën.

— Ti thua se më parë thirri që nuk kishte asgjë?

— Po! — tha fëmija. — Thirri dhe pastaj klithi.

— A e mban mend mirë që u zvarris një copë herë pastaj tha: «S'ka asgjë?»

— Po... por pastaj klithi!

«Hyrja në guvë duhet të jetë e sheshtë, pastaj

mund tē ketē një vrimë si pus...» mendoi ai dhe futi shpatullat brenda.

— Mos hyrë!.. — u lebetit flokëziu.

— Pusho! — tha ushtari. — Unë do tē dal prapë. Por po atë çast i shkrepi një mendim tjetër.

«Po sikur hapësira tē jetë shumë e ngushtë dhe tē mos kem mundësi tē vërtitem?.. Më mirë ndofta është që tē hyj me këmbët përpara...»

Futi këmbët deri në gjunjë. Nisi tē zvarrisej. I dukej sikur zvarrisej në një pritë buzë kufirit, duke përgjuar zhurmat e huaja. Hyri deri në mes. Me majat e këpucëve godiste me dyshim dheun e njomë. U shty edhe pak më prapa dhe goditi truallin me majën e këpucës. Trualli ishte i fortë. Tani kishte hyrë deri në supet. Pa, poshtë shkëmbit, qiellin e madh, tē kaltër e tē paanë. Fushëza ishte larë në një dritë tē bardhë. Shamitë dhe kapelat prej kashte në arat me misër lëvizën tē shqetësuara e u mblohdhën tufë.

«Ka arritur djali!» mendoi ai. «A do tē mbajë mend vallë pér një dritë?»

Futi gjithë trupin dhe u zvarrit prapa. Një lëvizje e njërsës këmbë... një goditje me majën e këpucës. Edhe një shtytje tjetër. Tokë. Edhe një... befas maya e këpucës rrahu në humnerë dhe ai e lëvizi këmbën e shtrirë në boshllék. Përreth, dhe i lagësht. Ngushtësi. Në peshkun e kurrizit, po ajo shkumë e ftohtë. E çara ishte disa metra përpara dhe drita tē vriste sytë. Sa e bardhë dukej kjo dritë! U zvarrit deri në hyrje tē guvës dhe doli. Sa kohë kishte kaluar vallë duke u zvarrisur ashtu, si kërmilli? Kush e di?

Nën shkëmb ishte mbledhur një turmë njerëzish. Ushtari hetoi fytyrat e tyre tē vrara, tē murrëtyera. Një grua flokëkuqe ishte përbysur mbi një gur dhe supet i ngriheshin e i uleshin nga dënesë tē shurdhëra... zë. — Pusho, de! Mos e qaj pér së gjalli!.. — tha një

Ushtari i hutuar fshiu dheun e verdhë, që i kish mbetur mbi xhaketë, pastaj e qiti fare dhe mbeti me këmishën e bardhë prej pambuku.

— Ç'na thua, ushtar? — pyeti një burrë i thyer.

— Për disa metra vendi është i sheshtë. Pastaj, duket sikur ka një humnerë — tha.

Gruaja, që kish ngritur kryet, e uli prapë me një ulërimë si të një njeriu të plagosur. Një burrë i gjatë, i dobët, me një kapele të zezë, pëshpëriti:

— Kështu ishte e thënë! Mos u helmo, o e helmuar! Shpella e Bozjakut është e shenjtë. Kush hyn atje nuk del i gjallë!

— Pusho, Timothe! I kemi dëgjuar këto përralla!

— tha një tjetër. — Tani po ngjitem unë në shkëmb. Më lidhni me litare dhe do të hyj brenda!

— Jo! — tha ushtari. — Do të hyj unë.

— Ti? Ty nuk të njohim. Kush je ti?

— Jam ushtar i postës. Po kthehesha me lejë në shtëpi.

— Pse të mos hyj unë? — tha një djalë nga gjashtë-mbëdhjetë vjeç.

— Unë jarn më i fortë se ju — tha ushtari. — Jam i stërvititur.

Mbi shkëmb, me atë trup të bëshëm e me muskujt që i ravizoheshin nën këmishën e bardhë, ushtari ngjante si një shtatore e latuar në gurë të bardhë.

— Shpëtomani!.. Zemra më thotë se është gjallë!

— tha gruaja.

— E shpëtoftë perëndia... — pëshpëriti burri me kapele të zezë.

Poshtë, në xhade, qëndruan dy gaze dhe disa njërez u ngjitën me vrap përpjetë.

— Shikoni! — pëshpëriti dikush. — Po vijnë nga rrethi. Kur shkoi lajmi deri në qytet?

— Lajmi i zi është si vetëtima! — tha Timotheu.

— Ah, mor djema! Ajo që u bë, nuk ndreqet më tanë!

Ushtari zbriti nga shkëmbi dhe u ul mbi një gur, i menduar. Po... vetëm ai e dinte se si ishte guva tanë; vetëm ai i dinte disa të fshehta të saj. Thirri pranë fëmijët, që kishin qenë me kuqon dhe i pyeti:

— Si u fut Nuni në guvë, me kokën përpëra apo me këmbët?

— Ja... ashtu si ti!.. me këmbët!

«Është zvarrisur prapa!» mendoi ushtari. «Por është zvarrisur shumë shpejt dhe kur ka arritur në humnerë, e ka tërhequr pesha. Po të kishte hyrë ndryshe, nuk do të kishte më shpresa.... Sikur gryka e humnerës të jetë aq e ngushtë sa të mos e linte ta tërheqë koka poshtë, ka shpresë... Ndofta ka rënë më këmbë...»

— Sidoqoftë — tha ushtari, sikur ndiqte vazhdën e mendimeve të veta — gjallë a vdekur, s'mund ta lëmë fëmijën atje brenda. Le të ngjiten disa nga të rinjtë me mua mbi shkëmb dhe lidhmëni me litarë!

Figura e gjatë dhe e zezë e Timotheut iu afrua dhe i përshpëriti:

— Ushtar! O bir! Ti po lot me jetën tënde. Je dhe duke u kthyer në shtëpi! S'ka asnje shpresë që djali të jetë gjallë... Pse të mbetesh edhe ti atje, në mes të errësirës së frikshme? Ku e di dot se sa thellë është?

Pushoni! — tha rreptë ushtari. — S'kini turp? Ne nuk e kemi jetën vetëm përvete!

— Ej, shpëtoje, o zot, gjynahqarin! — pëshpëriti Timotheu.

Ushtari hipi prapë në shkëmb, e lidhën kryq e tërthor me litarë, nën sqetulla, pas mesit...

* * *

Dhe hyri në shpellë ushtari. Ndezi elektrikun dhe u zvarrit ngadalë; pastaj bërtiti:

— Tani, lëshojeni litarin ngadalë! A më dëgjoni?

Jashtë zëri i tij erdhi si një gjëmim i potershëm borish. Ushtari u var mbi humnerën e ngushtë dhe ndjeu se si iu përgjigjen disa zëra të mekur, të largët.

«Çudi!» mendoi. «Unë s'jam as shumë thellë! Pse vijnë kaq të dobët zërat e tyre? Më poshtë ndofta nuk do të dëgjohet asnje zë!»

Deri këtu humnera ishte si një grykë e ngushtë

pusi. Një fërgëllimë shpresë si një valë e ngrohtë u derdh në tërë qenjen e ushtarit.

— Lëshoni prapë litar! — bërtiti. Nga lart dikush lëshonte, duke ngurruar, nga një centimetër litar. Po zbriste shumë ngadalë.

Ishte shumë ftohtë. Ushtari vërejti faqet e humnerës që ishte si grykë pusi. Një gjë e bardhë, si pushi i rrodheve, e ftohtë, mbulonte dheun. Ishte një myk i vjetër dhe i trashë. U mundua të drejtojë rrymën e dritës poshtë. Po nuk pa dot asgjë; drita godiste vetëm këmbët e tij të varura në një hapësirë të ngushtë.

«Do të jetë thellë!» mendoi ushtari dhe përsëri shkuma e ftohtë iu derdh nëpër shpinë.

«Gjallë a vdekur, fëmija duhet nxjerrë!» tha dhe mbështeti këmbët si bigë mbi mykun e bardhë të faqeve të humnerës.

«Ata lart po e lëshojnë shumë ngadalë litarin» mendoi. «Siç duket, kanë frikë se mos përplasem!»

Drita tani nuk para i hynte në punë. Mendime të befta e të panjohura i shfaqeshin e i zhdukeshin si një mjegull në kokë.

Atje lart qëndruan dhe nuk po lëshonin më litar. Ushtari mbeti pezull. Mezi dëgjoheshin ca zëra të largët e të dobët si zukatje mizash. Vetja iu duk brenدا një nate të çuditshme, kurse përtej saj, diku, zu-kaste jeta e largët e ditës së gjatë!

«C'kanë?» mendoi. «Pse qëndruan?»

U kujtua se nuk u kishte thirrur asnjëherë, kurse atje sipër kishin vendosur që ai të bërtiste vazhdimisht se si ishte, sepse zëri i tij dëgjohej mirë.

— Shtoni litarin! — thirri. — Shpella është e thellë!..

«Sa metra kam zbritur vallë? Dhe a mund të mos vritet njeriu po të bjerë nga një lartësi e tillë?»

Papritur, siç ishte ashtu me këmbët bigë mbi mykun e dheut, iu kujtua të kërkojë gjurmat e djalit. Por gjurma s'kishte. Dukej sikur fëmija kishte shkuar poshtë si një gur.

Humnera u ngushtua. Ushtari e kuptoi se nuk do

t'ja nxinte shpatullat dhe u mbështet me këmbë e me duar. Litari i tendosur tani po përdridhej e lëkundej mbi kokën e tij si gjarpër.

— Mos lëshoni litar! — bërtiti dhe lëvizi ngadalë, duke u munduar të shkasë nëpër ngushticë.

«Sikur të jetë kështu deri në fund, nuk do të hyj dot. Nuk do të m'i nxërë supet!» — dhe, për herë të parë në jetën e tij, mallëkoi supet e gjera.

«Duhet ta shëmb dheun!» — tha dhe thirri edhe një herë:

— Më ngrini! — thirri dhe për herë të parë i lindi dyshimi në e kuptionin mirë vallë ata lart. Por ndjeu se litarët e shtrënguan pa mëshirë dhe se nxori këmbët nga vendi i ngushtë.

— Mjaft! Më ulni ngadalë! — tha.

U mbështet fort me të dy duart në faqet e humnerës dhe i sëllói dheut me thëmbrën e rëndë të çizmeve. Dëgjoi dheun që shëmbej nën të. Pastaj befas trupi i ra poshtë si hobe, me një shpejtësi të madhe dhe s'pati kohë të mendojë asgjë. Vetëm e kuptoi se nga hunda, si prej një pompe të çuditshmë, po i rriddhë gjaku me forcë dhe po spërkaste mykun e dheut. Veshët i gjëmuant sikur do t'i çaheshin dhe mbeti pezull, duke u lëkundur. Vend i ishte i gjerë dhe ai lëkundej si një pendul ore. Gjaku vazhdoi t'i rrjedhë, po më ngadalë, mbi këmishën e bardhë. Sikur iu errësuan mendimet.

«Pse nuk e mora automatikun?» i vegoi një mendim përcart. «Ah, po! Unë po shkoja me lejë... me lejë... Nuk jam me shërbim!.. Po pse rashë kështu si gur? Apo ndoshta kur hapja vrimën, litari i tëkuzur u shtri dhe pastaj në boshllék rashë aq shpejt?»

Me mundim, nxori nga xhepi elektrikun. Nën një rrymë të verdhë dukej fundi i sheshtë i guvës. Por trupi i fëmijës s'dukej gjékundi.

«Në qoftë se do të ishte i vdekur, duhet të ishte pikërisht këtu! Të jetë gjallë e të ketë lëvizur?» dhe prapë ajo valë e ngrohtë i gurgulloi në tërë qenjen ashtu si gurgullon një rreze drite në një qiell

të turbullt. Dhe bërtiti me një zë, që sikur s'ishte i tij:

— Më lëshoni edhe tri metra...

Dhe u gjend në fund. Këmbët i shkelën në një tokë të butë, që gjëmonte nga hapat e tij, sikur poshtë të ishte një guvë tjetër. Drejtoi me ankth rrymën e dritës në anët e errëta. Në një skaj pa fëmijën të mble-dhur kruspull.

— Nuni!.. — bërtiti ushtari dhe u lëshua drejt tij. Fëmija nuk lëvizi. Ushtari e rrëmbeu në krahë, i shkopsiti këmishën dhe vurin veshin në zemër. Por nuk mundi të kuptoje asgjë. Herë i bëhej sikur ndjente një drithmë të mjerë dhe herë sikur mbi ata të dy kish zbritur një heshtje e madhe. Vetëm zemra e tij hidhët shkulme gjaku në damarët dhe atij i dëgjohej sikur dikush i ecte brenda kraharorit me hapa të fortë e kumbues. Prapë i buçiti gjaku nga hundët dhe i ra mbi trupin e fëmijës. Një dobësi, e parashur kurrë më parë, po i përshkonte trupin. E tërroqi djalin deri në grykën e shpeliës, e lidhi po ashtu si veten me litarin që kish mbështjellë në mes. Anët e litarit i lidhi fort pas mesit, në mënyrë që fëmija të qëndronte pingul nën këmbët e tij.

— E gjeta... Më ngrini! — gjëmoi zëri i tij atje lart.

Ndjeu se po e ngrinin me shpejtësi, kurse gjaku po i rriddhët akoma nga hunda. Në gojë kishte shijën e tij të hidhur dhe pështyu mbi mykun e humnerës. Dhe ndodhi prapë diçka që ai nuk e priste. Supet iu shtrënguan pas vrimës, që kish zgjeruar më parë, kurse ata lart vazhdonin ta têrhiqnin. Supet iu mbështetën në një send të fortë. Fëmija, si një gur i varur në këmbët, e têrhiqte drejt thellësisë. Litari i hyri në trup. Ja, tani ai ndjente litarin në tërë qenjen... në brinjë, në sjetulla, në supe; e ndjente se si kjo qenje kryenece... litari, po thellonte vijat, po i hynte në mish...

— Mjaft.. Më lëshoni!.. — bërtiti. Por, siç duket, askush nuk e dëgjoi. Vazhdonin ta têrhiqnin me kokë-fortësi. U bë e padurueshme kjo têrheqje e pafund dhe litarët që po i hynin në gjithë trupin...

«Po të mos i mbledh fuqitë dhe të thërras me forcë që të më lëshojnë... mbarova» i shkrepit në mendje. Dhe e vërviti edhe një herë kokën lart, drejt honit të errët që shihet si një masë të zezë pa formë mbi veten e tij.

— Më lëshoni!..

E kuptoi se u lehtësua, zbriti e mbeti prapë varur në hapësirë. Ngriti duart dhe ndriçoi mbi krye. E pengonte një gur. U mbështet i téri mbi të dhe e lëshoi veten. Guri u shemb e ra në fund të guvës me zhurmë. Dherat i ranë mbi flokë. Nuk thirri dot më, por e ndjeu se po ngjitej, se si zmadhohej një drithë e zbetë, se si drita u bë lëmsh i bardhë e i padurueshëm për sytë. Nuk i kujtohej se si i bëri ato pesë metra që duhej të zvarrisej. I kujtohej se në mendje i hyri një vegim i tmerrshëm, diçka e bardhë që ndofta ishte drita e ditës...

Pas kësaj, ushtari pati një anemi të gjatë. Dhe qëndroi tre muaj në spitalin e qytetit...

Dhe përsëri, çdo gjë i dukej e madhe, pa kufi; si atë ditë në qafën e malit. Dhe ishte i lumtur ushtari! Pranë tij, në një shtrat tjetër, në kryet tullë të Nunit, flokët ishin rritur të kuq e të fortë si gjemba e iriqit!

HAPAT E FUNDIT TË «SHTËRGUT»

«S'paska xhanxhin në udhë! E, ca më mirë, ca më mirë! Ç'më ze sëkëlldia mua se s'ka njeri?» mendoi njeriu i gjatë, i kërrusur, i veshur me xhybe. Prapa shpinës, drejt perëndimit, rrukullusej dielli i ftohtë i majit. Ai e ndjente rrukullisjen e tij, duke vështruar hijen e vet. Hija e shtrembër, e murme, zgjatej e lëvrihej deri në grunoret. Torba e rëndë e tërhiqte më të djathë. Ai doli në rrugën e qerreve. Hija u stërgjat edhe më e u cungua nëpër kanale. Vetëm hija e zezë e torbës lëvrihej me ngulm nëpër pluhurin e udhës, si një gungë.

«Ty... ty... ty... ! Leqendi e madhe me këtë torbë! Që s'gjeta dot një gomar e të hipja! Edhe Aliu, ku kisha shpresë, më gënjeu se gjoja e paskej gomarin në mal!..»

Kështu njeriut të gjatë i vinin në krye ca mendime të turbullta, si uji në gjurmë hajvanësh. Këto mendime ai i quante «të sëkëlldisura».

Po ngrysej. Duhej të bënte katër orë udhë natën. Por nata ishte me hënë dhe, në përgjithësi, këtij njeriu s'para i pëlqente drita e fortë dhe ca më pak i pëlqente dielli. I mjeruar nga mendimet e veta, që ai i quante «të sëkëlldisura», për një çast ai nuk e kuptoi se ishte mbi urën e varur mbi lumë. Nuk e dëgjoi llapashitjen e vrazhdë të ujërave. Pastaj iu muarën këmbët, sepse ura prej thuprash lëkundej dhe u mbështet pas telave të trashë. Teli ishte i ftohtë dhe uji atje nën këmbë

iu duk i turbullt. Vorbujt sikur e ndillnin. Hoqi vë-
shtrimin nga ujërat dhe e nguli në arat, rrëzë lumit,
ku dikush mbushte patatet. Në ledh, i penguar, për-
typte gjembaçë dhe rradhiqe një gomar bojalli, murro.
Fshatari sikur ta kish ndjerë mbi shpinë vështrimin e
ngulët të njeriut me xhybe, e la shatin dhe ktheu
fytyrën drejt urës.

— A...a... Po ikën, o Musa efendi? — tha.

— Po iki! Braho... po iki! — tha me pikëllim
njeriu me xhybe. — Dhe ndofta s'kemi pér t'u parë
më! Eja të takohemi!

— Mos e thuaj atë fjalë, efendi! — tha Brahua
dhe u ngjit nëpër shteg, drejt urës. — Vetëm mali
me malin...

— Ashtu, ashtu! Allahu e ka në dorë! Siç na kri-
jon dhe na bashkon, ashtu edhe na ndan. Sikush ka
udhën e tij, Braho!

Brahimi u ngjit mbi urë. I shtrëngoi dorën. Pë-
llëmbët i kish me baltë të përtharë. Sikur i erdhë një
e ndrojtur pa kuptim, se mos kjo baltë ndynte pëllë-
mbët e bardha të efendiut!

— Të dhëntë zoti ymër të gjatë ty dhe evlatëve
— tha Musai. — Ti, Braho, ke qenë tërë jetën njeri i
urtë dhe me mend në kokë!

«Ky Brahua është njeri i butë dhe i leshtë» me-
ndoi me vete njeriu me xhybe dhe vështroi tinëz mu-
rron që përtypëj përsëri te ledhi. Brahimi i gjorë u
zhyt në mendime të hidhura. Këto mendime nuk i
mbinë aty pér aty Brahimit. Ai e kish parë njeriun me
xhybe që larg. Dhe pér çudi i ish dukur sikur ai lëkundej
shumë në të dy këmbët, si një çalaman, sikur e frynte
era dhe, pér çudi, pér herë të parë iu duk se me të
vërtetë efendiu i ngjante një shtërgu. Ej! C'dreq njeriu
ai Malka i Sheros, që ja kish ngjitur efendiu nofkën
«shtërg». Dhe kjo kish ndodhur ndofta gjashëtë vjet më
parë. Atëhere Malka posa ishte kthyer nga ushtria,
kurse Musa efendiu kish çatisur papritur nga një fshat
i Gorës, ku nuk i ecte havaja, dhe ish ngulur atje në
rrëzë, ku kishte dhera më të majme!..

«Por që atëhere kanë shkuar shumë vjet!» mendoi Brahimi. Malkaështë tani sekretar rinie dhe anëtar i kryesisë! Musa efendiu erdhi e u tha edhe më, sikur të hante farmak e jo byrekë. U kërrus dhe kurrizi i mbiu si xhumbë! Brahimi u troshit një copë herë me këto mendime, derisa shquajti së largmi vetëm shtatin e gjatë të efendiut. Por kur shquajti mbi urë, fytyrën e drobitur, të plakur, që dukej e përvuajtur nga mendimet e gjata e të trishtuara, tha me vete me frikë, se e kish fyer më kot njeriun e zotit!

«Eh! Jazëk! Ç'bëra, ç'bëra! E fyejta kot së koti Musa efendinë! Po ç'tu desh ty, o vulëhumbur, të gojosej... Musa efendinë! Prit kur të të ndodhë gjësendi tani!»

Ndërkokë, në atë heshtje muzgu edhe Musa efendiu i mbiu sërisht mendimi i mëparshëm.

«Ky Brahuështë njeri i lehtë!..» dhe vështroi gomarin.

— Pse ike, o Musa efendi? — theu heshtjen Brahimi. — Ti mund të rrije edhe këtu e të punoje! Këtu tokat janë të mira, të pjellshme. — Brahimi s'e mbaroi dot mendimin e tij, kafshoi gjuhën e shau veten:

«Jazëk! Më hëngri gjuha! Si më rrodhën kështu dhe harrova që Musa efendinë e përzunë nga fshati ynë?»

— Guriështë i rëndë në vendin e tij! Dua të prehem në fshatin tim! — tha Musa efendiu.

«I erdhka rëndë ta kujtojë!» mendoi Brahimi, dhe i erdhi keq.

— Të kiske ndenjur të paktën këtë natë!

— M'u zvordh! M'u zvordh fshati, Brahim! M'u lutën katër a pesë miq! — Ai shikoi rrëth e rrotull.

— Sot më erdhën përvizitë, atje në odën time, goxha milet. Po ashtu, ama, fshehur, fshehur... Do ti që kur ikën të gjithë, gjeta në një qoshe këto para? Demek si hakë e këtij muaji që jemi! Ty... ty... ty... Në ç'sëkëlldi rashë, o Brahim! Kush t'i ketë lënë, thua ti? E dinin që unë s'ua zija me dorë! Se nuk e ka dhënë allahu që të mos u shërbesh njerëzve dhe të marrësh hakën! Kush t'i ketë lënë thua, o Brahim?

— Ku e di unë, efendi?

— Ashtu, ashtu... — tha mendueshëm. — Ku ta dish ti?

Tinëzisht ai vuri dorën e bardhë mbi supin e Brahimit dhe pëshpëriti me një zë tjetër, të thellë e të butë:

— Mbi dhe ka ardhur shejtani dhe ka turbulluar mendjet e njerëzve! Tani atje lart janë të zënë në një luftë! Po do të zgjidhen nga lufta e do të lëshohen si rrufe përvëluese kundër shejtanit dhe kundër atyre që marrin mendjen e mavijes... Se, ja, dëgjo, Braho vëllai, ç'i pat ndodhur njëherë, një farë Demke Poçari, në Kaçjar.. Po prej mote të shkuara, ama! Këtij Demkës ja turbulloi mendjen shejtani dhe zuri të thotë: «Ç'hotë efendiu, janë përralla. Unë nuk ja jap hakën! Unë do t'u vë evlatëve emra kaurë dhe s'i bëjmë synet!» Dhe e zgjati fort fërtomën ky Demka! Mirëpo do ti që pa u mbushur java na i ngordhi kali! Dhe si, pa? U qorollis mu në mes të sheshit, sikur u pengua në erë! Dhe një të penguar, kapër-kupër, u degdis në greminë! Do ti që pas një jave na e goditi një, mos u kujtoftë, damblla, të ëmën? Po çfarë nëne, thua ti? Banicë, ore, banicë, pér qimet e pejkamberit! E shëndoshë që ta çaje e ta bëje katër! Dhe mbeti si bythak i padjegur që as të ngroh e as të ftoh, po vetëm tym lëshon pér të qorruar sytë! Do ti që i sëmuret edhe djali prej një barku dhe po tretej dita-ditës? E ahore i ziu, duke u lebetitur, erdhi tek unë! «Derman, Musa efendi! Më hëngri gjarpëri nën gur! Ajo që bëra unë, mos u kujtoftë!» Më erdhi keq, i ziu insan! E ç'ta zgjat më? Mezi i zbutëm me nuska e me të kënduara pa hesap! Thuaj shyqyr që shpëtuam djalin! Mbeti mashkulli, mbeti oxhaku!

— Pa... pa... pa..! — tha Brahimë.

— Po ti, Braho vëllai, po të biesh në hall, prapë hajde tek unë! Të kam në tefter të veçantë ty unë!

— Falemnderit... — pëshpëriti Brahuë.

— E rëndë kjo e flamosur torbë! — psherëtiu. — Edhe udha është e gjatë!

— Të ta jepja edhe unë hakun... — pëshpëriti Brahim. — Po s'kam të holla me vete!

— Ç'është ajo! Unë ty nuk t'i merrja kurrë! Ja, ti, Brahim vëlla, po të duash, nema gomarin me qira deri në fshatin tim dhe nesër ta kthej.

Brahimi u kujtua se deshi të shpinte në shtëpi një barrë shkarpa, që i kish bërë me natë. Pastaj iu kujtua edhe Demka e Kaçjarit. Dhe tha:

— Paratë mos i zërë në gojë, efendi! Gomarin po ta sjell tani, në minutë..

* * *

Po atë mbrëmje Malka kthehej inga qyteti. Troku i nxituar i mushkës i shurdhonte zérat e tjerë të mbrëmjes. Ai vërvhellente dhe, si njeri i kënaqur, ku-vëndonte me vete. Në aktivin e rinisë, organizatën e fshatit të tyre, e kishin quajtur pararojë e luftës kundër besimeve fetare e zakoneve prapanike.

Nga tribuna ai kish folur ashtu, shtruar, sikur ku-vëndonte me shokët e tij, se si e kishin zbuar hoxhën. Ai e kish quajtuar atë «shkopin më të fortë që i vihej rrotës sonë që çante përpara». Tregoi se si e sheshuan minarenë dhe se si xhaminë e madhe e bënë vatër kulture, se si vajzat hoqën shamilë, që u mbulonin fytyrat... I kujtohej se kishte përfunduar pak a shumë kështu: «Tani mund të themi se s'ka më njeri që të besojë dokrrat e fesë, që të gënjet nga hoxhallarrët. Mund të themi se feja mbaroi, u zhduk...»

E kishin duartrokitur fort. Pastaj sekretari i partisë së rrëthit e kishte quajtur përfundimin e tij të nxituar. «Lufta kundër fesë nuk mbaron me rrëzimin e minaresë...» kish thënë ai. «Kjo luftë është e gjatë...» Thellë, në atë valë gjëzimi e kënaqësie që e kish pushtu-

ar, ai ndjente se nuk ishte i bindur në ishte me të vërtetë ashtu siç thoshte sekretari.

«Si është e mundur që, pas asaj që i punuam ne Musa efendiu, të ketë më njeri ta besojë?» Më të errur iu afrua fshatit. Gjer përtej shtriheshin grunoret. Togjet e jonxhës së thatë prisnin qerret. Në mugëtirë ato dukeshin tepër të murme, si të pathara. Në një ngastër, gruri dukej i shkurtër, si i mpirë.. Mendjen e tij e pushtuan mendimet për grurin dhe jonxhat!

«Duhet të kishim ngritur jonxhën! Koha duket si për shi! Edhe ajo ngastër gruri ka nevojë për një dorë nitrati! Duhet biseduar në kryesi!..»

Në mes të jonxhës, larg, syri i zuri një kalë që kulloste. Malka kërceu nga mushka, vrapi nëpër jonxhë dhe e nxori kalin; i vuri pengoren dhe e la të kullosoë rrëzë lajthishtës.

«Ç'bëhet, ore! Asllani i Lumes e ka lëshuar kalin si në mall të tij! Po t'i thuash që e zumë kalin në jonxhë, do të thotë: «Kush e di cili i paudhë e ka shpenguar, se unë ja lidha fërtomën të shkurtër o derrit!» Dhe pastaj do t'i fusë një fshikull kalit!! Një fshikull kalit? Eh! Sikur të mundte ta kuptonte Asllani që fshikullin duhej t'ja jepte vetes së tij!»

Muzgu u trash si një napë e palarë. Humbën hijet dhe fusha u kredh e u platisht për një çast në një qetësi të trishtuar. Dhe atij iu duk sikur qetësia ishte shumë e gjatë, e zbehtë; sikur qetësia e mbrëmjes mbante erë ujérash të ndenjura, erë zhuli e zhabash.

«Ç'është kjo qetësi kështu?» mendoi.

Pastaj fëshfëritën grunoret. Flladi i mbrëmjes i freskoi ballin e djersit të vrapit pas kalit kërr të Asllanit. Dhe atij iu duk sikur në vend të ajrit të njomë të mbrëmjes, thithë aromën e grurit, që kish brënda edhe erë vajrash të djegura, erë djerse qesh e djersë njeriu..

«Kështu po! Të mbushet shpirti plot! Të ngopet syri! Eh! Ç'drithë të mbarë kemi sivjet!» tha me vete.

«Njeriu, kur është vetëm, mendon shumë» tha,

«dhe mendoka gjëra që një tjetri mund t'i duken të çuditshme!»

«Që s'kam njeri të ma mbajë një këngë! Pa do t'ja dridhja një kënge pér mall...»

U dëgjuan zhurmë potkonjsh prapa kthesës. Dhe befas u duk hipur mbi gomar një njeri. Këmbët e gjata e të holla i zvarrisejshin përdhe. Dukej sikur koka e hiqte përpëra dhe ndaj rrinte ashtu i kërrusur, sikur nuhaste erën e qimeve të kafshës. Në errësirë xhybja e gjatë i jepte figurës së tij pamjen e atij drurit të zi me të cilin fshijnë furrat dhe që këtej i thonë pepellashkë.

«Qenke «shtërgu» tha Malka». Kush e di q'qesëndi ka ndjerë Musa efendiu kur e mësoi se i thërrisinin «shtërg»!

Mushka e Malkës dhe gomari i Brahos iu avitën njëri-tjetrit. Musa efendiu e vari kokën edhe më kur njobu Malkën. E shpoi gomarin në vithe dhe i tha nja katër herë «ush..., o i përshkretë...»

— E, mor ish-efendi!... — s'ju durua Malkës. — Prapë e ke sjellë kokën këtej?

— Sot në mëngjez, shyqyr zotit, sosa në fshat pér ca punë të miat.

— Mos ke mbështjellë lesh në torbë? Apo ndonjë peshtamall si myftiu? Ti, si dhëlpër e vjetër që je, nuk duhet të biesh në gabime të tilla.

— Ty...ty...ty... Larg qoftë! Zoti i sheh të gjitha. Vetëm ai e di zemrën time të paqme! Unë, o shoku Ismail, mora ca teshat e mia, që i pata lënë..

— Tani, po të më dëgjosh mua, ktheu në qytet e ble një kazmë të madhe dhe shtroju punës atje në fshatin tënd! Do të të vijë një çikë si e përpjetë në krye! Se ishe mësuar të fërkosh vetëm tespinë me dorë! Dëgjova se paske thënë që të luten të vesh hoxhë në një fshat në Skrapar, po ti s'dashke vetë! Mos u bëj budalla, se s'gënjet njeri tani nga këto fjalë!

— Ashtu...ashtu...Të paça sa malet.! Të kanë gënjer, o bir, të dhëntë zoti ymër të gjatë! Unë po iki se jam vonë...

- Ej! — u kujtua Malka. — Po gōmarin tē kujt e ke?
- Tē një miku!
- Tē ç'miku?
- Tē një mikut tim nga Sellca — gënjeu Musai.
- Se, në paç gënjer njeri në fshatin tonë, do tē tē zbritja e do tē ta merrja...

— Jo... Jo! Larg qoftë! E kam nga Sellca — tha ai dhe e shpoi prapë në vithe. Gomari mori një trok tē nxituar dhe figura e gjatë e Musait u tund një copë herë mbi samar.

«Ku ishim gjer dje?» mendoi Malka. «Ja, tani, si ikën Musa efendiu dhe si ikën e tretet bashkë më tē në errësirë edhe feja...» Sérish iu kujtuan ato fjalët e sekretarit pér «rrënjet e thella».

«Musa efendiu vjen ose në agim, ose në errësirë dhe zhduket në mbrëmje, prapë në errësirë! Kjo do tē thotë se asnjeri nuk ja shtroi në fshat, asnje besnik më s'i mbeti këtu! Atéhere ku i mbetën më rrënjetë Musa efendiu?»

U err edhe më. Silueta e murme e «shtërgut» humbi diku thellë. Atë sikur e përpiu vala e zezë e territ që mbulonte fushën. Malka dëgjoi shkumëzimin e potershëm tē ujérave. E zbriti mushkën dhe e hoqi pér kapistre nëpër urën prej thuprash. Në mes tē urës mezi dalloj një njeri tē ngarkuar me një barrë shkarpa. Malka e arriu më tē dalë tē urës.

- Qënke ti, Brahim? Si u ngryse? — tha
- Unë jam, o Malkë! Si ma ke qejfin ti?
- Pse je vonuar kaq shumë?
- E... e... prashita patatet në personalen — tha Brahimi.

— Ç'je ngarkuar kështu, si gratë qëmoti? Ku e ke gomarin? Brahim i s'foli. Gurmazi i lëvizi poshtë e lart me zor nga një e gjelltitur. E mbështeti anën me shkarpa pas telave, nxori urorin e bëri tē zërë një zjarr. Xixat ndriçuan fytyrën e tij tē parruar. Malkës iu duk i plakur, i drobitur nga lodhja e nga mendimet.

- Po gomarin ku e paske sot?

— Na! Ndize! — iu sh mang edhe një herë përgjigjes Brahua.

— Unë të them ura, ti më thua ku do hedhim lumen. More! — i shkrepit Malkës në mendje — More Brahim! Po ti ja kishe dhënë gomarin hoxhës?

— E çë, në ja dhashë? S'është njeri edhe ai?

— O Brahim, o mendjemykur! — thirri i nxehur Malka. — Këtu në fshatin tonë rron ti, apo në pyll me arinjtë? A nuk ishe ti në mbledhje, kur vendosi fshati ta zbojë Musa efendinë, atë gënjeshtar e maskara?

— E çë edhe në isha?

— A nuk e dëgjove ti të venë e Rushanit se si e gjennjente me nuska, se si vdiq djali i Rakipit se nuk e shpuri te doktori, se si...

— E çë edhe në i dëgjova? Mua s'më ka bërë ndonjë të keqe! Njeri nuk është edhe ai?

— Jo! Ai është pjavicë! Këpushë! Tani, po t'i bjerë kazmës, mund të fillojë të bëhet njeri si ty!

Brahu heshti. Edhe Malka heshti një hop. Ujërat e turbullta pérplaseshin pas gurëve.

«Po bërtas!» mendoi Malka. «Nuk duhet ta bindësh tjetrin duke bërtitur!»

Brahimi bëri të marrë shkarpat mbi shpinë.

— Ti, Braho, je si ato zhabat, që rrjinë në batak! Nuk po shkon me rrjedhën e lumit, me rrymën, që i përlan të gjitha!

— E? — tha Brahu, — q'thua?

«As kështu nuk bën!» tha Malka. «Brahimi s'të kupton kështu». Brahimi mori udhën. Ekte ngadalë, shtrembër. Barra ishte e rëndë.

«Një anë gomari!» mendoi Malka.

— Brahim!

— E!?

— Lëri shkarpat aty, t'i ngarkojmë në mushkë!

— Mirë!

U nisen në heshtje. Malka mendonte:

«Ja, Brahimi! Brahimi është si ai gruri, që ka dalë i mpirë nga dimri, se ka rrojtur në vende gropë, nën



ujëra. Musa efendiu është uji pér Brahimin. Ai i ka mpirë mendjen. Tani duhet diell, ajër, ngrohtësi! Duhet më shumë zgjuarësi, dashuri, fjalë e ngrohtë pér Brahimin. . »

Vuri re se Brahimi trazonte pluhurin e rrugës me një purtekë.

«Mendohet! Ç'mendon vallë Brahimi?»

— Brahim!

— E?

— Si thua? Mirë apo keq bëre që ja dhe gomarin ho-xhës dhe vetë u ngarkove me shkarpa?

— Ku e di unë?

— Ç'të mirë pate ti nga ai?

— Asgjë!

— Po kush pa të mirë nga këta njerëz, o Brahim?

— S'e di!

— Kur do të ta kthejë gomarin?

— Nesër!

— Ç'do t'u thuash vajzave të tua, o Brahim?

— Pse, vajzave do t'u jap hesap unë?

— Po kur ta marrë vesh fshati, si do t'u ruhesh rrromuzeve? — Brahimi e flaku fshikullin.

— Lëre! — tha. — Fshati do të më qesëndisë! Ndofta s'bëra mirë!

— Jo!

— A bën sikur mos të tregosh në fshat pér punën e gomarit?

— Se mos ka rëndësi kjo, o Brahim? Rëndësi ka që ti të kuptosh se Musa efendiu nuk e ka hak atë që bëre ti! Se ai, para teje, që je një bujk i mirë, që ke vaditur me djersë këtë dhe, është si një këpushë, si një mormolec i ujit, që të hyn në bark dhe të sjell dhimbje!

— Ej! Dreq! Sa ndoresh të vjen pérnofka! Mormolec i thua tani! — qeshi Brahimini.

Ju afruan fshatit.

«Do të më ketë gënjerë derri i derrit!» mendoi Brahimini. «S'besoj t'ja ketë paguar njëri hakun e muajit;

kurse më vuri krunde dhe vajta i dhashë gomarin!
T'ja them se si më génjeu këtij Malkës, apo jo? Ë?»

Brahimi, hëpërhc, heshtte. Malka mendohej:

«Nuk mjafton të prishësh minarenë. Duhet shkulur
një minare tjetër. Ajo ka lëshuar rrënje në një qoshe
të mykur të mendjes së Brahimëve... Këtu të dua
tani!»..

RRITËSIT E DERRAVE

Hajde, or hajde! Mjerë puna e mjerë njeriu që pret sa ta thërrasë puna e t'i thotë: «Eja se ja ku më ke!» — më thoshte një ditë Kovi Doja.

Kovi është njeri që s'bie në sy. I shkurtër, as i ri as i vjetër, flokët i ka të ngjitur pas kafkës sikur ja ka lëpirë lopa. Dimër e verë — një palë pantallona kadi-feje bojë vaji, që i janë krojtur në gjunjë. Kadifeja është zbardhur nga koha, nga udhëtimet, nga shiu dhe nga dielli.

Diku, në një vend të thellë në male, u hap një qendër grumbullimi. Dhe përkohësisht, derisa të pre-gatitej njeri i përshtatshëm vendas, dërguan atje Kovin. Ka edhe Kovi, si gjithë njerëzit, mendimet e veta, ëndrrat, dëshirat... Ka edhe një terjakillék të çuditshëm se, fundja, burri pa një terjakillék, s'është burrë! Mirëpo Kovi nuk është as teriaki i gjahut, as i duhanit, dhe as i rakisë. Është shumë larg tyre Kovi.

Meraku i Kovit janë... peshoret! Ja, ju çuditeni tani dhe shpërvishni buzët. «Njeri i fantaksur» thoni! Po mos u ngutni! Puna e ka lidhur gjithë jetën e Kovit me peshoret sepse ai është magazinier i një depoje, që shpërndan drithë dhe që grumbullon leshin kur qethen dhentë, lëkurat, çajin, salepin, luleshtogun e kokrrën e trandafilit të egër.

Dhe puna e grumbullimit lidhet me peshoret. Vëtëm për një gjë i qante syri Kovit: për një peshore të

mirë. Dhe kur, më nё fund, i dhanё njё peshore pesё-kuintalshe, qё mё tё priste si peshore farmacie, siç thosh ai, iu bё zemra mal e iu duk sikur zuri qiellin me dorё!

Dhe sa u dёshpёrua kur njё ditё i shkova me njё shёnim nga drejtoria qё atё peshore tё ma dorёzonte mua! Mё dukej se çdo rrudhёzё e fytyrёs i vajtonte, sikur i kish ndodhur njё gjёmё. E rrotulloj atё copё shёnim ndёr duar, e lexoi dhe e stёrlexoi... po shёni- mi ishte i qartё:

— Deh... or deh! — bёnte herё pas here. — Tё ta jap peshoren? Po si tё ta jap peshoren ty?

— Pёr nja tre muaj ty nuk tё hyn nё punё, apo jo? Drithёra nuk shpёrndan, kurse ndonjё gjё tё vogёl gru- mbulloje me kapan...

— Tё tё gёnjej, s'tё gёnjej dot. Nuk mё duhet ta- ni! Por, pas nja tre muaj, ama!...

— Do tё ta japim prapё!

— E... he!... Kёshtu thoni ju tё drejtorisё gjith- njё. Pastaj vini e mё pёlcisni kёtu dreqi e di se g'pe- shore! Kurse kjo; or vёlla... kjo s'ёshtё peshore, por balance farmacie! Edhe qimen e flokut e ndan kjo, ta dish! Po unё do ta kёrkoj doemos kёtё. Kёshtu u thuaj, ё? Dhe e mbani mirё. Mos i pёrplasni thasёt mbi tё sikur i hidhni pёrdhe!

— Mirё!... qesha unё. — Po si kjo peshore ne kemi nja dhjetё!

— E njoh unё, edhe nё njёmijё!

Po ndofta si tepёr u zgjatёm me pasionin e Kovit pёr peshoret.

Pra e caktuan Kovin grumbullues nё njё pikё tё re, nё thellёsi tё maleve. Fshatrat, si kopera tё mur- me dhensh, ishin qepur nёpёr shkrepa, nёpёr pjerrё- sitё, nёn shkёmbinjtё. Depua ishte ngritur buzё xhadesё, nё njё lёndinё me fier. Pёrkundrejt saj, buzё lumi, ishte edhe njё baxho. Asnjё tjetёr. Kurse lart mbi kokat e tyre, fshatrat e vegjёl.

Njeriu i parё qё njohu Kovi ishte pa dyshim ba-

xhoxhiu, Lulushi, një djalë si i ngathët në dukje, këmadh, por zot i punës në zanatin e tij. Pas kësaj pusan ditë të mërzitshme vetëm. Vetëm lumi gjëmonë pa prerë.

Grumbulluesit e malësisë s'mund të qahen se i mbyti puna. Mund të kenë punë të shumtë disa muaj në vit, në kohën e dëllinjave për shembull, kurse muajt e tjerë paguhen për të grumbulluar pak gjë. Atë vit malësia e kishte prodhuar edhe bukën vetë. Kovi nuk kishte më drithë për të shpërndarë.

Punë ku mund të të hipë dembellëku... Megjithatë, sa të nevojshëm janë njerëzit si ky për malësinë!

Mendohet e mendohet Kovi në hyrje të depos, vështron shkrepat prapa të cilave ngryset edhe një ditë tjetër...

«Hajde, or hajde!.. Ç'është kjo e shullëhur kështu? Sikur na paguajnë për të hapur e për të mbyllur derën, për të pritur një njeri që sjell një lëkurë!..

Kovi vëren se si atje përtetj në baxho, baxhoxhiu merret me hirrën që e shpie buzë lumit dhe e derdh. Kovit nuk i pëlqen emri i gjatë baxhoxhi, as emri Lush, prandaj i thërret shkurt vetëm «baxho».

Vëren Kovi se si derdhet hirra në lumë, se si kjo punë bëhet natë për natë.

— Hajde, or hajde! — i thotë Kovi. — Ju s'jini në binarë fare! Po qysh derdhet kjo hirrë kështu, or, t'u mbylltë me gurë?

— Ç'ta bëj? — thotë baxhua.

— Pse nuk ua jep këtyre të kooperativave për derrat?

— Qenke prapa ti! — qesh baxhua. — Nuk kanë nisur të rrisin akoma derra këtu. Le që janë edhe fantaikë të prapë!..

Kovit i shkrep përsëri në mendje një mendim që kishte disa ditë që e shqetësonte... që atë ditë kur vuuri re se si baxhua derdhë hirrën në lumë!.. Mbyll depon, kalon nëpër xhadënë tërë gropë dhe shkon në baxho. Baxhua ishte e re, e bardhë, mbante erë bulmet. Dhe Kovit i pëlqen shumë era e bulmetit.

— Ne të dy s'mund të themi se na vrapun!
Apo jo? — thotë Kovi.

— Jo!

— Si thua ti? A do të presim sa të na vijë puna
në derë?

— Po ç'të bëjmë, thua ti? — pyet Lulushi dhe
koka e madhe i varet mënjanë.

— Ne të dy jemi a s'jemi në mvartësi të një mi-
nistrie? — ja vërtit rrotull e rrotull Kovi.

— S'të marr vesh! — thotë baxhua.

— I trashë që je! Ja, de! Ndërmarrja jote e qumë-
shtit me c'ministri lidhet? A s'lidhet me tregëtinë?

— Po!

— Edhe ne grumbullimi me tregëtinë jemi ta-
ni!..

— E pastaj se qenkerkeni me tregëtinë?

E gjithë kjo bisedë kështu rrotull i duket për të
qeshur Kovit. Mirëpo ai e ka menduar me kohë që ta fu-
së edhe ministrinë këtu, sepse ka frikë se mos «ba-
xhua» refuzon. Këtë e quan «të marrët e krahëve» Kovi.

— Ja, pra! Jemi ndërmarrje simotra, siç thonë.
Motër e vëlla. Ne të dy do të bëjmë bashkë një pu-
në!

— C'punë?

— Më parë më jep fjalën që do ta bëjmë e do të
më ndihmosh!

— Më thuaj një herë se c'punë, pastaj...

«Tuaf njeri. C'më polli me këtë! Po sikur të mos
pranojë! Ahere do t'i futem vetë...»

— Meqë s'mund të qahemi se na mbyti puna, a
nuk i hyjmë një valleje? Se njeriu, them unë, nuk duhet
të presë sa të thërrasë puna: «Eja, se ja ku më ke!»

— Folë de, të shkretën, se më nxore thinjët! — tho-
të baxhua.

Kovi i tregon me sy kazanët e mëdhenj me hi-
rrë. Lulushi pyet i habitur:

— Hirra?!

— Po! Hirra dhe të fshirat e depos sonë... Dri-

thi që prishin minjtë... A mbajmë nja katër a pesë derra pér majmëri dhe pastaj ja japid ndërmarrjes?

— Lulushi mendohet.

— Ej, dreq! — thotë. — A e di ti që këtë gjë na e ka thënë njéherë edhe ministri në një mbledhje? Pse s'mbani ndonjë derr pranë baxhove po e derdhni hirrën kot së koti?

— E shikon? A rrihet kështu si unë e ti? Ja, ti sa qumësh punon?

— Gjashtëdhjetë kile! Po të bjerë nën pesëdhjetë, baxhua mbyllët!

— U vrave nga puna! Si thua? E bëjmë atë që tha-shë?

Baxhua kruan kokën.

— Se juve ju ka thënë edhe ministri — e nget më tej Kovi.

— Au!.. Sikur të bëhen të gjitha sa thuhen!..

— Le ta nisim ne! Unë sjell derrkucët nga ndërmarrja jonë. Mua po më vjen doresh pér murator. Gurë kemi, baltë kemi, furka presim në pyll... Bëjmë një koçi pér derrat.

— E ç'ti bëjmë më pas?

— Tuaf që je, ore! I bëjmë nga tetëdhjetë kile dhe i themi ndërmarrjes: «Urdhëro, sill maqinën e merri derrat pér të therur». Dhe kështu shtohet mishi pér popullin.

— Ptu!.. — kundërshton baxhua. — Ç'janë pesë derra pér ndërmarrjen tuaj? Një pikë uji në det!

— Ua! Qenke tuaf ti! — inatoset Kovi. — Ke parë kur ziejnë raki? Edhe aty nga një pikë rrjedh raka, po mbushen gjyma, ama, prej asaj pike...

Baxhua kruan kokën përsëri. Zgjat dorën, që mban erë bulmet dhe e tok me dorën e Kovit, që mban erë dëllinjë.

— Na vaftë mbarë! — thotë Lulushi.

Kështu nisën të rritin derra pér majmëri në një pikë të largët në male, ku kishte një depo grumbullimi dhe një baxho!..

LULISHTJA MBI VARREZA

Plaku po kthehej nga shetitja në lulishten e vjetër të qytetit. Vapa i rëndonte mbi shpinën e kërrusur dhe këmbët sikur i qenë trashur. Atë mbasdite nuk kishte fjetur dot. Ky afsh korriku, që dridhej si avujt mbi një kazan me ujë të valë, ishte shumë i rëndë e i bezdissħem. Një fëshfërimë e butë gjethesh sikur e ndolli drejt lulishtes së re. Por përnjëheresh plaku u step. Lulishtja ishte ngritur mbi dheun e varrezave të vjetra. U ul në stolin e trotuarit. Dielli i binte mbi sytë. Plakut sikur i erdhi pér të dremitur.

«Ja.. këtu prapa kurrizit tim, ishin varret...» mendoi. «Varret dhe kryqet. Kryqe prej mermeri të bardhë, kryqe të rënda guri, kryqe të drunja, të krimmbura e të vajisura, kryqe të humbura në mes të barit. Dhe qetësia e përjetshme. Vend i errët, i zymtë. Netve s'pipëtinte asnijë zë. Ditën harabelët bridhnin nëpër dru-rët. Harabelëve iu lejohet kjo gjë...»

Plaku kujtoi se si kishte qenë këtu disa vjet më parë. Dikur varrezat ishin ndanë qytetit. Mirëpo qyteti zmadhohej çdo ditë dhe varrezat mbeten si një lungë e keqe në mes të ndërtesave të reja. Dritaret e apartamentit të plakut shikonin tamam mbi varreza dhe atij gjithnjë i qe dukur një ogur i zi që i kishin dhënë ato dhoma kundrejt varrezave.

Dy vjet më parë kishte filluar shtegtimi i kryqeve drejt vendeve të shkreta. Ishte rrëzuar tempulli plot engjëj të bardhë i varrit të një ish-tregëtarit.

«Dhe mirë u bë..» mejtoi atëhere plaku, që ishte shumë fetar. «Zoti e ka thënë që para tij të gjithë jemi njëloj. Sa mund të hyjë deveja në vesh të gjilpërës, aq mund të hyjë edhe i pasuri në parajsë. Atëhere, ç'të drejtë paska ky të ngrerë mbi eshtrat e veta një tempull, kurse i varfëri të ngrerë një kryq druri si një krah prej sakati?» Plaku kishte qenë kundër kësaj gjithë jetën e vet.

I kujtohet se si nëpër maqinat e zeza dhe nëpër karrocat e qivureve me dantella të zeza nëpër anët, ishin bartur eshtrat drejt vendit të shkretë, drejt strehës së re. Dikush bashkë me eshtrat shpinte edhe kryqin e gurtë. Kryqet prej druri s'i përfillte asnjeri. Ata ishin kalbur. Një ditë, i mblodhi të gjithë bashkë një karrocë e komunales.

Dhe mbetën vetëm drurët.

Mbi varrezat, si për çudi, po mbinte lulishtja. Nga dritaret ai vështronë qdo ditë se si rritej kjo krijësë e re: lulishtja. Bile në fillim ajo nuk i ngjante lulishtes, po ishte një gjë pa formë, me rrugëza tërthore të shtruar me pluhur tulle. Më vonë u mboll bari dhe lulet. Erdhi edhe një kujdestar. Ky ishte një punëtor i thinjur, me rroba gurkali.

Plaku ishte mësuar me atë heshtjen e thellë të varrezës, me frymëmarrien e saj të kalbur, me errësirën. Tani kishte shumë diell, potere dhe erë... Por plaku ishte fetar. Kishte punuar shumë vjet si murator në manastiret e Malit të Shenjtë dhe kishte sjellë shumë ikona. Plaku mburrej me ikonat e veta. I biri, murator, thuajse nuk hynte kurrë në dhomën e plakut.

Si fetar plaku ishte hidhëruar që kishin guxuar të përdhosin vendin e shenjtë, qetësinë e përmortshme të eshtrave. I dukej se ishte prishur e gjithë qetësia e shpirtrave, që fluturonin lart.

Si njeri që kishte punuar një jetë të tërë me gurët e ashpër, iu duk e mirë që u prish ajo pabarazi e madhe e kryqeve. Plaku e dinte se në vendin e ri, të shkretë, nuk do të kishte më tempuj plot engjëj.

Në lulishte mbinë lulet. Dhe bari rritej si i harbuar.

Plaku kundronte tinëz lulishten. Ajo ishte e shkretë. Pothuajse askush nuk kalonte mbi tokën e varreve që ishte përzier me pluhur tulle.

«Ehe! ..» mendoi plaku. «Njerëzit u druhen varreza të vjetra. Ikën varrezat, po mbeti hija e tyre e rëndë. Thuaj si të duash, po feja ka rrënëjë të thella!»

Plaku ngrivej vonë dhe nuk e kishte vënë re se si herët në mëngjez nëpër lulishte kalonte një turmë punëtorësh. Ditën e katërt i vuri re dhe pshëretiu:

«Sidoqoftë, këta janë punëtorë, të rinj! I bien shkurt për në fabrikë! Po ku m'i ke moshatarët e mi, ë?»

Të nesërmen në lulishte qëndruan fëmijët e një kopshëti. Ata nisën një valle të çuditshme përmbi dheun e varrezave.

«Eh!» pshëretiu plaku. «Fëmijët janë si zogjtë. A nuk ishin zogjtë të vetmit këngëtarë të varrezës?»

Erdhi vera. Në lulishte erdhën pleqtë e parë. Plaku shetiste ngadalë deri në lulishten e vjetër të qytetit, ku mblidheshin shokët e tij. Por ai ishte shumë plak. Rruga e lodhëte.

— Baba! — i tha muratori. — Pse shkon aq larg? Ja ku është lulishtja e re, dy hapa më tej! Edhe hija e drurëve është më e mirë.. !

— Se e përdhosët ju vendin e shenjtë, nuk do ta përdhos edhe unë!

Kudo rëndoi zagushia. Ai vështronte lulishten nga dritaret. Kujdestari këndonte një këngë sipas një avazi të vjetër dhe bridhte me markuç në dorë. Vapa e përcëllói barin, që u tha pothuajse kudo. Vetëm mbi varet bari ishte i gjelbër, sikur ushqehet me lëngjet e jetëve të shuara. Plaku kishte dëshirë të bisedonte një herë me kujdestarin e lulishtes, që e mbante barin të gjelbër. Ç'njeri ishte ky vallë, që shkelte si pa të keq mbi gjurmat e kockave të kalbura dhe s'kishte asnë shqetësim? Mirëpo kujdestari s'para ja vinte veshin vështrimit kureshtar të plakut.

Marazi më i madh për plakun nisi atëherë kur në lulishte ndërtuan një hauz dhe sollën peshq. Thoshin se kishin sjellë ca peshq të kuq. Atëherë lulishtja u bë

si pazar, njerëzit mbidheshin rrerth hauzit, kundronin peshqit dhe u hidhnin aq thërrime buke sa kujdestari, i ngrysur, detyrohej ta pastronte çdo ditë hauzin. Pastaj kureshtja u shua, por që ato ditë, në një qoshe të lulishtes, nën hijen e dendur të rravepe dhe po aty ku kish qenë tempulli, filluan të luajnë domino ca pleq.

Plaku e merrte me mend se ç'kënaqësi duhet të ishte atje... hije, fëshfërítje e fletëve mbi krye dhe mbi të gjitha, dominoja! Plaku vdiste për një çikë të lojtur. I binte shpesh më qafë të birit në shtëpi, po ai e luante pa zemër, nuk e përplaste gurin mbi tryezë dhe, bile, harronte të thërriste: «Gur një!...» Dhe ja, tani, djalli i kishte shtyrë këta moshatarë të tij të harronin shumë gjëra menjëherë!

«Siç kam rrojtur, do të vdes,» mendoi plaku. «Nuk do t'i përdhos tani në buzë të varrit varrezat!» dhe dremiti mbi dërrasat e ashpra të stolit.

* * *

Muratori mbështeti bërrylin mbi sërën e tullave që posa kishte shtruar, ndezi një cigare dhe e thithi tymin thellë. Nga skela dukeshin pullazet e shtëpive të vogla me tjegulla të nxira nga vjetët. Nën vapën përvëluese të korrikut çatitë dukej sikur dreminsin. Po sa kishte lagur soletën e katit të tretë dhe një afsh i mërzitshëm nuk ndahej nga konturet e ndërtëses. Në rrugë zhurmonin maqinat dhe karrot. Retë e pluhurit ngriheshin deri lart dhe trazoheshin me afshin e valës së ujut që avullonte.

Njëqind hapa nga ndërtesa ishte lulishtja, lulishtja që kishte mbirë mbi tokën e varrezave. Në drurët e mëdhenj krokatnin pa pushim një grumbull sorrash; që nga skela lulishtja dukej më shumë si një livadh i pakositor, i harruar në mes të ndërtësave të kuqe. Muratori apo kish lexuar në një revistë për lulishtet, që ata i quanin «qilima të qëndisur shumëngjyrësh!» Ai kish qeshur. Ç'nuk i pjell mendja njeriut! Ai e kish kluar fëmininë në fshat. Në lulishte syri i ngopej vetëm

me gjelbërimin e barit të lartë. Edhe nga lulet, më të bukura i dukeshin lulet e brishta, që mbinin vetiu në mes të barit.

Eh!.. Lulishtja e brengoste gjithnjë muratorin, i sillte mendime të zymta, të pazgjidhshme. Ajo ishte nën dritaret e apartamentit të tij.

— O Ndrek!

— E? — tha ai.

— E ke humbur fare! — tha Refati. — Po të mendohesh kaq shumë, do bëhesh fillozof!

— Kam një brengë, Refat, — tha Ndrekua.

Muratori vërviti bishtin e cigares mbi soletë dhe e mbushi mistrinë me llaç; pastaj filloi të radhitë tullat me ngut. Refati e vërente me bishtin e syrit. Kishte ditë që e vërente. Posa ngritën skelat e katit të tretë, përkundrejt lulishtes, atij sikur iu pat shtuar edhe më ajo brengë e fshehtë. Po Refati ndruhej ta pyeste më tej. Nuk ja kishte ënda të gërmonte atje ku nuk e ftonte njeri dhe prandaj Refatin e hiqnin për njeri të mbyllur. Po Ndrekua e dinte se ç'zemër të dhemshur kishte ky murator i vjetër.

— Mos është plaku yt ai në rrugë? — e pyeti Refati. Ndrekua la mistrinë. Në trotuar, nën hijen e mureve të ndërtesave, capitej i kërrusur një plak. Babai dukej i lodhur, sikur i rëndonin dyfish të gjitha vjetet e jetës së tij. Në rrugë kaloi me shpejtësi një maqinë riportabël dhe e mbushi me pluhur, pastaj një karrocë që e hiqte një kalë kerr. Plaku pështyu pluhurin dhe ngriti bastunin e përshëndeti karrocierin e vjetër.

— Ku vete kështu nëpër zheg? Mos të kërkon ty?

— pyeti Refati.

— Jo! — tha Ndrekua. — Është njeri zevzek. Ka qenë edhe ai murator si ne. Prandaj nuk i rrighet brenda.

— Pse nuk i thua të çlodhet nën rrepet, me pleqtë e dominosë, po shitet në këtë vapë? Për pleqtë e përfëmijët i bëjnë lulishtet, apo jo?

— Ku ta dish sepse? — murmuriti Ndrekua dhe heshti.

Plaku nuk hyri në rrugicën e shkurtër të lulishtes,

që do ta nxirrte në shtëpi, po dredhoi në xhade, ku shkonin pa pushim maqina, që e mbushnin me pluhur.

«Si u bëka, njeriu!» mendoi Ndrekua. «Nga turpi mund të shtiret si i paditur dhe të gënjejë! A thua ta dijë ky Refati punën e plakut? S'besoj! Këtë e dinë vetëm në lagjen tonë, bile vetëm bloku ynë Nr. 7. Ku ta dish vallë që shtyn njeriun drejt gënjeshtës? Turpi, ndrojtja? Apo vetë mendimet e errëta, që kanë mbetur në qoshe të vjetra të trurit të tij? Po sikur t'i kërkoja Refatit një këshillë? Ja, unë i thashë se kam një brengë, dhe ai nuk më pyeti q'brengë është kjo! Pse s'më pyeti? Po pse të më pyeste? Ka njerëz që e kanë në gjak të gërmuarit e të mërzitin me pyetje. Refati është ndryshe. Me siguri mendon se mund të më lëndoje po të më pyesë!»

Mendimet e shqetësuarë, të papritura, dukej sikur urdhëronin edhe duart që të punonin sipas ritmit të tyre. Zylyftari, zeshkan, i zhveshur deri në brez, që sillte llacin, po gulçonte si kalë. Djersa i rridhte nëpër faqet e zeshkëta dhe i mblidhej në gropën e mjekrës.

— E dërmove djalin! — tha Refati. — Një herë të mbyten gjemité dhe rri si i rrahu; një herë punon si lokomotivë! S'është punë kjo!

— Sot jemi prapa! — tha Ndrekua.

— A e ndezim nga një?

— E ndezim!

— Thonë se, andej përtëj, nuk i lejonë të pinë duhan gjatë punës — tha Zylyftari.

— Andej? — tha Refati dhe tregoi me dorë malet e zhveshura, të murme, prapa të cilave ishte kufiri.

— Të shtrydhin si limua!

U ulën mbi dërrasat e skelës. Lulishtja mbeti prapa shpinës. Nën ndërtesën e re shtrihej pejsazhi i murmë i një lagjeje të vjetër të qytetit. Dukej sikur ndërtesa e re do t'i mbulonte përgjithmonë me hijen e kuqe të mureve të saj gjithë shtëpitë e vogla e të shtrembëra.

— Ama u dërmua kjo fole e varfërisë! — tha Refati.

— Cila?

— Lagja e vjetër, pra. Katavaroshi! Ti nuk e ke mendjen!

— Nuk e kam... — psherëtiu Ndrekua dhe u mat t'ja tregonte brengën e tij Refatit. Por... një kat më poshtë, suvatorët i ranë çangës për pushimin e drekës. Zbritën nëpër shkallët e pjerrëta të skelës, mbi të cilën grindej një vinç i vogël.

— Refat! Unë të gënjeva! — tha Ndrekua papritur.

— Kur?

— Qëparë! Kur më pyete për babanë!

— Si?

— Ti më pyete pse nuk shkon plaku në lulishte. Unë të thashë, nuk e di.

— Po...

— Të gënjeva... Ja, kështu! Të ndodh ndonjëherë të gënjesht nga turpi?

— Si të të them? Me siguri më ka ndodhur ndonjëherë!

— Ja, kështu... Plaku nuk shkel asnjëherë në tokën e lulishtes. Edhe në mëngjez, kur shkon për qumësh, dredhon rrugicave, që të mos shkelë atje!

— Pse?

— Është fetar. «U përdhos vendi i shenjtë» thotë. Ti e di... ai ka qenë murator nëpër manastire...

— Pse të shqetëson kaq shumë kjo gjë? — tha Refati.

— Ja edhe ti... si një shok aty në lagje... «Pse kërkon t'ja tronditësh besimin e tij tanë në buzë të varrit?» thotë. «Ai ka besuar tërë jetën, lëre të besojë edhe një vit që i ka mbetur!»

— E zorshme! — psherëtiu Refati. — Një njeri që ka besuar tërë jetën!..

— Nuk është atje puna! Puna është se ai dhe nja tre pleq të tjerë të fantaksur të lagjes, si të thuash, janë në opozitë me lulishten... Kupton?

— «U përdhos vendi i shenjtë!..» Shih se ç'thonë djajtë! — tha Zylyftari.

— Ndofta ai nuk do të shkëputet kurrë nga feja...

— Është e ditur!

— Mirëpo, të paktën, të mos molepsë të tjerë!

— Si?

— Ja, pëshpërisin plakat: «E shihni xha Naumin ç'neri i shenjtë është?» Kështu feja vazhdon të vijë vërdallë prapë...

— Po ikona ka? — pyeti Zylyftari.

— Ka nja gjashtë. Po i ka kyçur në dhomë.

— Kjo s'të ka hije aspak ty! — tha Refati.

— Eh... Ja, prandaj e kam këtë brengë!

— Po ç'kërkon të bësh?

— Si të të them? Në krye, ndofta, duhet t'ja ç'rrenjosim nga mendja atë paragjykim të shëmtuar përlulishten. Të mos thotë më se u përdhos vendi i shenjtë. Ai s'para flet. E kupton që s'ka hije as për të, as përmua, të flasë tani për asketët e Malit të Shenjtë.

— Po përbuzja e tij përlulishten flet vetë, ama! — tha Refati.

— Flet!

— Keq! — tha Refati.

— Sikur të mundja ta bindja që të shkonte e të çlodhej në lulishte! Kjo do të ishte mirë... Por s'po më shkon mbarë...

— Merre një herë për krahu, fute brenda dhe ulu me të në një stol.. — tha Zyflua.

— Nuk pinë ujë urdhërat në këto punë — tha Refati. Ndrekua nxori një mollë dhe e preu më tresh.

— Kam një mendim — tha Refati. — Mund të na ndihmojë lulishtari. Është një plak i zgjuar. Ai ka miqësi me gjithë pleqtë, që shkojnë në lulishte. I sheh se si janë mbledhur në atë qoshe dhe luajnë domino? Ai, po! Ai edhe pleqtë e tjerë mund ta tërheqin plakun në lulishtë!

— Atij ndofta do t'i duket kjo gjë si një bezdi e kotë.. — tha Ndrekua.

— Nuk dihet. Fundja, pse t'i duket ashtu? Njeri i thjeshtë, punëtor është edhe ai. Duhet ta kuptojë që kjo molepsje është e dëmshme!

* * *

Lulishtari, një njeri i veshur me uniformën prej doku bojë gurkali, i rrudhur e i fishkur nga erërat, aq sa

nuk ja gjeje dot moshën, i ndoqi pas të panjohurit i habitur pa masë.

Këta dy muratorë e kishin pritur në lulishte derisa mbaroi orari i punës dhe e kishin ftuar në shtëpi për të pirë një gotë. Një herë mendoi se do të ishte më mirë të mos shkonte me të panjohurit, mirëpo kjo iu duk e pahijshme, aq më tepër sepse njëri prej tyre banonte në njëren prej ndërtesave që rrethonin lulishten e tij. Ndërtesat e reja ai i quante me mend si pjesë të lulishtes, megjithëse të gjithë thoshin se, përkundrazi, ishte lulishtja një pjesë e ndërtesave të reja. Po kujdestari s'e pranonte këtë mendim dhe lulishtja, prapë, i dukej më e rëndësishme.

Pra, derisa iu duk e pahijshme ta refuzonte ftesën, aq më tepër, kur ishte fjala edhe për një gotë, iu duk e udhës që më parë të lante këpucët dhe fytyrën me ujin e markuçit dhe pastaj t'i ndiqte pas. Dhe, siç ndodh rëndom, ai sigjeti pyetje tjetër për të bërë, veçse këtë:

— Ku jemi parë?

— Nuk e di — tha ai që ishte më i ri. — Ne jemi muratorë. Ndofta na ke parë në skelat e ndërtesave të reja.

— Po! — tha lulishtari. — Me siguri, atje ju kam parë!

U ngjitën në katin e tretë. Në shtëpi nuk kishte njeri. Muratori më i ri nxori tri gota dhe një shishe me raki, i mbushi gotat dhe pastaj i çokën.

— E po!... Ju paçim gëzuar! E me shëndet! — uroi lulishtari.

— Gëzuar!... — thanë muratorët dhe pinë nga një gllënjkë. Lulishtari e ktheu me një frymë dhe ndjeu t'i mbetej në gojë era e rëndë e manit të zi.

— Raki, po raki... raki për arinj! — psherëtiu lulishtari. Pas kësaj nuk foli njeri. Heshtja e bë e rëndë, e mërzitshme. Muratorit, që në krye i ish dukur e lehtë të bisedonte me lulishtarin, tanj po i dukej i vogël, pa kuptim halli i tij dhe fjalët që kish menduar sikur iu tretën.

Lulishtari vriste mendjen dhe nuk kuptonte asgjë

nga vështrimi i hutuar i muratorit. Ai ishte afruar në dritare dhe kundronte lulishten. Muratori tjetër mendohej. Lulishtari s'kuptoi gjë dhe u afrua edhe ai në dritare. S'e kish parë kurrë lulishten e tij nga lart dhe diçka e ngrohtë i gurgulloj përbrenda.

— Plaku yt paska ndenjur prapë në atë stolin e trotuarit — tha Refati.

— Po m'i ngacmojnë peshqit kalamajtë — tha lulishtari.

— A do të shtohen peshqit në këtë hauz? — pyeti Ndrekua, që u turbullua kur e pa lulishtarin gati për të ikur.

— Do të shtohen! — tha lulishtari. Po ju a i kini parë peshqit?

— I kam parë — tha Refati.

— Sa lloje janë? — pyeti lulishtari e shkeli synë me djallëzi.

— Dy!

— He... he... Dy thonë të gjithë!.. Se ju shihni vetëm ngjyrën! Peshq të kuq... peshq të zez! Mirëpo të zeztë janë dy llojesh — tha lulishtari, i kënaqur që më në fund muratori i hapi një bisedë të dashur për të. Ja nisi një rrëfimi të gjatë për peshqit e hauzit. E vinte re se të dy muratorët e vështronin me kurrestje. Lulishtari mendoi se tani e kishte hak edhe gotën e dytë. Ai u ngrit prapë dhe shkoi në dritare.

— Gjeta belanë nga ata pleqtë në qoshe!

— Pse? — pyeti Refati.

— Luajnë domino mbi bar. Në fillim e kishin marrë rrëmbyer, uleshin ku të mundnin. Unë i zbova. Mirëpo u qanë në direktori dhe ramë në ujdi që t'u lemë atë qoshen nën rrepet e mëdhenj! I shikon? Atje ka qenë varri i një tregëtarji.

— E di! — tha Ndrekua.

— Një varr i bukur, me një shtatore engjëlli!

— Dhe mbi varrin e tij luajnë domino pleqtë, ë?

— tha Refati.

— Thuaj të drejtën — tha Ndrekua. — A i shkon mendja njeriut se këtu kanë qenë varrezat?

— Ku ta dish? Njerëzit ishin mësuar me këto vare, që kishin mbetur si një moçal...

— Ai u ul dhe e mbushi vetë gotën e tretë. I pëlqyen këta muratori të çuditshëm, që nuk dihej se përsë e kishin thirrur. Apo ndofta ashtu, kот së koti?

— Në fillim, kur më caktuan në këtë lulishte, e mora punën pa qejf — nisi të rrëfejë. — Thosha me vete... Eh! njerëzit nuk e donin varrezën. Kish hi-je të rëndë ajo. Nuk do t'u pëlqeje pleqve të çlodhen këtu. Dhe dëgjoja, o vëlla, fjalë murtaje... g'pyet! Dhe ditët e para, të të them, zemrën sikur ma kish qepë një makth.. Sikur isha në një bunacë. Nuk më vinin pleqtë në lulishte... Dhe a e dini? Lulishtja pa njerëz qenka si një plagë e hapur në një trup të shëndoshë. Po. tani, ja. Ju i shihni vetë. S'mbeti asgjë nga ajo hije e varreve!

— Ka mbetur... ka mbetur... — psherëtiu mura-tori më i ri.

— Si paska mbetur? — u zemërua lulishtari.

— Ja... babai im, plaku... nuk shkel kurrë në lu-lishte!

— Hm... — tha lulishtari. — Ka edhe të fantaksur.

— E njeh ti?

— Ku ta dish? Unë edhe i njoh, edhe s'i njoh pleqtë. Fytyrat ua di të gjithëve, emrin nuk ja di asnjërit.

— Ja, eja këtu! Është ai që rri në stolin e trotuarit, karshi lulishtes.

— Ai plaku i gjatë? E njoh! E kam vënë re se si e vështron lulishten me sy të egër — tha lulishtari.

— Mundet!

— Ai është! Mbështetë mbi bastunin dhe vështron pleqtë, që luajnë domino. Njëherë dikush e thirri, po ai as që ktheu kokën.

— Ai është!

— Hm... — hunguroi i pakënaqur lulishtari.

— Prandaj menduam të flisnin një herë me ty, se ndofta na ndihmoje, ndofta e tërhiqje plakun në luli-shte — tha muratori më i vjetër, Refati.

Lulishtari mendoi se në këtë qast biseda hyri në një udhë tjetër, të rëndësishme dhe nuk i kishte më hije rakia, prandaj e la pa pirë gotën që e kish mbushur vetë.

— Kaq e domosdoshme qenka që të vijë plaku në lulishte? — pyeti ai.

— Po! — tha Ndrekua.

— Edhe ai ka qenë murator si ne. Mirëpo ka ngritur manastire nëpër vende të huaja. Është fetar, siç mund të jetë një i ardhur nga vendi i murgjve. Në dhomë ka kyçur ikona. Pastaj të gjithëve këtu u bie në sy këmbëngulja e tij pér të mos shkelur mbi varreza.

— Edhe pér mua nuk është mirë kështu! Kupton?

— tha Ndrekua. — Ç'shembull japim kështu ne, si punëtorë?

— Po!.. — tha lulishtari. — S'është mirë!

— Është njësoj sikur në lulishten tënde të kishin lënë një gur varri pa hequr. C'do të bëje ti me të? — tha Refati.

— Do ta hiqja!

— Ndihmoria pra t'ja heqim plakut këtë paragjykim pér lulishten — tha prapë Refati.

— Veç kësaj, kemi edhe ikonat! — tha lulishtari.

— Kështu, po t'i vihemti të gjithë... ne, ti, pleqtë e lulishtes, që luajnë domino mbi varrin e tregëtarit... Si thua?

— C'më pyesni kot? Ja, unë po iki tani!... Gëzuar e na vaftë mbarë — Nëpër shkallë u ndien hapat e lehta të lulishtarit. Muratorët hapën perden e dritares. Lulishtari, me rrobat gurkali, nxitoi nëpër rrugicat e lulishtes dhe doli në stolin e trotuarit. U ul përbri plakut, që dukej sikur dremiste nën muzgun e gjatë të korrikut.

Muratorët nuk u ndanë nga dritarja. Të dy pleqtë seç shkëmbjen disa fjalë, pastaj drodhën nga një duhan prej qeses së lulishtarit.

Hapën dritaren. Zhegu i mesditës kishte mbaruar dhe fëshfëritja e butë e fletëve hyri brenda bashkë me flladin e mbrëmjes...

ZERA NË MJEGULL

Katër veta të heshtur dhe të shqetësuar dolën nga mbledhja e kryesisë në muzgun e turbullt të një mbrëmjeje vjeshte. Heshtjen e natës e brejtën kërkëllimat e ngitura të kyçit. Mbrëmja ishte e ftohtë, drithëronjëse. — Ama, punë e bitisur kjo, për ideal! Tri orë mbështjellje për një... — pëshpëriti sikur mbillaçiste bukë njëri nga të katër.

— Pusho! — tha një zë i ashpër. — Hallet e kryesisë, s'janë muhabete rrugësh. — Hija e tij, me strehën e gjatë të kasketës, që dukesh si një eshtë e dalë e ballit, ishte më e madhja.

Ata heshtën. Dhe heshtja pillte mendime dhe kuvendime me vetëveten...

«U mbylliën në kryesi. Tymi, era e djersës dhe tri orë biseda pa bukë» mendoi Markua.

«Ama punë e bitisur, për ideal! Tri orë mbështjellje për një copë çoban,» e mbaroi me vete Rushiti kuvendimin e ndërprerë aq vrazhdë.

«Pse më vështronë Markua me ngulm, kur kryetari thoshte se nuk del njeri nga fshati ynë për t'u bërë bari?» mendoi Rasimi.

«Që çobani është vulëhumbur, e dimë. Po nuk më thoni, me nder jush, kush ka vithe të dalë nga fshati ynë e të marrë tufën? Që kur s'mbahet mend, zanati ynë ka qenë ai i muratorit shëtitës» mendoi kryetari.

Shtëpitë e murme i mbështollë me gunën e zezë natë e vjeshtës. Kjo ishte një natë e ftohtë si gjithë ne-

tët e tjera të vjeshës së vonë. Markos i dukej më tepër e trishtueshme dhe e plogët se sa e ftohtë. Era turfullonte si kalë i lodhur nëpër drurët e arrave; rrëmbente e përdrithte në vorbujt e saj gjethet e fundit. Në bunacë, gjethet e verdha me përdredhjet e tyre të shpenzuanët erë, i ngjanin si lakuriqë nate të ngathët. Fshati kishte shumë drurë të tillë të vjetër dhe era përdriqhte me vrundull shumë gjethë të tilla të mërzitshme. Hapi i rëndë i Markos ishte i vetmi tingull zëmadh i natës. Hapa të tjerë, hapa opingash, kishin një kumbim të dobët përpara zhurmës së proqeve të këpucëve prej alpinisti të Markos.

Era e fshikullonte në fytyrë me gjethë të kalbura, të ftohta dhe ai i krahasonte përsëri gjethet me lakuriqë nate. Bunaca i sillte angushti dhe heshtja i dukej e vrenjtur dhe e rëndë si hija nën drurët e arrave. Njëlloj të rënda, monotone, si një brerimë e njëzëshme shiu mbi llamarinë ishin dhe mendimet, që e shqetësonin.

«Duhet pranuar se, sonte, forca bindëse e fjalës sate ishte zero. Në të vërtetë, po të ishte kjo vetëm fjalë jote, përsë të breheshe kështu? Njëshi është hic... siç thoshte Majakovski. Po ti brehesh, se kjo ishte fjalë e dyimbëdhjetë vullnetarëve të klasës punëtore! Kurse shokëve të kryesis iu duk diçka e vogël, si një nga ato vogëlsira te përditshme me të cilat është mbushur plot jeta e një fshati thellë në male, që posa është kollektivizuar».

Por ai është punëtor dhe pat ardhur këtu me shoque e me shokë të tjerë që të punonte dy vjet. E zgjodhën në kryesi të kooperativës. Eh! Sa mendime të tilla i lindnin këtu çdo ditë! Dhe në fillim gjithshka dukej nëpër masa të vogla, e zakonshme, e falshme. Ja, le të mos shkojmë larg. Një ditë më parë djali i Rushitit nuk doli në punë. Penda mbeti pa pendar. Rushiti tha se e kish zënë përdhesi në këmbë: Po në mbrëmje e panë që kthehej tinëz nga mali, me mushkën të ngarkuar me dru. Kurse Rushiti, anëtar kryesie, bënte be e rrufe: «Për ideal, ju them, unë e dija të së-murë! Më nxiu faqen faqeziu! Për ideal, ju them!»

Hynë nën hijet e drurëve dhe bunaca u bë më e dendur. Dritaret e vogla si sy të verdhë ndruheshin të shihnin në rrugicat e ngushta.

«Pas një viti këto dritare si kumashë pulash do t'i bëjnë më të mëdha. Do t'i hapin edhe më shtë e tyre, do të ndriçojnë më fort natën».

«Ç'na polli me këto mbështjellje për natë! mendoi Rushiti. «Tani të shkoj në shtëpi, të thekem një herë, të pjek nja dhjetë patate në hi, pa copë le të bëhet!»

«Në mbledhjen e parë do të them: — Ore... e di ni që ja nxini faqen vetes apo jo? Ç'domethënë kjo, të mbeten qetë tona në dorë të një çobani mangut nga mendja? Kush ka vithe të dalë nga ju e të marrë tufën pa mund t'i shkruajmë edhe pesëdhjetë ditë në muaj» mendoi kryetari.

«Ç'mund të pëshpërisin për mua sikur të marrë tufën e qeve?» mendoi Rasimi. «Do të thonë: «S'kemi parë e dëgjuar gjer më sot që një anëtar kryesie të jetë edhe çoban.»

— Natën e mirë! Unë po kthehem në shtëpi! — tha anëtari i kryesisë, Rushiti.

— Ne vendosëm që të zgresim në stallat. Në krye si je i ngarkuar për blektorinë. Do t'i mbash vithet drejt, apo jo? — tha kryetari.

— Ç'të bëjmë në shitalla? Se mos na mori malli për Kuken?

— Gjersa s'kemi njeri nga fshati të marrë tufën, shqyr që u ndodh edhe Kukja — tha kryetari.

— Kuke ziu do të na i ngordhë qetë! I kullot nëpër bokërina dhe natë për natë i mbetet nga një ka në mal — tha Rasimi.

— S'ka faj i gjori! Kukja nuk sheh natën, se ka sëmundjen e pulave — pëshpëriti Rushiti.

— E?

— Është bardho! Ka sëmundjen e pulave — pëshpëriti Rushiti dhe kush e di sepse ja dha një të qeshuri sikur rrëkëlleheshin arra.

— Pse qesh si budalla? — tha Rasimi. — Kemi gjetur një gjysmëmendje që llufit dy çanakë fasule në vaht dhe presim të na venë mbarë qetë.

— Uleni zërin! Punët e kryesisë nuk janë muhabete rrugësh — tha kryetari dhe mori një shteg me gurë të bardhë, që të shpinte në shtalla.

Hynë në oborrin tërë plehë të shtallës. Në derë, nën dritën e pakët të një feneri, dukej Kukja dhe xha Xibua, shtallieri plak. Dëgjohej zëri i ngjirur i plakut:

— Nuk i pikase se ku të mbetën, bre Kuke?

— Nuk i pikasa, or, arrakatët, jo!

— S'je për bari ti, jo, po për në grazhd! Të të lidhim e të të japim bar!

— Barin haje vetë!

— Ptu! Buf i pulave! — e shau plaku.

Kryetari u afrua i pari dhe bërtiti me zërin e tij të vravhdë:

— Pse grindeni, o vulëhumburit e derrit?

— Grindje është kjo a? — tha Kukja.

— Kanë mbetur në mal dy mëzetët, që morëm nga shitet tha plaku.

— Sikur është hera e parë! — deshi të bëjë shaka Rushiti. — Nesër Kukja si të dendet me një çanak fasule që me natë, i gjen përsëri!

— Kohë për shaka është kjo a? — u shkreh kryetari.

— Nesër! — tha plaku. — Mirëpo në mal tani ka rënë mjegulla. Dhe egërsira mjegullën pret.

Kryetari u kthyte dhe u nis me hapa të gjatë drejt fshatit.

* * *

Ndërkohë u shuan dritat e fundit. Rrugicat u kredhën në errësirë. Një mjegull e trashë, e palëvizshme, si një agushtë që të merr frymën, zbriti nga mali. Dru-rët u fundosën në të si në një hon. Vetëm një zhurmë nate, e çuditshme, e pakapshme, dridhej si një piskamë e mbytur nëpër natë. Herë-herë mbi të vërtitej

lehja e qenve të lëshuar nëpër oborre, që skërmisinin dhëmbët pas gardheve.

— Or shoku Marko! Nuk të ngrihet njeri nga gjumi tani pér të kërkuar mëzetët në mal! Pér ideal, s'i ka lënë mendja njerëzit! Sikur është e para herë që mbeten bagëti në mal.

— Sikur është e para herë që gjejmë bagëti të cara nga egërsirat — qeshi Rasimi.

— E... e... sikur thashë!.. Edhe egërsirat kanë kësметin e tyre, se, po mos të kenë këtë kësмет, mund t'i vërsulen fshatit pastaj!..

— Pusho, more! — tha vrazhdë kryetari. — Nuk i le këto fjalë të mëdha ti? Bëji një zë Shyqos aty të vijë me ne.

— Unë a? Jo, or shoku kryetar! S'më kanë rrjedhur akoma që të zgjoj njerëzit pér dy mëzetë! Njëherë e një kohë...

— Hë?

— Asgjë, asgjë.... — u përtyp Rushiti e kafshoi gjuhën. Deshi të tregonte si ca vjete të shkuara i pat mbetur një viç në mal, mirëpo gjithkush kish punën e vet. Njeri nuk e ndihmoi ta kërkonte. Viçin e patën kësмет ujqit.

«Mirëpo kjo nuk bën të tregohet» i dha karar ai.

— O Shyquo; — thirri kryetari. Heshtje. Masivi i murmë i shtëpisë dilte në mjegull si një grumbull errësire pa formë. S'pipëtiti asgjë, veç asaj piskame të gjatë, të njëzëshme e të çudishme që s'dihej se nga vinte. Pastaj, sikur u zgjua nga gjumi, u sul nga stela një kone dhe filloj të grindet e të angullojë.

— Ama ç'qen! — tha Rushiti — Me një kone të tillë mund të flesh rehat! Nuk të gjen gjë!..

«S'të gjen gjë!...» vazhdoi mendimin e tij Mar-kua. «Prona e vogël ka mbjellë në shpirtin e këtyre njerëzve pasigurinë e natës, frikën e vjedhjeve. Sa thellë, në lashtësi, i ka rrënjet vallë një pasiguri e tillë?».

Më në fund, pas shumë thirrjesh, ai që quhej Shy-
quo, doli në dritare me një fener në dorë.

— Ç'ka ngjarë, more? — pyeti me frikë.

— Kanë mbetur dy mëzetë në mal dhe do të shkojmë t'i kërkojmë! Vishu — tha kryetari.

— A jeni në vete ju, apo jo? Natën do të marrim udhën e malit që të biem në ndonjë greminë a?

— Po të kishin mbetur të tutë, do t'i kërkoje?

— Hm... sikur është aty llafi! Pastaj ju e dini që mua më ngjet përdhesi.

— Rri aty e ngroh vezët — iu shkreh kryetari.

— Na e jep të paktën fenerin — tha Rasimi.

— Nuk ja duam as fenerin!

«Është njeri i vrazhdë ky kryetari» mendoi Markua. «Po u lidh me kooperativën si mishi me thuan».

— U bindët tani? — qeshi Rushiti.

— Jo! Nuk janë të gjithë Shyqo e Rushitër — tha kryetari.

— Po mua ç'më përzien? A s'po vij me ju unë?

— S'ka gjë se dikush nuk do të vijë — tha Markua. — Do të vijnë të tjerët. Do të vijmë edhe ne të gjithë vullnetarët.

Markua u kthyte në shtëpinë, ku flinin shokët. Ngjiti në terr shkallët e vjetra që kërcisin. Që poshtë vinte ende era e plehut dhe e urinës, megjithse ata e kishin pastruar haurin. Ndezi një shkrepse, po drita s'depërttoi dot deri në shtretë. Lëvizi më tym dhe goditi me bërryl kitarën e Pandit, që ish varur në mur. Një tingull i ëmbël, i thellë, mbushi heshtjen e natës. Dikush lëvizi.

— Shokë!.. Miço! Tomorr!.. — pëshpëriti.

Një zë i përgjumur diç murmuriti.

— Ngreuni! — tha Markua.

Trupat e përgjumur lëvizën nëpër shtretë. Markua ndezi prapë një shkrepse dhe kërkoi llambën.

— C'ka ndodhur?

— Kanë mbetur bagëti në mal. Do të shkojmë t'i kërkojmë.

— Mirë.

A duhet të marrim gjë me vete?

- Shishet me vajguri. Shkrepse. Duhet të ndezim zjarre.
- Mirë.
- Tomi! Merre edhe kamën! — qeshi dikush. — Sonte kemi punë me ujqit!
- Unë po shkoj të thërres vajzat!
- Por... Është një natë që...
- Kujton se janë më të dobëta se ne?
- Shko i zgjo nga gjumi!
- Përndryshe të gjesh vrimë ku të futesh!

* * *

Një dritë e dobët rrëshqiste mbi xhupat bojë mjafti të vullnetarëve dhe mbi xhaketat prej shajaku të zi të fshatarëve, që i kishte ngritur nga gjumi zëri i vrahndë i kryetarit. Dhe kjo aradhë, si një gjymtyrë e malit, vandakë mjequlle dhe hidhësia dhe lagështia e saj depërtonte deri në palcë. Pesë vajzat, të mbështjella me xhupat me jaka të ngritura pas veshëve, vinin pas kryetarit, që hiqte udhën. Aradha ishte e heshtur, vetëm rrallëherë një zë i vrazhdë pyeste bariun:

— Këtu?

— S'di! Kot më muarët mua! Unë nuk shoh natën!

— Hm... — hunguronte zëri.
Atëhere Kukja zbythej nga kreu i aradhës dhe kërkonte aty në mes të saj Rasimin.

— Rasimo! Mos ke ndonjë kore bukë?
— Hy! I babëzitur!
Kurse kryetari mendonte për vullnetarët. Çdo ditë hetonte tipare të reja në fytyrën e tyre të përbashkët.

«C'njerez! C'vajza trimëresha! Me një zë, u ngritet në mesnatë si në një alarm dhe u nisën nëpër mjequll!»

«C'më gjeti belaja.» Mendonte anëtari i kryesisë,

Rushiti. «Tani do të bëja gjumin e parë! Po këta ç'shpirt kanë vallë, që i shtyn të braktisin shtretërët e ngrohtë dhe gjumin?»

«Ata do të ikin pas një viti!» Mendonte Rasimi!» Të ishte tjetërku, nuk do ta çante kryet fort për qetë tonë! Se mos do ta lidhin jetën e tyre me to... Ata janë punëtorë dhe zërin e punës e dëgjojnë edhe në mes të natës... Po sikur unë vete të marr...

«Mjegull! Mjegulla e çdo nate!» mendonte Mar-kua. «Ndofta një mjegull e tillë bie herë-herë edhe në mendjen e këtyre! Mjegulla e pronës!.. Po kjo aradha jonë, fshatarë e vullnetarë, që ngjitet me fenerë drejt malit, si një pishtar dritash, duhet të depërtojë me forcën e saj deri në thellësitë e mykura, ku strehohet mjegulla!»

«Sikur të guxonim të mos na thërrisin!» mendonte një vajzë e imtë, që e cte pas shpinës së madhe të kryetarit». Uh! Si do t'ua bëja samarin copë në mble-dhje!»

Kryetari ktheu kryet dhe vështroi me ngulm fy-tyrën e vogël të mbështjellë me një kurorë flokësh të zez, që nuk i ndahej hapit të tij të madh. Nën dritën e fenerit ajo iu duk e verdhë, e lodhur. Vetëm sytë s'kishin asnjë shenjë gjumi në bebëzat e zeza e të ndri-tshme si thëngjij. Oh! Ç'flakë mendimesh të shqetësuara digjeshin në ato bebëza!

— U lodhe? — pëshpëriti njeriu i vrazhdë me një zë të ulët të rëndë si plumb, po të malluar, të dhi-mshur.


— Jo! — tha vajza. Pse mendon kështu? Ne e bë-jmë çdo ditë këtë rrugë.

— Po tani është një natë me mjegull...

— Rruga është po ajo. Ditë ose natë...

Qëndruan. Fenerët u mblodhën si një tufë e ver-dhë.

— Tani do të shpërndahemi! Nga dy-tre veta në çdo majë. Merrni me vete vajguri që të ndizen zjarret! Egërsira do të hutohet. Kërkoni dhe thërrisni njëri-tje-trin.



Kështu mbi lëndinat e njomura nga mjegulla u ndezën zjarret. Në mes të avujve të bardhë, që endeshin poshtë e lart si një kope pa bari, siluetat e zbehta të zjarreve, të turbullta e të rrrethuara me kurora sikur lëpinin me gjuhët e tyre mjegullën e natës. Dhe nisën zëra të tjerë ta çajnë terrin e ta mbysin atë piskamë të njëzëshme e të çuditshme të natës!

— E... e... e...!

— He... he... he... ej!

Toka ishte e ngrirë. Avujt njominin këmishët dhe flokët e shpupurisur. Zëra të hollë të mprehtë, të vranzhët përgjigjeshin breg në breg. Ky kor zérash vazhdoi gjer vonë. Zjarret shuheshin dhe mbinin përsëri, në një kodër tjetër, pastaj platiteshin e mbinin prapë. Dhe zërat mbushnin me jehonën e tyre zbratzësinë e natës, të honeve e të pyllit të rrallë me ahe të vjetër.

Kështu, derisa një zë i hollë thirri me një tingëllim tjetër:

— E... e.e...ej! I gjetëm!... i gjetë...ë...m! Kryetari e njohu menjëherë zërin e asaj vullnetares së imtë me bebëza të shqetësuara, që quhej Aishe.

Agullimi i një dite tjetër të turbullt vjeshte i gjeti afër fshatit. Mjegulla kish mbetur si ishuj të bardhë në shtratin e greminave, mbi ujërat e përrenjëve. Mëzetët me trupin të njomur nga avujt pëllitën dhe shtryqën trupin e mardhur. Pika uji spërkatën dheun.

«C'njerëz!» mendonte kryetari.» Ndofta pikërisht kjo do të thotë: Klasa punëtore t'i japë tonin jetës së vendit. Kjo vajzë e brishtë, sonte, i dha tonin një fshati të tërë.

«Hëm...» pëshpëriste anëtari i kryesisë, Rushiti. «Tjetrit s'duhet t'ja hash hakën! Nga sebepi i vullnetarëve shpëtuan mëzetët sonte...»

«A i thua vetes i ri?» mendoi Rasimi. «Atëherë dil vullnetar dhe merr tufën e qeve.» Dhe iu afrua Markos:

Marko! Po e marr unë përsipër punën si bari!
Markua buzëqeshi.

«Kjo është përmbyssje!» tha me vete, duke menduar Rasimin. «Përmbyssjet këtu i ngjajnë shkëputjes së gurreve prej masiveve shkëmbore. Këputet e thërmohet një koncept i vjetër, i mykur e, në vend të tij, si një bila-shnjok, që lëshon lisi i prerë në pranverë, mbin mendimi i ri, revolucionar. Dhe, ndofta, ndodhitë si kjo e natës së shkuar, i ngjajnë një gurgdhendësi të madh e të padukshëm. Ata gdhendnin tiparet e reja në fytyrën e ashpër e të lashtë të malësisë! .»

PUNËTORI I XHADESË MALORE

Këtë njeri e kam takuar për së pari në një vend të pazakonshëm për të. Më vonë e njoha më shumë nga tregimet e të tjerëve. Ai vetë ishte një njeri fjalëpакë.

Në një ekspozitë të arteve figurative sesi lindi një diskutim i gjatë, që s'kishte të mbyllur. Një piktor i nojhur, njeri që merrej me pejsazhet malore, kishte ekspozuar një nga krijimet e tij, midis krijimesh të tjera. Ishte një pamje malore. Mali i zhveshur, i thatë, bojëhiri i errët të kundronte si një përbindsh i frikshëm, i egër, i pakapshëm.

— Nuk e kuptoj! Unë e njoh këtë mal — tha një ushtar. — Po ku është rruga malore në pejsazhin tuaj?

— Rruga? Ky mal nuk ka rrugë, po një tragë të humbur dhish, djalosh! — tha piktori.

— Gaboheni. Ky mal ka një xhade zigzage, që ngjitet me thonj e me dhëmbë deri në majë.

C'rëndësi ka në pikture xhadeja? — tha një djalosh me syze dielli, që mësonte për pikture në kursin që drejtonte piktori i njohur. — Xhadeja është vetëm një detaj. Piktura s'është fotografi. Piktorit nuk i duhet ky detaj, ndaj ai nuk e sheh!

— Mua më duket se duhej të shihte pikërisht xhadenë — tha ushtari.

— Eh! Ushtar! Ju pak gjë kuptoni nga artet figurative. Ideja këtu është madhështia e egër e malit... Egërsia, zymtia, diçka e lashtë dhe e pamposhtur. Punë e gjatë... — pshëretiuj një burrë me borsalinë të madhe, bojëhiri.

— Kujtoja se kuptoj edhe unë diçka — tha me shpoti ushtari. — Sepse kam mbaruar liceun artistik dhe kam qenë mësues vizatimi në jetën civile...

Piktori e shikoi me interesim.

— E dini? — tha. — Mua s'para më pëlqen të interpretoj dhe të shtrembëroj sendet. Nga ky realizëm, mua bille më quajnë pak... hm... naturalist. Dua t'ju siguroj se ky mal nuk ka asnje zhade.

— Jo... ka një zhade! — tha një zë tjetër, që s'ishte ndjerë më parë. Të gjithë kundruan atë që posa foli. Një ftyrë e rreshkët, bojë bakri, me rrudha të vogla rrëth syve, që vërtiteshin me shqetësim, si të penduar për shpërthimin e papritur të gojës, që tha se ka një zhade. Një kasketë e vjetër stofi. Njeri me shtat të imtë, nën një palë rroba të zbardhura doku. Duar të ashpra, të çara, që binin menjëherë në sy si një kontrast i çuditshëm me gjithë duart e tjera të vizitorëve... Piktori mendoi se ky ishte, sigurisht, një vizitor i pazakonshëm, një nga ata njerëz që ndofta e kish kthyer rryma e kureshtarëve; njeri që s'mund të thoshte gjë për veprën e tij.

— Interesant! Po ju kush jeni që i dini gjithë këto hollësi? — pyeti burri me borsalinë.

— Unë... Hic!.. E di! — tha burri me duart e ashpra. — Jam punëtor i mirëmbajtjes së kësaj rruga.

— Oh! Interesant! E po si ju duket kjo pikturë?

— Nuk më pëlqen — tha. Ushtari ka të drejtë. Këtu mungon rruga.

— Prapë doli rruga? Ju s'keni konceptin e pikturës!

— tha djaloshi me zyze dielli.

— Zhadeja u hap vitin e shkuar... — murmuriti ai.

— Folë, pra!.. — tha piktori i lehtësuar, — Kjo tablo ka tre vjet që është bërë.

— Sikur të ishte edhe zhadeja!.. Pa mendoni se ç'kontrast — tha ushtari. — Mali, vrazhdësia, që duket e paepur dhe zhadeja, që i ka hyrë në bark si një nerv i domosdoshëm për jetën... Diçka e bardhë, që gjarpëron në një sfond bojë hiri të errët.

— Ju s'kuptoni qëllimin — tha borsalinua. — Këtu s'hyn fare rruga. Ai mund të mos e vështrojë fare atë. S'ka rëndësi rruga!

— Si nuk ka rëndësi xhadeja? — tha njeriu me kasketë të vjetër. — Ky mal nuk ka asgjë tjetër të dobishme përveç xhadesë dhe ndonjë fije bari në skerkë. Kurse ju thoni...

— Aman... Ç'diskutim! — psherëtiu djaloshi me syze dielli. — Të të mësojë të shohësh një pikturë një punëtor i xhadeve! — dhe bëri të ikë.

Punëtori i hodhi një vështrim të nxituar. Rrudhat rreth syve iu shtuan edhe më.

— Ti nuk do të mësosh të shohësh mirë, në qoftë se nuk i heq ato syze të errëta — tha dhe u largua.

Grupi mbeti një çast në heshtje. Kundronin njeriun që largohej me hapa të shpejta deri sa zbriti shkallët.

— Interesant! Ç'shpoti therëse — tha borsalinua.

Ndofta do ta kisha harruar këtë njeri, ose ndofta s'mund të shkruaja asgjë për të, megjithëse në blokun e shënimeve kishte mbetur ngjarja e mësipërme. Por më vonë, në udhëtimet e mia, më ndodhi të shkoj në këtë xhade malore.

Ishte fundi i gushtit, koha kur në këtë malësi të largët vlon lëmi. Maqina kishte tre-katër udhëtarë, djema që ktheheshin nga ushtria me leje. Shoferi, një moshatar imi dhe shok i vjetër që në bankat e shkollës, njeri llafazan, më mbyti me pyetje. Pastaj iu vërtit plakës, që ishte përpëra bashkë me mua. Plaka kish qëlluar edhe ajo llafazane. Rruga ngjitej lart, duke dredhur nëpër malin e thatë. Ishte një rrugë e vësh-tirë dhe bënte vapë.

— Rrugë e zorshme — thashë kot së koti.

— Po — tha shoferi. — Ka dy-tre vende të rrezik-shme që të mallëkosh veten. Këtu janë shkelur të gjitha normat teknike të ndërtimit.

— Ndofta nuk bëhej ndryshe — thashë unë.

— Mundet — tha shoferi. — Ku u ka shkuar mendja njerëzve të bëjnë rrugë!

— Je mërzitur në këtë rrugë?



— Për mua, njëlloj është! — tha shoferi. — U mësova. Janë shumë të mirë këta fshatarë. Të sjellshëm. I ke parë se si shtyhen në autobuzat e qytetit? Shty të shtymë! Edhe këtu mund të shtyheshin. Nganjëherë ka shumë njerëz dhe biletat i pres unë nga dritarja e maqinës. Kur i shoh që ka shumë, u them: «A! Kam fëmijë unë, o vëllezër! Më shumë se njëzet e tetë, asnje nuk marr! Dhe të shohësh... «Mirë.. mirë..» thotë ndonjë i këshillit. «Le të hipin një herë gratë, pastaj sho him e bëjmë». Veç kësaj ka edhe një punëtor mirëmbajtje këtu, vëllako, që për kokën e tij! Unë gjithnjë kam menduar që mirëmbajtja rruga do të bënte mirë të na thërriste në mbledhjet e kolektivit të saj ne shoferëve. Ne ua dimë horrllëqet atyre, ata na i dinë neve! E di? Është një punë ajo e tyrja, që mund t'ja këpusësh gjumit e të bësh kokrrën e qejfit. Nië orë në ditë! Hidh dhjetë lopata zhavor, shtrihu në lëndinë... Janë nja dy në një rrugë anësore të fushës që, sa dëgjohet zhurma e maqinës, i ke mbi togjet e zhavorit. Dhe ta hedhin zhavorin në turi, sikur të thonë: «A na shikon ç'punëtorë që jemi?» Po në u kthefsh pas një ore, do t'i gjesh aty ku i ke lënë dhe kanë borxh të të vërtitin prapë ca lobata me zhavor në turi!

— Ka shumë si këta a?

— Jo! Po ky i kësaj rruge është veç të gjithëve. Do mirëmbajtje kjo rrugë, or baba, ndryshe vete në greminë!

— Është nga fshati ynë! — u hodh plaka. — Ka një karvan fëmijë dhe e caktoi vetë këshilli në ndërmarrje.

— Ishte një tjetër më parë... një kokërr dembeli, që lëre mos e pyet. I thosha: «Ore, mbushe këtë gropë këtu të viaj e ujit, se më ze diferenciali. Nuk e sheh ç'të gjerryer i ka bërë viaj?» «Jo more...» thoshte. «Ç'të bëj punëra të padukshme? Sot e mbush, nesër bie shi dhe bëhet prapë gropë!» «Po ti mbushe prapë!» i thoshja. «Përse të paguajnë?» «Pse, o, ç'bëjmë? Mbush e zbraz... mbush e zbraz? Si ai që deshi të mbante ujë në vërzomë? Ti bëje çështje andej, të vijntë forca nga ndërmarrja, se

nuk éshtë pér këllqet e mia kjo» thoshte. Tani e ka bërë ky tjetri që s'njihet fare se ka qenë gropë.

— Edhe ai lumëziu nga fshati ynë ishte — tha plaka. — I zuri e mira sytë atij! Deshi të hajë me dy lugë, edhe në qeveri të hante, edhe barrë dru të bënte fshehur në pyll...

Heshtëm. Mendoja punëtorin e panjohur të rrugës malore, atë fshatar punëtor, që nuk e kontrollonte askush veç ndërgjegjes së vet. Rruga dukej vërtet e ~~mbajtur mirë~~, sa nuk ta merrte mendja se mund të ishte kështu një rrugë malore.

— Ta shihje këtë në të dalë të dimrit — tha shoferi. — E kishin zbritur në pjesën e xhadesë, që éshtë në fushë. Natë pér natë mbaronte punë e ngjitej në fshat, gjurmë më gjurmë. Ja nisi me dëborën e rrugës... bot e bot... shkrifte këtë që ta hante dielli, qëronte aty me tej! I vinte shumë inat që xhadeja s'punonte dot dimrit, se dëbora këtu matet me metër dhe sikur i kish caktuar vetes ta përzinte dimrin nga xhadeja sa më parë. Dhe çatisi në inspektorët në fund të marsit. «Ejani të shihni rrugën, éshtë gati apo jo?» tha. «Je në vete? Xhadeja e L.? Kur të bëhet gati në fund të prillit, thuaj shyqyr!» thanë ata të inspektoratit. «Po ju ejani një herë e shihni, se dimri i sivjetëm ishte më i shkurtër».

M'u shtua kërshteria pér ta parë këtë njeri. Shoferi më kuptoi dhe tha:

— Do ta takojmë, mos ki merak. Duhet të jetë afër qafës, se aty ka shkarë një ledh dhe rruga éshtë ngushtuar. Do të qëndrojmë atje, se éshtë çesma.

Qëndruam. Një njeri i pakët, me rrudha të shumta rreth syve, me rroba të zbardhura prej doku, me kasketë të vjetër, po hidhte lopata me dhe njëra pas tjetrës në greminë.

— Qëndrojmë këtu — thashë. — Unë duhet të bisedoj me të.

— Si zor të nxjerrësh gjë prej tij! — tha shoferi.

— Éshtë si vuv! — tha plaka.

— Ej! Bato! — tha shoferi. — Ky shoku gazetar do të shkruajë pér ty! — Ai qeshi dhe vazhdoi të hedhë

dhe në greminë. Shoferi shkoi të mbushë ujë. Batua u ul dhe ndezi një duhan. U ula edhe unë pranë tij, në një lëndinë të butë, të njomë nga lagështia. S'kishte asgjékundi një dru për hije dhe dielli si saç na rrinte mbi krye. Mendoja për këtë njeri, që punonte nën atë diell dhe në afshin e valë e përcëllues të gurëve të skërkës, që dukej sikur dilte nga një burim i nëndheshmë. Në lëndinëzë me radhë ishin mbjellë një sërë plepa dhe gjethet e tyre të pakta fëshférinin nga puhiza. Mirëpo plepat ishin të rinj, të vegjël, pa kurorë, dhe hija e tyre i ngjante hijes së një druri të thatë. Edhe gjatë rrugës pata vënë re se kishte mbjellë drurë nëpër vendet më të buta. Nuk dinim se ç'të flisnim.

— Ja. Kjo është një punë e mirë! — thashë. — Kjo rrugë e thatë duhet të ketë gjelbërim. Duhen mbjellë edhe drurë të tjerë.

— I sheh tarracat në skërkë? — tha ai. — Pyjorja ka mbjellë pishë. Kurse këto pak rrënë plepa i mballëm ne të mirëmbajtjes.

— I ka mbjellë ky! — tha shoferi, që u afrua.

— Ti e tepëron! — tha ai. — Aty nga fundi i vjetës, s'para na vijnë maqina — m'u drejtua mua. — Konsumi e mbaron shpejt furnizimin. Sikur pata mbetur pa punë. U thashë atyre shokëve të ndërmarrjes: A na sillni një maqinë plepa, t'i mbjellim pas rruge?» Ata shokët e ndërmarrjes, shyqyr, janë të kuptueshmë. E dérguan maqinën...

Ndezëm nga një cigare. Cigaret u shuan. Pas tyre përsëri heshtëm. Ç'të thoshim? Ai dukej sikur ishte mërzitur. Pimë prapë cigare.

— Paske duhan të butë — tha.

— Nuk po i thua asgjë për punën tënde? — tha shoferi. — Ky do të shkruaj për ty!

— Budalla që je! — i tha ai. — Ç'mund të shkruajë për punën time? Punë si të tjerat. E padukshme. Sot mbush një gropë. Nesër hapet një tjetër. E mbush edhe atë! Ky mund të shkruajë për xhadënë, për dobinë e xhadesë, për shembull. A e di ti se ç'është xhadeja për

ne? Xhadeja éshtë lidhja me botën. Por pér këtë kanë shkrojtur të tjerë më parë... Po ku ta dish? Njëherë, kur shihja një pikturë në qytet, që tregonte këtë mal, se kush thoshte. Ç'rëndësi ka rruga?». Prandaj, ndofta ja vlen të shkruaj prapë pér rrugën — tha.

Ne hipëm në maqinë, kurse ai mbeti aty, në lëndinëz, buzë ledheve të gremisura, nën fërshëllimënen e butë të plepave të rinj.

G E R M A D H A

Kjo ngjarje më kishte mbetur në kujtesë si një copë mjegull. Dhe ashtu siç zhduket e tretet mjegulla, po thërmohoj nëpër vjetët eahe ftyra e ngjarja e tij.

Në agullimën e zbetë të një dite të largët, i përcjellë nga lehjet e qenve, ai ecte nëpër shtigjet e pyjeve, drejt qytetit. Qyteti ishte larg dhe mezi arriti në mesditë.

Këmbëngulja e tij e çuditshme ishte si një anekdotë. Ky njeri me ftyrë të imtë, të parruar, me shtat të pakët nën një xhaketë prej kadifeje të zezë, nga ato që dërgon konsumi në dyqanet e malësisë dhe që janë të qepura të gjitha me një masë, prandaj nuk i rrinë askujt pas shtatit, u ngjitej si rrodhe pleqve, që ishin kthyer nga kurbetë, i vështronte me dy sy të habitur, i pyeste dhe largohej prej tyre i mërzitur e i zymtë, duke nxituar të gjejë një tjetër.

Puna më shpuri njëherë në fshatin e largët Zebec. Ky ndodhet në një zonë të thellë, në male. Ju s'duhet të përfytyroni ato malet e larta e të ftohta, në gropat e të cilave qëndrojnë deri në verë ishujt e bardhë të dëborës. Malet janë të buta, valë-valë në të dy anët e lumit. Në pjerrësirë rriten hereket e rrushit të ëmbël Serin. Vera është tmerrësisht e nxehjtë dhe e thatë. Dhe vetëm larg në horizont duken kurrizet tërë gunga e gropat e maleve të larta, që pshëretijnë me erëra të ftohta.

Në mbrëmje rrnim anës së vatrës në ca poste të



zeza leshi. Mbi gurin e vatrës kishin tri gota rakie që Kosta ngutej të mos i linte zbrazur se: «gotat rënkojnë kur s'kanë brenda këtë lëngun e bekuar të rrushit» thoshte. Shtëpia ishte e re, e porsambaruar. Mbante erë gëlqere e dérrasa pishe.

— Sa të kushtoi shtëpia? — pyeti llogaritari, që mundohej të mos i nënshtrohej dremitjes, që ja ndillte rakia dhe të thekurit pas zjarrit.

— Nuk e di — tha Kosta.

— Si është e mundur? — qeshi llogaritari. — Ju nuk doni të na tregoni.

— Që thua ti, or mik, shtëpitë e mia kanë historitë e tyre. Nja dhjetë vjet të shkuara, aty më poshtë ja nisëm një shtëpie por... u rrënuar. Si u rrënuar? Një histori tjetër kjo. Mbeta në shtëpinë e vjetër, që tani e kam plevicë. Kur u bë kooperativa dhe nisën të ngrihen radhë shtëpi të reja, më thotë kryetari: «Or Kostë, kjo vjetërsirë do të të zërë brenda; bëj një kërkesë të të ngremë një shtëpi të re!» «Sa ditë do të më vejë shtëpia?» i thashë, «Të shohim» tha. «S'kam këllqe përshtëpi të re unë» i thashë, «gruaja m'u plak, unë i kam bërë a s'i kam bërë dyqind ditë. Fëmijë nuk kam, do të ngrysemi njëfarësoj në këtë vjetërsirë.» «Jo» tha ai, «do ta bëjmë».

Kështu, e ngritëm. Bëhet mbledhje. Se kush hidhet e thotë: «Or shokë! Qysh bëhet, që duan t'i mbajnë ditë-pune xha Kostës? Ai është plak, mezi i ka bërë; a falim të gjithë nga dy ditë dhe të mbylljet hesapi?» Një të thënë, një të bërë. Kështu që unë nuk e di fare se sa kushtoi.

Llogaritari ra në mendime anës së zjarrit. Unë **desha** të pyes përshtëpinë e rrënuar. Dhe, posa nisi të më tregojë, m'u kujtuan të gjitha.

Pra, ato vjete, u kthyen shumë pleq nga kurbeti dhe në rrugët e qytetit u dukën figurat e tyre të çuditshme kurrrizdalë, me bastune dhe me republika bojë hiri, me syze, të ngadalshëm e të habitur. Ky njeri i gjurmonte kurbetlinjtë kudo që ishin. Ulej në tavolinat e tyre në kafene, ulej në stolat e lulishteve; tro-

kiste nëpër dyert e tyre. Të gjithëve u uronte ashtu, fshatarçë, mirseardhjen, pastaj u tregonte një zarf të gjatë me adresën e një njeriu dhe i pyeste:

— Zotëria juaj... mos kini qenë në këtë vend që thotë adresa?

Pleqtë vështronin njëri — tjetrin, pastaj ja jepnin zarin atij që dinte shkrim më mirë dhe, duke ndërprerë njëri — tjetrin, i thoshin:

— Oh! Kjo kasaba qenka në stejtin Kolorado! Atje ka shumë pak shqiptarë!

Dhe Kosta, i habitur, ngrinte vatat e rënda të supeve të xhaketës prej kadifeje dhe pëshpériste:

— Q'djall vend ky, ku s'paska tjetër shqiptar veç xhaxhait? Si nuk i paska rënë rruga asskujt në këtë qytet?

Dhe ja niste kërkimit prapë, i zymtë, i lodhur. Ky kërkim i gjatë e këmbëngulës mbeti atëhere si një ndodhi jetëshkurtër, zbavitëse.

* * *

— C'do të bëje ti, sikur një ditë të vinte një njeri, të të hidhte në duar një grusht me të holla, të të thosh: «Janë të tuat» dhe të ikte? Ja, kështu, ndofta, më ndodhi mua. Postieri më solli papritur një zarf të madh, të çuditshëm. Po ti s'besoj t'i kesh parë zarfet e tyre. Të gjatë, me vijëza të vogla anëve, vijëza të kuqe, blu, të bardha, Më pulla të vogla, me fytyrën e rrudhosur të një njeriu. Po prisni, më duket se ka mbetur një zarf i tillë.

U ngrit, rrëmoi në një arkë me vjetërsira dhe slli një zarf të zverdhur nga koha. Zarf i huaj, me vula të mëdha, të kuqe dhe nga prapa me vullat tonë. Fytyra e rrudhosur e Linkolnit në pullë dhe adresa... Nick P. Adams...

— E, bre? — pyeti Kosta dhe puliti sytë. Vështrimi i tij kureshtar hetonte me vëmendje mbresat aë

linte zarfi tek ne. Po këto mbresa ishin shumë të vaka, prandaj ai ngutej të na shpjegonte më tej.

— Ja... të vjen korrieri e të thotë: «Kostë. Kjo letër është për ty». Fytyra e tij është e habitur. Demek, as atij nuk i besohet që kjo letër është tamam përmua! «Ehe! U plake!» i them, «s'mund të jetë përmua kjo letër. E ke gabim.»

«Edhe mua s'më besohej», thotë, «ndaj pyeta edhe mësuesin. Megjithëse e shkrojtur pak si gabim, po prapë merret vesh që është Kostë Adhami, fshati Zebec, komunja e Gusharit, prefektura e Korçës!»

Akoma me komune dhe prefektura ai! Por ahore unë s'dija fare se kush ishte ai. Në fshatrat tona kurbetlinjtë janë të rrallë. Tjetër punë malësia e Dardhës, aty në burimet e Devollit. Vende të ashpra ato, toka nuk i mbante. Kurse pleqtë tonë thoshin: «Bukë thatë, pa në shtëpinë tënde».

Ato vjete 1roja bashkë me vëllanë, Peron. Nuk ishim ndarë dhe ndofta s'do të ishim ndarë kurrë, po, siç do ta dëgjosh më pas, edhe ndarja i ka kryet te kjo letër. Kur erdhi letra, vëllai ishte në mal përdru. U mundova ta lexoj adresën me atë pak shkollë të vjedhur që kam, po s'mora vesh asgjë. I shkova mësuesit në shtëpi. Letrën nuk e pata hapur fare. Mendova: «Dale, or lum Kosta, ku i dihet, mund të jetë gabim! Le që gabim do jetë, s'ka tjetër!»

— A s'e shikon prapë këtë letër?» i thashë mësuesit. — Është a s'është përmua!

— E pashë dhe më parë — tha. — Letra është për ty. E dërgon një Nick... — Më vonë, dikush që duhej të ishte më i ditur se mësuesi ynë, ma shkoqiti që kjo Nick duhej lexuar Nik, demek, shkurtim i emrit Nikollë... Sepse ajo «c» atje s'paska vleftë, qenka kot së koti, si puna e bishtit të dhisë. Sikur mësuesi të paskej ditur se Nicku do të thotë Nikollë, mund të më kishte shkarë mendja një çikë më parë se kush e kishte dërguar letrën. Mirëpo mësuesi «Nick»... unë po e bëja «Niskë». Gjeje ti tani q'është ky Niskë. Deri këtu, është si për të qeshur, po të thartat janë më

pas. Mësuesi, mëkë... mëkë... sikur të mos kishte qenë shqip, por tjetër gjuhë, djersiti gjersa e shkoqiti. Ç'mendoni ju? Letra ishte tamam për mua, nga xhaxhai, Nikolla Adhami. Ja, ju po habiteni prapë! Si, ore, të kesh një xhaxha dhe të mos e dish? Si të të them? Këtë xhaxha edhe e dija edhe nuk e dija. Po tani duhet të të rrëfej historinë e xhaxhait. Ky ishte një mot m'i vogël se babai. Ishte martuar një mot pas tij, atë vit që isha lindur unë. Rrëfenin se i kish rënë në short një nuse... po ç'nuse thua ti? Bilonjë pylli, ore ... që t'i rrëmbeje kokën në torbë e të merrje arratinë. E urtë, e zgjuar, punëtore si bletët dhe e bukur, si thotë ajo përralla: i thoshte hënës dil ti, pa të dali unë!... Ishte nga fshatrat e largëta të një krahine tjetër. Ky xhaxha Nikolla, siç kam dëgjuar nga të tjerët, ishte njeri i grindur, noprani. S'bëri dy vjet me nusen dhe e përzuri te prindët. Thoshin bile, se xhaxha Nikolla kishte ndenjur me një grua tjetër në fshatin fqinjë dhe njerëzit e gruas së parë e kërcënönin ta vrissnin. Atëhere u zu edhe babai im me xhaxhanë. «Mos të t'i shoh sytë kurrë! Kurrën e kurrës!» i pat thënë. Xhaxhai u zhduk; pëshpëritej se kishte shkuar në kurbet. Dyzet e shtatë vjet s'u bë i gjallë. Po edhe babai kish kokë prej bualli. Për hir të asaj deli nuseje, që e cfiliti kot së koti, s'deshi më të pyesë e as të dëgjojë emrin e tij. E ëma e dinte të vdekur dhe kështu u shkrojt me të humburit. Atëhere unë mund të kem qenë nja katër vjeç. A mund ta mbaja mend një të harruar të tillë? Mirëpo xhaxhai, sipas letrës, na dinte ne si koqja në palare. E dinte se babai paska vdekur, prandaj po na shkruante tani e jo më parë; se, sa rronte i vëllai, rronte midis tyre edhe mëria e vjetër; kurse tani, demek, që paske vdekur ai, po na kujtonte prapë si nipër shumë të dashur edhe mua edhe vëllanë, Peron. Kish dëshire t'i shkruanim, t'i dërgonim fotografitë tona.

U ktheva në shtëpi si i trallisur; habitje e madhe! Bëja, ç'bëja dhe nxirrja nga xhepi zarfin e gjatë. Vi-jëzat blu, të kuqe, të bardha më treteshin përparrë sy-

ve, të turbullta. E ja, ashtu, mendime të atilla më shkonin edhe në krye... Sikur kisha rënë në një ëndërr të gjatë, sikur nuk mund të besohej që të ndodhin të paritura të tilla. Më kujtohej babai. Vinte i pakët, i thanë, kështu si unë, zevzek, i prapë. Gjer atë mot që vdiq, punonte pendar. Pendar, tërë jetën e tij. Dikush ja kujtoi një herë xhaxhanë. I tha se ndofta nuk kishte vdekur. I shkrepëtinë sytë nga mëria e vjetër dhe tha prerë: «Mos ma zërë më në gojë atë njëri! Dëgjove?»

Shkoja rrugëve të fshatit, nëpër kalldrëmin e prishur që i kishin mbetur gurët si dhëmbë të rronitur dhe prapë si ëndërr më kujtohej gjithshka që kishte të bënte me mërinë midis dy vëllezërve. A thua vetëm e vetëm se e braktisi atë deli grua pa u zunë, apo kishte diçka tjetër? Ku ta dish tani? Plaku ka vdekur. Sa ishte gjallë, emri i xhaxhait s'pipëtinte në shtëpi. Kurse tani xhaxhai i humbur u ngjall së vdeku-rish dhe dërgoi një letër. Nji letër të përmallshme, aq të përmallshme, sa të mallëngjente. Me atë gjuhën e tij të vjetër, na lutej që t'i shkruanim. Kur arrita në shtëpi, duket se isha aq i tronditur sa kisha ndryshuar fare në fytyrë.

— C'ka ndodhur që je zverdhur kështu? — tha gruaja.

— C'ishte ajo letër? — pyeti Peruia.

— Asgjë — thashë. — Nuk ju shkon kurrë në ment. Një letër nga vëllai i babait. Ai i harruari.

— Hë — u interesua Peruia. — C'thotë?

— Shumë i mallosur. Po ku e di vallë që ka vdekur babai dhe që je edhe ti? — më lindi për herë të parë ky dyshim.

— C'na hyn në qese kjo gjë? — tha Peruia. — Sos'ska pak shqiptarë atje? Por c'thotë... c'thotë një herë?!

— Ja... merre, lexoje — i thashë. Peruia e rrëmbeu letrën dhe nisi ta lexojë. Merre me mend, kur nuk e shkoqiste dot mësuesi, sa do të hiqte Peruia që kishte vetëm katër klasa.

— Kjo sikur s'është shqip fare — tha. — Unë smarr vesh asgjë.

- Shqip është — i thashë. — Po e ngatërruar shumë. Shiko këtu ç'thotë.
- «Mouva!»
- Mua! — qesha unë që kisha mësuar pako gjë nga gjithë ajo djersitje e mësuesit.
- Dreq — tha Peru. — Po ç'thotë?
- Asgjë... de! Pyet si një njeri që e ka marrë mali, kërkon t'i dërgojmë fotografitë tona dhe të shtëpisë së vjetër.
- E muarëm vesh që është i mallosur. Tjetër...
- Sikur thotë t'i shkruajmë nëse kemi nevojë që të na ndihmojë.
- Këtë thuaj më parë, të shkretën... — i qeshi ftyra vëllait. — Këtë thuaj.
- Çfarë — u inatosa unë, — mos do t'i kërkojmë atij! S'të bie në hatër se plaku s'donte t'ja dëgjonte emrin?
- Au! Plaku... Plaku. Ai u tret, s'kujton më asgjë, e ndjeftë zoti. I vdekuri për të vdekurit, i gjalli për të gjallët. Do të zbres në qytet, t'i bëjmë një letër të mirë te avokati.
- Hajvan! — e shava. — Letra është mbi mua. Unë do t'i përgjigjem. S'duam lëmoshë dhe nga ti mos të dëgjoj më fjalë të tillë, ta dish! — i thashë. Gjer atë ditë Peru më bindej tamam si të isha baba; ishte të thuash dhjetë vjet më i vogël, po unë e pata rritur. Këtë ditë s'foli më. Natën u mendova... u mendova gjatë. T'i shkruaja apo jo? Më çudiste malli i tij për gurë e për drurë, për shtëpinë e vjetër me kanate dërrase, për vreshtat. Më kujtohej babai. Pse vallë më kërcënonin ata sytë e tij të vrejtur nën vetullat si strehë që i sillja ndër mend? Mirépo... i gjalli me të gjallët, thashë edhe unë. Babai nuk ishte njeri pa gjynahe, le të mos e kishte bërë tërkuzë këtë histori. Je mi një gjak. Po sikur të ishte qyqar, si druri i varreve, në dhe të huaj, i ndjekur nga hija e mërisë së vjetër të vëllait për vjete me radhë, aq sa nuk guxonë të shkruante më?... Një njeri i vetëmuar, që i dri-

dhet zemra për vendlindjen, që ëndërron t'i prehen kockat atje ku i ka rënë koka? Ç'nuk më polli mendja! Xhaxhai nuk shkruante se ishte vetëm ose që mund të kthehej, por mendja ime aty më nxirrte. I shkrojtëm. Një djalë që vente në Tiranë në shkollë, na nxori në fotografi të gjithëve përpëra mureve të shtëpisë së vjetër, që kishin dhënë bark. Nuk shkuant dy muaj, çatisi prapë zarfi i gjatë. Këtë herë nuk çuditej më njeri. Fshati i tërë e mori vesh se ishte ngjallur i vdekuari. Brenda në letër ishte një copë letër si e kollarisur, e verdhë, e shtypur.

— Ç'është kjo? — kërceu vëllai.

— Ku ta di unë? — thashë.

— Shiko këtu! Ç'është ky numër 200, një pikë, dy zero të tjera?

— Nuk e di — thashë.

— S'besoj të jenë para! S'mund të jenë kështu paratë. Po ku i dihet. Pa ja jep djalit ta lexojë.

I humburi, aq shumë e pat stërvitur të birin me letrën e parë saqë ishte mësuar me të shkrojturit e çuditshëm të xhaxhait dhe i shkonte goja bilbil fare. Banonim atëhere të gjithë bashkë në një dhomë të vjetër, përdhese. Ishte natë. Në zjarr bubulonin flakët e karthjeve të dushkut. Perua mbante llambën mbi kryet e djalit që ta lexonte më mirë dhe unë shikoja se si i dridhej dora me gjithë llambën.

— Lëre drithën në vend — i thashë. — Ty të dri-dhet dora.

— S'ka gjë — thosh Perua. — Dhe ju gratë pu-shoni një herë.

— Ne s'po flasim — tha e shoqja. Dhe vërtet në dhomë dëgjohej edhe kërcitja e karthjeve në zjarr. Na kishte mbërthyer një ankth i papritur, që na mbante fry-mën pezull. Xhaxhai shkruante se i ishte bërë zemra mal që kishte marrë letrën tonë dhe se e kish njomur me lot. Shtëpia i ish dukur shumë e vjetëruar, sikur do të shembej nga dimri dhe për këtë ishte pikëlluar shumë; thosh se ne dukeshim të gjithë shumë mirë.

— Ju thashë! — u shkreh Perua. — Mos m'u pispi-

llosni me rroba tē reja sikur do tē venit nē dasmë...
— Djali lexoi mē poshtë:

«Po ju dërgoj këto para. Mua ma ka ënda që tē ngrini një shtëpi tē re, mē poshtë kësaj gërmadhe, te lëmi dhe shtëpia tē shohë nga ana e kories, nē perëndim tē diellit. Më shkruani sa mund t'ju kustojë që tē dërgoj para tē tjera. Ta dish, nip i dashur, se xhaxhait i ka ecur fati...»

Flaka e llambës u drodh, u zgjat. Peros i dridhej dora, sikur e kish zënë ajo punë.

— Ah... xhaxhushi! S'është budalla, jo! Për nder që është shumë i dashur ky xhaxhai.

— Do tē tē bjerë llamba! Nema mua — tha e shoqja. Perua i dha llambën. Mori mbi oxhak letrën e trashë e tē verdhë, e vërtiti nē duart e ashpra dhe e futi mu nē sy sikur ishte çakër.

— Eh... çudi, o zot! Kjo letër e verdhë tē jetë para!

Unë e vura re se si iu ndez nē sy një shkëndijë lakmie dhe nuk më pëlqeu. Nuk mund ta nuhatja që atëhere se c'do tē vinte më vonë. Qelepiri është i ëmbël, thonë. Dhe mua sikur më zunë sytë perde... mua, që kisha qenë udhërrëfyes me brigadën e parë. Më zuri sytë ai grusht me tē holla që mora nē bankë. Më vonë tē gjitha letrat vinin mbi emrin tim, si vëllai më i madh që isha. Nisëm tē ngrehim shtëpinë e re karshi perëndimit tē diellit, karshi korieve, siç kishte dashur xhaxhai, Perua se ku i gjeti ca ustallarë tē huaj, që, si e nuhatën se këtu rridhët burimi, nisen tē na rjepin mirë, se punën e **kishim dhënë me mëditte**, **zgjatin ditët**, duke i gdhendur qoshet dhe guët **sikur do tē ngrinin shtëpitë e Jaçe** beut. Po kush vinte re?

Ndonjëherë vrisja mendjen: «Ç'është kështu, si qenka kaq i pasur ky njeri, që i derdh paratë si lumë, kurse kurbetlinjtë e tjerë janë trokë? Pse u kujtua tani tē shkruajë? Si i ka fituar këto para?» Po këto ishin hamendje tē varfëta, tē përkohshme. Muret po bëhen shin tē forta, me gëlgere dhe natën nē errësirë gëlqe-

rja zbardhët sikur mbi shtëpi ndriste gjithnjë hëna! Hodhën trarët e katit të parë. Xhaxhai na shkruante se mund të vinte si turist, të shihet një herë vendin dhe ndofta më vonë mund të vinte të rehatohej në fshatin e vet bashkë me ne. Po tretej qortimi i hijes së babait, po harrohej edhe ai vetë, të gjitha po harroheshin, do të harroheshin. Ndofta do të na kishte marrë lumi i lakmisë. Do të më merrte mua nderin tim. Mirëpo, thellë, më rrinte i zgjuar një boshllék i madh që s'e mbushte dot asnjë letër... Boshlléku i jetës së çuditshme e të panjohur të xhaxhait. Kjo i lëndonte kujtimet e mia të luftës, plagën time. Cili ishte ai? Si i kishte fituar këto të holla? Si njeri i ndershëm apo si batakçi? E kujt do të ishte kjo shtëpi, e një njeriu të ndershëm apo e një njeriu të përdalë? Pse nuk shkruante asgjë pér veten e vet? Pyesja veten, pyesja fotografinë e madhe të xhaxhait, që porsa na kishte ardhur. Një plak i hijshëm, i gjatë, me fytyrën të nxirë nga dielli, me sy gjysmë të mbyllura se ja vriste drita, me duar të kryqëzuara, në një kopsht me pemë të panjohura. Vështrimi i tij ishte shpotitës. «Këtu kam ardhur të bëj verën» shkruante. Ja tregojë këto shqetësimë Peros.

— Hajde, or derëbardhë, ç'ë vret mendjen? Ç'të duhet ty se ç'është xhaxhai? Jo nderi, jo bataku! Thi-the dhe gëlltite tani sa është hëna e plotë e duken punët si ditën. Është budallallepsur nga malli. Llastoje tani, se nesër i bie ndonjë pikë damblaje dhe mbetesh me gisht në gojë. Të erdhi e mira në derë dhe ti kërkon t'i biesh me shkelm. E di ç'të bësh ti, vëllako? A nuk i shkruan kujt ja ka bërë pasurinë përsipër?

U zemërova me Peron pér këto fjalë. Shqetësimi pér jetën e xhaxhait të panjohur tanë më brente më shumë.

«Ç'ngjet kështu me mua?» mendoja. «Dikush më hedh një grusht para në dorë dhe unë i marr si i verbër. Ç'di unë pér të? Pse i lindi ky mall tanë e nuk i lindi më parë? Pse nuk na shkruan se kush i ka tre-guar që vdiq babai? Pse bën sikur e harron gjithnjë këtë gjë? Cili është ai i panjohur që i ka folur pér ne?»

Jo... jo. Unë duhej ta shihja në dritë fyttyrën e errët të xhaxhait. Në qytet, në fshatrat e kurbetlinjve, po ktheheshin shumë pleq nga kurbeti. Dikush duhej ta njihte, dikush duhej tē më fliste pér xhaxhanë.

Më hipi kjo mendje në kokë dhe i thashë Peros:

— Dëgjo! S'mund t'i pranojmë më këto para si lypsarët, që nuk e shohin kurrë në sy atë që jep lëmoshë. Ne duhet ta dimë ç'mall èshtë, ç'mendon, cili èshtë ai që i kallzoi pér ne dhe ne nuk e njohim!

— A, o Kostë... Ty po tē lë mendja — tha Perua. — Mos, or i mirë, mos se, po i shkuan në vesh xhaxhait këto gjurmimet e tua, na i preu ujet tani, që e kemi në misër.

— Jo — bërtita. — Unë do tē gjurmoj.

— E gjurmo atëhere, o i marrë! — më bërtiti pér herën e parë në jetë vëllai im më i vogël. Mua më goditi si rrufe kjo fjalë. Qëkur s'më pëlqenin shkëndijat e lakmisë, që ishin ndezur në sytë e tij, ajo dridhje si ethe, që e pushtonte sa herë vinin zarfet me vijëza tē kuqe, blu, tē bardha, dëshpërimi i vjetër, që mundohej ta fshihte prej meje, dëshpërim, që e pushtonte sa herë shikonte se tē gjitha çeget xhaxhai i dërgonte mbi emrin tim. Atëhere mundohej tē bënte shaka:

— Kush e di sa tē vogël më di nga mosha mua kxaxhushi, që më këshillon sikur jam kalama, tē shko: mirë me vëllanë e madh!

Sa herë zbrisja në qytet, gjente shkak tē vinte me mua. Këtë herë paratë na ishin mbaruar. Perua u zu me ustallarët dhe i përzuri. Këtu edhe unë isha më tē, aq më kishin bezdisur ata rjepacakë. U pajtova me vëllanë, por ishte një pajtim i ftohtë. U pajtova pér hatër tē femijve tē tij që i doja sikur paskeshin qenë tē mitë. Nuk e mora në qytet; thashë se mund tē rrija katër — pesë ditë në krahun e Oparit pér tē kërkuar ustallarë dhe u nisa. E, ja, atëhere nisi dhe ajo që mban mend ti. Në fillim mendoja se i pari njeri që do tē pyesja, do tē dinte diçka pér xhaxhanë. Dua tē them se këta pleq nuk ngjanin aspak me fotografinë e xhaxhait, me atë fëtyrë tē pjekur nga dielli e

i pashëm si i ri. Këta ishin të zgërbulët, kaba, anko-heshin shumë nga damarët e këmbëve ose nga zemra, se gjithë jetën kishin punuar më këmbë dhe rëndë, lëkurën e kishin të zbetë, të butë e të rrudhur, të bardhë sikur nuk i kish thekur kurrë ai diell, që thekçe xhaxhanë. Më thoshin:

— Oh! Çudi! Xhaxhai yt qenka pasanik. Këtu, në Majamibiç venë pér verë vetëm të pasurit.

— Nuk e njohim!

— Qenka në stejtin Kolorado!

— Nuk e di të ketë shqiptarë në këtë stejt!

Katër ditë brodha kafeneve, lulishteve, shtëpive. Asgjë. Vetëm habitje. U ktheva i dëshpëruar, edhe vëllanë e gjeta të dëshpëruar pa masë. Kishte një tre muaj që s'po na vinin më letra.

— Eh? — më pyeti.

— Hiç! Nuk gjeta muratorë.

ve tjetër?

— Asgjë. Nuk e njeh njeri.

— Çudi!

— Të gjithë thonë se duhet të jetë i pasur.

s'po dérgon më.

More, atë e di unë më mirë se ata, po ç'e do që

Unë heshtja.

— Si thua? Mos ka vdekur?

— S'besoj.

— S'dihet! E di se si vdesin këta? Pup! Sikur pikon një dardhë fickë!... ose mos është zemëruar. Hë?...

— bënte hamendje vëllai.

— S'di!

— Mund të jetë zemëruar. Mund të ketë marrë vesh që ti s'je i kënaqur dhe që po pyet poshtë e lart.

— Këtë dua të di edhe unë! Si i ka marrë vesh të gjitha këto? Cili është ai njeri i panjohur?

— Prapë sinorin te thana ti, o? Ja, kështu e zemërove dhe na rruat tanı... — tha ai, i pakënaqur. Po mua më brente tjetër gjë... Më brente shqetësimi që nuk po gjeja njeri që të dinte jetën e tij. Pa e më-

suar këtë, nuk do të më zinte syri gjumë dhe shtëpia që po ngrinim, do të më mbetej si një gjemb i madh mu në sy, për tërë jetën.

Pas dy ditësh, prapë gjoja për shkak të muratoreve, u nisa për rrugë. Këtë herë e lashë qytetin, ku më tregonin me gisht si një çudi dhe u hodha fshat më fshat te kurbetlinjtë. E kisha ndarë mendjen të mos kthehesha pa mësuar gjë të saktë. Në krye s'më doli gjë fare. Po të paktën dëgjova se një farë Tasi Mulliri mund të kishte qenë në stejtin Kolorado, se ai ishte njeri që s'para zinte vend dhe kish bredhur tërë jetën. E takova në një fshat tjetër, të vogël. Ish një burrë i madh, i gjatë, që dukej se po të të binte sipër, do të të shtypte. Kurrizin e kish të dalë, sa kostumi i ish holluar e vjetruar në shpatullat. Sytë i kish të frikshëm, jashtë zgavrave të tyre. Më thanë se ishte njeri i çuditshëm, i drejtë deri tek ai dhe ktheu prapa, por sherxhi e pijanik. Mirë thonë, s'ka kalë pa huq. E takova në klubin e fshatit. Posa hyra, më ra në sy trupi i tij i madh; pinte konjak e këndonte nëpër buzë:

«Trendelinë, moj,
Si të thashë, moj.»

— Kam ardhur nga fshati Zebec — i thashë. — Dua t'ju pyes për një xhaxhanë tim.

— Paske bërë udhë, o bir! Maçi! Silli një konjak këtij mikut! — Unë desha të kundërshtoja, po e pashë se si u ligështua në ftyrë dhe nuk bëra zë. Pimë.

— Si e ke punën, bir i dashur?

Këtë «bir i dashur» e kishte në majë të gjuhës. Edhe më të moshuarve se unë, që atëhere isha pesëdhjetë vjet, kështu u thoshte. Vetë ishte shumë më plak, po kish gazin e një të riu. Kam marrë vesh se rron akoma.

— A kini qenë ndonjë herë në Kolorado? — i thashë pa i treguar zarfin. Ke parë ti? Sa herë kisha treguar zarfin, s'kish dalë njeri të më thoshte një fjalë të saktë. M'u bë si paragjykim: «Pa të pyes një herë pa e treguar zarfin» thashë.

— Kam qenë, biri i dashur, — tha me zë të lartë.

— Edhe atje, edhe në Njy-Meksiko, bile edhe në Sauth Dakota kam qenë...

— Po a kini qenë vallë në këtë qytet dhe a njihni këtë njeri? — i thashë dhe nxora letrën nga xhepi. Vuri një palë syze dhe e lexoi. Menjëherë u thartua në ftyrë, sikur kish gjelltitur gjë të hidhur dhe i kish mbetur në fyt. I hoqi syzet me nxitim.

— Ç'e ke këtë njeri, bir i dashur? — më pyeti.

— Xhaxha.

— Po, e njoh... — psherëtiu. E njoh shumë mirë.

— C'njeri është?

— Është maskara i madh, o bir! — tha. — Gangster! Një herë, Nik Adamin e kam ngordhur në grushte unë vetë, ja me këto duar.

«Prandaj e shan!» mendova, «derisa është zënë, doemos që do ta shajë!» M'u kujtuan të gjitha ç'më kishin treguar për Tasin.

— Ti, bir i dashur, thua me vete se unë e shaj menjëse jam zënë?

— Po.

— Gabim! — gérthiti. — Nik Adami është maskara. Unë kaq di, kaq them. E rraha një ditë se gënjeu; tha se nuk ishte shqiptar, por grek. Po ty, bir i dashur, unë s'të tregoj më asgjë. Unë kështu jam i prerë. Të pashë në sy që nuk më beson.

— Jo, të besoj — i thashë. — Tregomë.

— Nuk dua! — tha. — Ti shko në fshatin tënd. Kërko Çall Leksin. Është njeriu më i urtë në botë. Nuk nget asnje pulë. Pyete atë. Po të tha ndryshe, kthehu këtu dhe pështymë mua. Maçi! Bir i dashur, mbushi dhe një konjak këtij mikut se është i dëshpëruar.

— Të paktën më trego se nga kush e mori vesh vdekjen e babait.

— Nga një laro prej atyre të Ballit, një Sherif... Sherif. Është i ardhur vonë, nga ajo krahina juaj. Me të është bërë ortak.

— Më shkruan se do të vijë turist — thashë unë.

— Ptu! — pështyu plaku. — Kurrë! Edhe po të dojë, nuk qas qeveria jonë në prak bajga si ai. I di ajo, i di të gjitha.

Edhe kaq, ishte mjaft për të njohur xhaxhanë, mi-repo kërshteria pér të mësuar sa më shumë më shtyu të takoja edhe plakun tjetër. Prej tij mësova se xhaxhai që në të ri të vet, ishte bashkuar me një shoqëri komarxinjsh. Njëzet vjet të jetës së tij s'kish bërë punë tjetër veç kumarit dhe zareve. Mbante tre trima pas dhe luante me zare qyl. Ç'të ta shpjegoj këtë? Nga ai mora vesh edhe tekën e çuditshme të xhaxhait pér të na dërguar ne paratë. Patjetër, kjo s'mund të ishte veçse teka e një njeriu të shthurur. Xhaxhai kishte qenë i martuar me një grua të huaj, të re. Ca vjet më parë, xhaxhai u sëmur nga sémndja e sheqerit dhe e shoqja i kërkoi të bëjë testamentin pér pasurinë e tij. Niku ish tërbuar fare. «Si? Pa vdekur unë, kërkon ti të gllabërosh paratë e mia? Unë të ndaj,» bërtiste. «Unë nga inati paratë e mia ua dërgoj nippërve në Shqipëri dhe ty të lë me gisht në gojë.» Kështu, ç'mund të presësh nga një njeri i tillë? Kishte të drejtë i gjori baba që nuk donte t'ja dëgjonte emrin. Po ç'ishin vallë tërë ato përmallime, lot e dëshira pér t'u prehur në vendin e vet? A thua se në pleqëri, pas një jete aq të shthurur, e kishte marrë malli pér vendlindjen, që kushedj sa herë e kishte mohuar dhe që ishte tanë pér të i ndaluar si edhe sheqeri? Ku ta dish? Dhe ç'më du-heshin mua më tej këto mallëngjime të tij? U ktheva në fshat. Isha i qetë, i vendosur. Më dukej se tërë jetën s'kisha bërë një punë më të mirë se sa kjo bre-dhje pér të mësuar të vërtetën. Vëllai më priti i ngazellyer. Siç duket, kishte ardhur letër.

— Nema letrën këtu! — thashë. Siç duket, dukesha fare i qetë; ai nuk dyshoi asgjë.

— Merre, vëlla, — tha. — Këtë herë, e paska bërë fora xhaxhushi!

— Po... fora e ka bërë — thashë dhe e grisa letrën me gjithë çekun më dysh.

— Ç'bën? ... u marrose? — thirri Peruia.

— Jo — i thashë. — S'ka më xhaxhush, tani. Xha-xushi qenka maskara dhe është bërë ortak me ballistët e arratisur.

— Si? — mezi pëshpëriti ai dhe një bojë të vde-kuri i ra në fytyrë. — Nuk e besoj... jo.

— Është e vërtetë, — i thashë. — Po ty të ka verbuar lakmia, prandaj nuk do që ta besosh. — U plas mbi postet e deleve si thes dhe zuri kokën me të dy duart. Po pas një çasti e ngriti e tha me zë të ulët:

— Fundja, ç'na duhet neve? Ne bëjmë sikur s'dimë gjë. Hë?

— Hajvan! Qorr!... — i bërtita dhe i çora prapë copat e letrës.

— Bobo! — tha. — U marrose! Një pasuri të atillë, o perëndi! Një pasuri të atillë! — Nuk i fola më. Dola nga shtëpia e vjetër, të marr ajër të pastër, ja-shtë. Po ngrysej. Nga lëmi më kundronte shtëpia, kati i parë me trarët e hedhur. Po... Bukur ndriçonte dielli, në perëndim e sipër. Pas një jave u zumë përfundimisht me Peron. Mora vesh nga i biri se kish ndër mend t'i shkruante xhaxhait. E kërcënova me një inat të atillë, sa ty s'ta merr mendja. Bile, i thashë që unë vetë do ta fusja në burg, po ta bënte këtë. U tremb. Por buka ishte thyer tashmë dhe, kështu, u ndamë. Shokët më përgëzuan. Po kishte edhe njerëz që habiteshin: «Mirë, xhanëm... mirë, le t'i presë marrëdhë-njet me xhaxhanë, tani që doli puna kështu; po pse të mos e mbarojë shtëpinë për pesë para gjë? Fundja le ta bëjë me një kat e të hedhë që tanë çatinë. Nuk e sheh i humburi që po i gremiset shtëpia e vjetër?» Budallenjtë! Nuk e kuptonin që unë s'mund t'i shikoja dot ato katër mure me gëlgjere, qe zbardhnin natën.

Kështu... shirat dhe dëbora e dimrit bënë punën e tyre dhe në pranverë shtëpia u bë gërmadhë. Dhe u rrënuar shpejt. Ke parë ti sa shpejt bëhet gërmadhë çdo shtëpi, po nuk ndezi zjarr brenda saj njeriu?

UJÉRAT E NDENJURA

Dy veta, burrë e grua, qëndruan përpara një shtëpie të madhe e të errët, në një nga rrugët anësore të qytetit. Ishte mbrëmje. Një llambë e dobët, e mbësh-tjellë me një abazhur të gjelbër si një gjysmë shishe birre, e varur shumë lart, lëshonte një dritë të turbullt e të venitur në ballin e shtëpisë. Suvaja vendevende ishte rrëzuar nga shirat dhe muri dukej si një perde e arnuar me nxitim.

— Kjo është shtëpia? — pyeti burri.

— Kjo! — tha gruaja. — Dhomat janë të hallakatura, të ftohta.

Burri, i veshur me një pallto të shkurtër meshini, që lëshonte ca reflekse të zbehta në dritën e llambës, ishte shtatmadh, me një profil të ashpër, si të latuar në dru. Nga ngjyra e murme e duarve kuptohej se kishte vjete që punonte me hekurin dhe me benzinën. Gruaja ishte zeshkane. Format e plota të një femre të shëndetshme spikatnin në një fustan basme; sytë e zez, të thellë, hunda e vogël e nazike dhe dy buzë kryeneqe i jepnin fytyrës së saj nje shprehje të përhershme gëzimi. Burri i shtrëngoi me dorën e madhe dhe e zrudhi autorizimin, që i kishte mbetur në xhep. Shtëpia hijerëndë me dritare të larta e të ngushta si dritat e kishave, prapa kangjellave të ndryshkura, iu duk si një maunë, si një maunë e mbytur dikur dhe e nxjerrë pastaj nga fundi i detit pér të qëndruar përjetësisht në këtë rrugë si një grumbull kaotik drita-

resh të gjata, suvaje bojë hiri dhe oxhakësh të lartë, midis shtëpive të qeta, të vogla, që i rrinin përbri. Dukesh sikur i zoti e kish ngritur këtë shtëpi të lartë, në mes të ngrehinave të vogla, për t'iu penguar atyre die-lin. Por dielli ishte shumë lart. Dhe ku ta dish? Ndofta pronari i vdekur i shtëpisë, i cili dikur kish qenë vetëm shegert dhe pastaj kish vënë një farë pasurie e i h bë-rë tregëtar i vogël, e kishte ngritur këtë shtëpi tri-katëshe për t'i rrëfyer botës se ishte shkëputur nga vulgu dhe po ngjitej lart. Në katin e poshtëm kishte qenë dyqani, që mbyllej me qepene të rënda. Tani **aty** kishte tri tabela të thjeshta. «Bukë-fruta-mish».

— Si thua? Të hyjmë? — pyeti burri.

— Hyjmë — tha gruaja. — Në katin e dytë banon një grua.

— Ti më the se ka edhe të bijën — tha burri.

— Po!.. Quhet Ankushë. Eshtë një flokëverdhë që bie shumë në sy. Eshtë ndarë nga burri.

— Ankusha? — pyeti burri. — E di.. e kam dë-gjuar!

— Ju shoferët i dini të gjitha gjérat që kanë të bëjnë me femrat e bukura — tha ajo.

Burri e mbështolli me krahun e vet, mbështeti kokën e saj në gjoks dhe pëshpëriti:

— Xheloze e vogël...

Dy djem të mitur i kundruan një copë herë nga qoshja e rrugës, pastaj filluan të vërvhellenin. Më i vogli, një çunak me prenka e kokëtullë, u fsheh nën një strehë, nxori kokën dhe thirri:

— I..i...i... e puthi!

Ata të dy qeshën. Gruaja trokiti në derën e an-shme. Një herë nuk u përgjegj askush, pastaj nëpër shkallë zbritën hapa të lehtë, të shpejtë, sikur ecte ndonjë mace dhe, afër derës, u ndie fëshfërëtja e një fus-tani. Pa pyetur se kush mund të ishte, derën e hapi Ankusha. Kishte veshur një rrobe nate të gjatë, të ndritshme. Një mori lecka shumëngjyrshe, si ato zburimet e bredhit të vitit të ri, i vareshin në flokë. Penuari ishte aq i hapur në gjoks, saqë linte të dukej

tantella e këmishës dhe format e kërcyera, tekanoze të gjive. Vetëvetiu, posa pa siluetën e gjatë të burrit prapa gruas, ajo ngriti dorën dhe e mbështolli me jakën e hapur lakuriqësinë e gjoksit deri në grykë. Ashtu, me dorën e djathtë në gushë, në gishtin tregues të së cilës dukej një unazë e madhe me një gur të zi, me vështrimin paksa të hutuar të të dy syve të errët dhe me shkujdesjen që linte të dukej nën penuar kombinezoni bojë trëndafili dhe forma e kofshës, ngjante si një krijesë e dalë papritur nga historitë e romaneve të vjetra të dashurisë dhe e mbetur kush e di sepse në mes të zymtisë.

Njerëzit e panjohur, që trokasin netve, i ngjallnin kurdoherë kërshëri, ashtu si këtë herë punëtorja e filaturës dhe i shoqi, që kishin ardhur me një autorizim për dhomat e zbrazura nga një nëpunës i transferuar. Dhe, kur i lindte një kërshëri e tillë, sytë e errët i lëvrinin si të luaneshës; ahëre asaj i dukej vetja shumë tërheqëse.

Pasoi një grimë heshtje e ndrojtje, gjatë së cilës Ankusha pati kohë të përfytyronte menjëherë shumë gjëra. Buzëqeshi dhe tha:

— Oh!... Më falni! Mezi ju njcha në këtë mugëtirë. Ju jeni Drita, fqinja ime e re! Ky është burri juaj? E mora me mend. Urdhëro, e dashur, hyni si në shtëpinë tuaj. E dëni? Më duket e habitshme se si nuk ju njoha në çast, megjithëse ti, Drita, ke një fytyrë shumë shprehëse. Por... ishte errësirë...

Kështu me një breshëri fjalësh i përçollti nëpër shkallë, deri në katin e dytë, ku do të banonin. Shoferi donte të hynte vetëm një çast, për të parë dhomat, por Ankusha, plot përgjërimi, i ktheu në dhomat e veta.

Në dhomë, në një kënd ngjitur me sobën, që kerciste nga zjarri, dremiste një plakë e gjatë, si një send i zi, i harruar mbi velenxën me theka. E ëma e Ankushës e la mënjanë trikon, që po thurte dhe i vështroi me kërshëri, po ashtu si e bija, të panjohurit; kurse plaka mbi velenxë nuk e bëri qejfin qeder, ngriti një herë



kokën pastaj dremiti prapë. Nënë e bijë ngjisnin shumë.

Dhoma u ngjau e çuditshme, si një rrëmujë midis pasurisë së perënduar dhe varfërisë së sotme. E shkuara u belbëzonte nga shtretërit e mëdhenj me anë të nikeluara e me zbukurime bronxi; u pëshpëriste nga llampadari si shandan, ku përpëliteshin të ndrydhura në mes të abazhureve si qirinj, ca llamba elektrike; i vështronte nga kornizat e punuara me filigran të dy pasqyrave të ciflosura, përmbi një komo me enë biluri. Por mbulesat e shtretërve ishin të vjetra, dalëboje, dërrasat e nxira të dyshemesë, që duhej të ish larë fort rrallë, i mbulonte një shkorsë e vjetër prej leckash, ku zotëronin leckat bojë qelli të zbardhura e të lerosura nga pikat e lyrës... Praqet e dritatëreve i kish ngrënë krimbi, një xham ishte ngjitur me brumë, kurse një tjetër ishte zënë me kompensato.

— Mama!.. Janë fqinjët tanë të rinj! Njerëz të mirë — tha me një buzëqeshje të shtitur Ankusha. — Janë njerëz interesantë, mama! Drita, punëtore në filaturë, i shoqi, shofer.

Mamaja tundi kryet e thinjur, kurse plaka gjerrhiti. Burrë e grua, të rënë papritur në një dhomë të huaj, të çuditshme, ishin si mbi gjemba. Ankusha dërdëlliste pa pushim dhe i mbyti me pyetje të vogla: Befas shoferi bëri një pyetje, që e zgjoi nga gjumi plakën. Mamaja psherëtiu.

— Juaja është shtëpia? — pyeti prapë me këmbëngulje shoferi.

— Jo... është e shtetëzuar — tha mamaja. — Vëtëm dhomat tonë, më kanë mbetur mua si trashëgim nga burri.

— Burri juaj ka qenë pronari i shtëpisë?

— Po... — psherëtiu gruaja. — Njeri fatkeq. Sido që tregëtar i vogël, edhe ai dha diçka për luftën. Pastaj, si të gjithëve, edhe ne...

— Nuk kishte qenë në burg asnijëherë — shtoi Ankusha. — Vdiq si qytetar i ndershëm...

— Njeri fatkeq — përsëriti gruaja. Vdiq brenda një nate, nga pikë.

Pas një çasti shoferi dhe e shoqja u gjendën në rrugicë.

Të nesërmen në shtëpinë numër 46 të rrugës «Bogdani» hynë me zhurmë banorët e rinj. Kureshtarët e mëhallës kishin dalë praqeve.

— Bëjnë inventarin e plaçkave që do të sjellim!

— murmuriti me inat shoferi. — Ç'zakon i ndyrë mikroborgjezësh!

— Pastaj, nga ato që do të shohin, do të krijojnë edhe opinionin pér ne — tha gruaja. Por, meqë çifti i ri niste gjithshka nga e para dhe s'kishte veç një karrocë me sendet më të nevojshme, kërshteria e grave nëpër parqe, mbeti pezull, deri në mbrëmje duke pritur ndonjë karrocë tjetër. Lart, nga një dritare, plaka e hetoi me një vështrim të xhamtë gjithë mbartjen, pastaj pëshpëriti:

— Paskan një këndez plaçka!

Plaka pështyu nga dritarja e lartë në rrugë, si rrugaçët.

* * *

«Ç'femër e kolme na mbiu në derë!» psherëtiu berberi. Berberi quhej Timo Lolo dhe banonte në katin e tretë. U shtriq edhe një herë, u kthyte përbysë në shtratin e gjerë, që ishte akoma i ngrontë, mbylli sytë dhe dëshiroi të dremiste. Por në korridor u dëgjuan pëshpëritjet e zakonshme të mëngjezeve. Të dy vajzat e këpuçarit të sëmurë, Teuta dhe Ana, përsërisnin mësimet. Berberi, që kishte turnin e mbasditës, u mërzit. Kishte dashur kaq herë të bënte fialë me vajzat, por i vinte rëndë nga i ati i tyre, që dergjek në shtrat. Vajzat ishin pa nënë. Ajo kishte vdekur papritur, tre vjet më parë.

U ngrit me përtesë. Mbi jastëkun e së shoqes kishin mbetur fije të bardha flokësh. Në kuzhinë vajza e madhe preqatiste mëngjezin e më të vegjelvë. Berberi kish katër fëmijë.

Ai doli në korridor. Do të ishte një ditë e ftohtë, me mjegull. Ditë të tilla ja ngrysnin shpirtin dhe e bënин njeri të mërzitshëm.

«Duhen ngjitur galloshet! Po nisin shirat!» tha me vete.

— Moj ti, mace! — i thirri së bijës. — Merri lekët mbi komo dhe shpjeri galloshet te Koçua. Po i thuaj që janë të miat, ama!

Vajza, e pakët, e imtë dhe e ndrojtur, dukej më e vogël nga ç'ishte. Doli nga kuzhina, ku bërtisnin e grindeshin me njëri-tjetrin tre vëllezërët më të vegjël.

— Mbasdite, unë jam në shkollë, baba! — tha me zë të ulët.

— Ç'masdite? Pse, gjithë ditën në shkollë do të mbetesh? Apo nise prapë me ato rrethe të mallëkuara? Nesër unë dua galloshet!

— Mirë — pëshpëriti vajza. — Bukën ta kam lënë mbi tryezë!

Berberi zbriti rëndë-rëndë shkallët e drunjta, të vjetra, që rënkonin nëpër peshën e tij. E ndjente bukur mirë se ishte rënduar. U mbështet pas parmakut dhe zgjati kokën drejt korridorit të katit të dytë. Dhoma e Ankushës ishte e hapur. E hapur ishte edhe destra e dhomës së fqinjëve të rinj. Gruaja e re, Drita, i kish kthyer shpinën dhe po fshinte. Berberi u përkul mbi parmakët dhe ngriu në heshtje derisa u dëgjua një zë shpotitës nga dhorna e Ankushës.

— Ej! Buzaç! Ç'shikon ashtu? — thirri ajo.

«Grua pa cipë! Po ç'grua biskonjë është ama!» pshërëtiu berberi. Zbriti shkallët me ngutësi, duke menduar se sikur të mos kishte qenë ajo derë e mallëkuar e fqinjëve e hapur dhe ajo Drita e kolme me fshesë në dorë, mund t'i fuste një të pickuar tanë Kunadhes, siç e quante ai Ankushën.

Edhe Kunadhja vetë s'kishte as gjashtë muaj që ishte kthyer atje, pasi ishte ndarë nga burri.

— Mirë mëngjezi, fqinjë! Si u gdhitë? — pyeti Timua.

Drita doli në korridor. Doli edhe Ankusha me rr

bën e natës, me flokë të shpupurisur, që i mbulonin laku-riqësinë e supeve. Timua vetëvetiu lëvriu përbrenda dhe solli ndër mend atë natë të largët, kur Kunadhja i kish lejuar diçka më shumë se një shaka pa të keq. Po që atëherë Kunadhja e tallte dhe ai e dinte se ajo diku humbiste gjithë ditën... Të tre mbetën një çast në heshtje, sikur prisnin se kush po fliste i pari, Drita për herë të parë e shihte berberin. Ky burrë ftyrë-kuq, i ngjallur, dukej se i kish kaluar me kohë të dy-zetat. Mbi ballë flokët i ishin rralluar, por anës dhe nga mesi i kokës e më pas, kishte një drudhë flokë kokorithka, si të lyer me vaj. Me ato mustaqe të holla spicë dhe me ftyrën e kënaqur, të yndyrshme, me vështrimin e paturp të një çapkëni të vjetër asaj iu duk i neveritshëm. Sidomos të neveritshme ishin buzët e tij të fryra, me tul, të trasha. Drita e kish njojur një ditë më parë gruan e berberit, që ishte një femër e urtë, e plakur pa kohë, që punonte në rrobaqepësi.

— A u rregulluat mirë, fqinjë? — pyeti përsëri berberi.

— Po!

— Po të kini nevojë për ndihmë, fqinjë, mos na kurseni. Këtu jemi si një shtëpi, do hyjmë, do dalim. Apo jo, Kunadhe?

— Po, buzaç!

— Ku e kini burrin?

— Burri është shofer. Shkoi në minierat e hekurit

— tha Drita.

— Shofer? Ah, sa keq! Dhe një femër e re si ju të mbetet vetëm?

— Ju qenki me të vjetrat — tha Drita. — Kush ka frikë tani se mbetet vetëm?

— E... e... — u gëlltit berberi. — Ju patët fat se ratë në një shtëpi me fqinjë të mirë. Nuk keni fëmijë?

— Jo!

— Dhe as mos bëni shpejt! Ja, merrni dëshminë e gjallë, gruan time të mjerë. E njohet? Po? E, ta dini pra se edhe ajo ka qenë dikur kështu e freskët, e kol-

me si ju... Po tani ka mbaruar si grua! Lindi katër fëmijë dhe mbaroi...

— Si flisni kështu për gruan tuaj, për nënën e fëmijëve tuaj? Nuk kini turp? — tha e habitur Drita.

— Nuk e them në sy të saj, jo! — tha berberi. Po ajo që është, është! S'mbulohet dieili me shoshë!

— Edhe ti ke mbaruar... — qeshi Ankusha. — Flokët po të bien dhe barku po të rritet!

— Ah, moj Kunadhe! Burri nuk mbaron aq lehtë... — qeshi Timua.

«Cnjeri i pacipë qenka ky!» mendoi Drita dhe mbylli derën. Nga brenda dëgjoi dy zëra si të përhumbur në një thellësi të largët, zërat e Ankushës dhe të berberit:

— Mos na u zemërua fqinja e re kështu?

— Nuk i kuptojnë të gjithë shakatë e tua pa kripë, buzaç!

— He!... he... Po ju, moj mackat e lumi, në shkollë po shkon a?

— Po... — u ndëgjua zëri i njërsës prej vajzave të këpuçarit.

— Sot më latë pa gjumë, ju mori dreqi! — tha berberi. — Unë po dal! Ditën e mirë, Kunadhe!

Në shkallë u dëgjuan përsëri hapat e tij të rëndë, pastaj hapat e lehtë të dy motrave. Derën e gërvishi si një kone Ankusha, pastaj e shtyu. Dera kërciti si një teneqe. Ankusha e përfshiu me një vështrim dhomën e gjunit të çiftit të ri. Ishte fare e thjeshtë. Bile nuk kishte as pasqyrë tualeti. Ju kujtua dhoma e saj në Tiranë, dhoma e bukur bashkëshortore. Sido që prapanik e ziliqar i madh, i shoqi kish qenë njeri me shije. Të mos e paskej atë xhelazi të mallëkuar që solli ndarjen!

— U zemërove me buzaçin? — pyeti duke qeshur.

— Qenka njeri i pështirë. Gruaja e tij është për të ardhur keq! E ka shtrydhur si limua, i poshtri!

— Oj...oj! Jo kaq përpjetë menjëherë —tha Ankusha. — Ju nuk e njihni! Pastaj, një femre nuk i kanë hijke fjalët «i poshtë».

— Vetëm gënjeshtra nuk është e hijshme! E vërteta është kurdoherë e hijshme!

— Dëgjomë, e dashur! — tha Ankusha. — Ti je më e re se unë! Unë kam parë shumë! Mos më gjyko nga ajo fatkeqësi, që më ka ndodhur e që mund t'i ndodhë kujtdo! Një fatkeqësi që po ti... a nuk do të ta tregoj?..

— Jo! — tha Drita.

— Falemnderit! Se ka ca, që kërkojnë të gërmojnë e përzihen në punët e brendshme të të tjerëve. Në ndjenjat. A mund të përzihesh në ndjenjat? Thuaj edhe ti! Jo, ë?...

— Si ta kuptosh...

— Mos iu mërzit buzaçit! Është njeri qesharak! Edhe mua më vjen krupë kur e shikoj! Ne femrat e bukura si unë dhe ti, nuk e durojmë dot shëmtinë. Vetëm se buzaçi është i këndshëm në muhabet. Çdo femër e krahason me një kafshë të egër... Kush e di ç'nofskë do të të ngjitë edhe ty!

— Do ta ketë të përpjetë me mua! Nuk para i gëlltit unë këto — tha Drita.

— Ku ta dish? Sot thua kështu, nesër ndryshe! Mësohesh! Motrat i quan «mace të lumi», se i kanë flokët si fije preshi, të ngitura pas kafkës, si macet e lagura. Vërtet, atyre nuk u shkojnë fare kështu!... — tha Ankusha. Sytë e butë u bënë ëndërrtarë, të largët, të çuditshëm.

— A e di se pse më thotë kunadhe mua? — pshëri-tiu. — «Ti je një femër e jashtëzakonshme» thotë. «Pylli ka lepurushë, ketrushë po kunadhe ka pak, sepse kunadhja është kafshë e rrallë, e shtrenjtë. Edhe fati yt është si i kunadhes. Të futën në një gropë, t'i mbyllën gjithë udhët e daljes dhe të lëshuan tym. Ti u verbove nga tymi, dole nga vrima dhe të futën në thes...» Kupton?

— E ngatërruar, siç mund ta pjellë një mendje e sëmurë. Mos ndofta do të thotë se ti je krijuar për një jetë tjetër, për gjetkë, dhe ke mbetur këtu në vrimë si kunadhja?

— Ç'thuia kështu? Ju punëtorët gjithshka do ta

lidhni me politikën! Ai e ka fjalën për martesën time fatkeqe! Ai njeri i mbrapshtë më verboi me tymin e tij si kunadhet...

— Kurse ti i ike nga thesi!...

— I ika!

— Ike apo të lëshoi vetë?

— Vetë? Ai edhe sot përgjërohet për mua, po kush i kthehet prapë matufit të drejtë?!

«Mirë të kam nuhatur unë që në krye» mendoi Drita. «Duhet prerë çdo lidhje me ty!»

I erdhën në majë të gjuhës njëmijë fjalë, që do ta prisnin një herë e mirë këtë njobje të rastit, por u pendua. Ç'do të mendonin për të të tjerët... gruaja e urtë e berberit, këpucari i sémurë, vajzat, fqinjët? Erdhi një grindavece që për një fletë presh e prishi menjëherë me të gjithë.

«Me këtë grua nuk më lidh asgjë...» mendoi.

«Por sot është herët. Duhet ta njojin edhe të tjerët, kështu si unë ...»

— Juve ju duhet një pasqyrë tualeti — dëgjoi zërin e Ankushës. — Nuk them se jeni pa gusto, por gjëja e parë tanë për ju është tualeti! Për këto punë këshillohuni me mua. Burrat s'i ke për gjë fare.

Dhe, si nuk mori asnje përgjegje, u mbështet në kornizën e derës dhe tha:

— Ika! Mbeta me këtë penjyar gjithë ditën..

* * *

Erdhi dimri. Besniku kish dy muaj në minierat e largëta dhe nuk kthehej më. Vetëmja, që në muajt e parë të martesës, Dritës i rëndoi fort në shpirt. Në fillim shkonte ditë të tëra nga nëna e saj, por edhe kështu mërzitez njëlloj.

Kur kthehej në dy dhomat e shtëpisë në rrugën «Bogdani», ajo i dukej çuditërisht e madhe, e errët, e zbrasët. Dhomat ishin të ftohta akull, sikur s'ishin ngrohur kurrë. Drita e kuptoi se shtëpia nuk do të ngro-

hej kurrë, po të mos flinte ajo vetë këtu. Edhe Besnikut nuk i pëlqente ky shtegtim i saj nga shtëpia e tyre në atë të nënës.

Në këto net vetëmie Ankusha deshi t'i bënte shoqëri, mirëpo Drita nuk ja zgjati. Dy-tri herë Ankusha, që kish dëshirë ta bënte mike gruan e re të shoferit, e ftoi në kinema, por ajo prapë nuk pranoi. Dhe Dritës iu duk sikur, më në fund, e ngriti murin midis saj dhe Ankushes.

Dukej sikur në shtëpinë e hallakatur nuk ndodhte asgjë. Si gjithnjë Timo Lolua lyente kokorithkat me brillantinë dhe i quante vajzat e këpuçarit mace të lumi, kurse asaj i ngjiti nofkën ketër. Por kjo nofkë s'pati jetë as dy ditë, sepse Drita ja përmblodhi një mbrëmje me fjalë të ashpra, saqë berberi zuri të belbëzonte si gagaç dhe iku i mërzitur jashtë, në kafene.

Si kaloi ndonjë muaj, Drita vuri re me shqetësim se të dy vajzat e këpuçarit e kishin trashur shoqërinë me Ankushën. Vajzat ishin të padjallëzuara, u pëlqente të ndiqnin modën. Ankusha dinte të rregullonte flokët. Ankusha dhe dy motrat shkuan disa herë në kinema.

Në fillim të dhjetorit Besniku u kthye për një javë. Nata kish qenë e ftohtë.

— Oh! Flihet mirë këtu — tha Besniku.

Ishte agim i thellë. Kishin një copë herë që ishin zgjuar. Zilja u cërriti në vesh dhe ai bëri të ngrihet.

— Rri edhe pak... — tha Drita. — Dhoma është e ftohtë!

Shoferi u fut në shtresat e ngrohta. Natën era kish vërvhëllyer e kish bredhur pa fre nëpër mazgallet dhe të çarat e çatisë. Një qepen i prishur përplasej pas një dërrase dhe bënte një zhurmë sikur godisnin me gurë një kazan. Ajo iu struk në gjoks, sikur deshi të thithë ngrohtësinë e trupit të tij. Ai binte erë benzinë. Po kjo erë kish filluar t'i dukej e këndshme.

— Pse është kaq ftohtë këtu? — tha ajo.

— Në një shtëpi, ku ndizet zjarri rrallë, gjithnjë është ftohtë. Kështu janë dhomat e hoteleve, që nuk

ngronen kurrë. Kurse për qytetin tonë të ftohtë zjarri
është si buka.

Ajo u mblodh kruspull dhe në faqe i hipi zjarrmia.
Po... ai kishte të drejtë, shtëpia e tyre e re po mbetej
e ftohtë, e harruar. Macja e bardhë që kishin marrë nga
nëna, se shtëpia ishte plot me minj, ishte dobësuar e bërë
legëtyrë se nuk e ushqente njeri.

— Sa kohë do të vazhdosh akoma në minierë? —
pyeti ajo me një zë të mekur.

— Deri në fund të vitit. U mërzite?

Ajo pshëretiu. Nuk donte t'i thosh të vërtetën.
Asaj i dukej sikur Besniku ishte i ashpër ndaj çdo ma-
llëngjimi a lëbrente të ndarjes, i dukej sikur të gjitha
këto, përpara punës së tij, ishin cikërrima. Mirëpo nuk
ishte kështu. Edhe ai e ndjente fort ndarjen nga gru-
aja. Vetëmja e saj në ato net të ftohta, kur kthehej
nga turni në dhomën e ftohtë e të hallakatur, e ndiqte
pas nëpër rrugët e vështira të minierës. Dhe një men-
dim tërë drithërimë i përshkontë trupin: «Sikur të ke-
mi një fëmijë... Një frymë tjetër të ngrohtë pranë shtra-
tit! Sa më parë një fëmijë...» Kur kthehej, e vësh-
tronë të shoqen në sy, thellë dhe vështrimi i tij ish i
çuditshëm. Dhe i vinte inat që ajo nuk i thoshte asgjë.

Në dritare u duk qelli i turbullt i dhjetorit. Llam-
ba e vogël në shtyllë vazhdonte të digjej me atë qetë-
sinë e vet monotone, të patrazuar, të digjej gjithë natën
për rrugën, për qepenet, për tabelat, për mazgallet, nën
strehët e çatisë. Tërë natën, ajo hidhte një fashë të
bardhë drite deri në këmbët e shtratit të tyre.

— Mos ki frikë — tha burri. — As kur je vetëm
dhomë, as kur kthehesh natën nga puna. Mos ki frikë...

— Nuk kam frikë. Nga puna kthehem me shoqet. Kur-
se këtu prej kujt të kesh frikë? Veç shtëpia më duket
shumë e madhe, e zbruzur. Natën mezi më zë gjumi.

— Kur të kemi një fëmijë — pëshpëriti ai, — atë-
here...

— Kush do ta mbajë fëmijën netve?

— Hm.. — tha burri. — Atëhere, ndofta drejtoria

do të më vërë në linja të tjera ose... Le të kemi fëmijë një herë, pa do të bëjmë si të bëjmë.

— Do të kemi edhe fëmijë — pëshpëriti Drita.

— Vërtet? —

Shtrati kërciti sikur do të thyhej. Ai e mbështollë me krahi. I mori fytyrën e zeshkët në mes të pëllëmbëve dhe e vështroi në bebet e syrit. Dhe, në bebëzat e saj, pa fytyrën e vet me pushin e dendur të q'm'vë, që i ishin rritur gjatë natës. Dhe ajo fytyrë që shihte në bebëza, iu duk e çuditshme, sikur s'ishte e tij, po e dikujt tjetër, e një njeriu të hutuar nga lumtëria.

«Baba!»

— Mos — tha ajo. — Ma more frymën. Dëgjo të të tregoj pér këta...

— Léri mënjanë të tjerët. Tregomë pér vete.

— Mua më shqetëson shoqëria e vajzave të këpucarit me Ankushën. Seç ka filluar të bëjë vizita edhe një djalë i gjatë, i verdhë, me një manjetofon. Seç mblidhen ca tipa! Nja dy-tri vajza, berberi, dëgjojnë muzikë. Një herë shkuan edhe vajzat.

— Ç'kërkojnë ato?

— Nuk e di — tha ajo. — Në dhomën tonë dëgjohen të gjitha. Unë atëhere isha e mërzitur. Ti kishe një muaj që s'kishe ardhur. Dhe erdhi manjetofoni me zhurmat dhe me zëret e tyre si nga një thellësirë! Nuk e di se sa u mërzita!

— Pastaj?

— Vallëuan!

— Po vajzat?

— Edhe ato! Unë i qortova, po më duket se u zemëruan. Thoshin se në këtë mes nuk kishte asgjë të keqe.

— Po!... — tha Besniku. — Ajo jetë qejfesh i tërheq shumë! Ankusha dhe miqtë e saj janë batakë, ujë që ka ndenjur shumë kohë në vend dhe tanë qelbet! Po nganjëherë kur e pi, ky ujë duket i ëmbël! Kupton?

— Unë shqetësohem vetëm pér vajzat. Ato janë të reja. Kjo muzikë, kërcimet i tërheqin shumë.

— Ti duhet t'i bësh me vete vajzat. Të mos i lësh

të futen në këtë batak. Ç'punë kanë ato me një grua si Ankusha?

— Atëhere me siguri do të kërcasë sherri me këta!

— Le të kërcasë!

— A është mirë kështu, që në fillim? — pyeti ajo.

— Po!

Jashtë u shua llamba e elektrikut. Dita e re hyri në-për dritare. Ajri i dhomës ishte i thatë nga furnella elektrike, që kishte ndërtuar Besniku. Ai u ngrit, veshi rrobat e punës.

— Prit të të bëj një kafe!

— Jo! Mos u ngre. Do ta bëj vetë — pëshpëriti ai.

— Po më urdhëron kështu?

— Po... sepse... ti e di...

Gruaja qeshi dhe u shtrit në krahun tjetër. U ndie zhuzhurima e xhezves, që po vlonte. Burri u aviti me majat e këmbëve, u përkul mbi shtrat dhe i pëshpëriti:

— Ki kujdes atë.

Pastaj u dëgjua dera, që kërciti. Era e tij kishte mbetur ende në shtrat. Ajo shikoi orën. Hapi dritaren... Në korridor u dëgjua zëri i Ankushës:

— Mirë mëngjezi, Besnik!

— Mirë mëngjezi! — tha ai me një zë të ngjirur.

— Përsëri po ikni për një kohë të gjatë?

— Po.

— Punë e zorshme kjo jotja.... e keqe...

— Keq është vetëm kur je pa punë!

— A mund t'ju lutem për diçka të vogël?

— Cfarë?

— Shihni nëpër dyqanet, ku shkoni ju, për një të kuq buzësh çiklamin. Mbajeni mend! çiklamin! Dhe merrini edhe gruas suaj një të kuq 17 fraksion 3! Zeshkaneve u shkón shumë kjo ngjyrë, megjithëse thonë, që gjoja qenka për bionde! Po në këtë rast bukurinë e krijon kontrasti!

— Unë punoj nëpër miniera. S'ma merr mendja të ketë nëpër dyqanet e tyre të tilla gjëra! Ditën e mirë!

Mbi çatitë e murme të lagjes u gdhi një ditë cingërimë. Tjegullat zbardhnin nga bryma e natës dhe oxhakët nisën të tymonin. Drita doli në rrugicë. Grilat e vjetra të dritareve të këpuçarit rënkuani dhe prapa xhameve u duk ftyra e verdhë, e sëmurë e plakut.

— Mirë mëngjezi! — thirri Drita. — Thuaju vajzave se po i pres në rrugë. — Plaku tundi kokën dhe hapi dritaren.

Motrat i ngjanin shumë njëra-tjetrës, sikur të ishin binjake. Vajzat dolën nga shtëpia. E vogla, Ana, i kishte fryrë flokët si grua, kurse e madhja, Teuta, i kishte si më parë.

— E dini? — gugurisi Ana. — Buzaçi vetëm Teutës i tha sot «mace e lumi!»

— Po ty nuk të tha asgjë?

— Jo!... Vetëm se qeshë si budalla!

— Duhet të të thoshte luaneshë. I paske bërë flokët si krifë!

— E dini? M'i rregulloi Ankusha kështu! Kurse kjo nuk do! — tha Ana.

— A ju pëlqen të rrini me Ankushën?

— Shumë! E dini? Ajo është grua interesante!

— E ç'gjë interesante ka? — kundërshtoi Teuta. —

Ne kemi shkuar ndonjëherë në kinema me të sepse jemi vetëm.

— Jo! — tha Ana. — Tek ajo gjithshka është interesante. Edhe shoqëria, edhe barcoletat që tregojnë, edhe muzika! E dini? Ajo vetë ka një zë të mrekullueshmë! E ke dëgjuar? Dhe e shoqëron me kitarë ai djali.

— Ai verdhacuqi?

— Jo! Ai ka manjetofonin. Agroni i kitarës është ai me flokë të gjatë!

— Dhe ju pëlqen një shoqëri e tillë, një jetë e tillë, vajza? — pyeti Drita.

— Nuk e di! Mua më duket interesante. Sidomos ai manjetofoni.

— Dhe do të të pëlqente t'i ngjaje Ankushës?

— Kurrë! — tha Teuta.

— Ç'zili t'i kesh fatit të saj të mjerë? — tha Ana.

— Po që është interesante, është! S'kam si të them jo!

— Dëgjoni, vajza! Mua s'më pëlqen as Ankusha, as miqtë e saj, as këngët e tyre, as mbrëmjet e saj. Ju nuk duhet të përziheni me të!...

— Ndofta ashtu duhet! pëshpërithi Teuta.

— Ama edhe ti! Ke parë ndonjë gjë të keqe? Mbli-dhemi, këndojojmë, dëgjojmë manjetofonin! Sikur jemi të vogla ne! — tha Ana.

— Unë e di, në krye të gjitha të duken të këndshme, zbavitëse. Muzika të duket e bukur. Edhe shoqëria të duket interesante. Të duket sikur dehesh nga një pije e émbël! Po në themel, ama, të gjitha ato janë të vjetra, të huaja, të kalbura. Edhe morali i tyre është i huaj. Sikur Ankusha të ishte vetëm një grua e ndarë nga burri dhe për të cilën të kishte vetëm pëshpërityje, unë nuk do t'ju thesha pse shoqëroheni me të. Një fatkeqësi e tillë mund t'i ndodhë kujtdo. Po ja ta shohim një herë, cila është kjo Ankusha. Një grua afër të tridhjetave, vajza e një tre-gëtarë të vogël, paçka se ajo mburret që babai i saj s'qen-kej burgosur kurrë. Me të s'ju lidh as mosha, as shkolla, vetëm se banoni në një shtëpi. Ajo herë punon e herë nuk punon askund, si ti tekët. Juve ju rregullon flokët dhe ju thotë se kështu dukeni më të bukura. Dëgjoni këngë të huaja në manjetofonin e atij verdhacuqit dhe ajo ju thotë se tamam këto janë të bukura dhe asgjë tjetër. Ajo ju fut në botën e saj, që është shumë e vjetër. Juve ju duket sikur s'bëni asgjë të keqe, po s'është ashtu, se dalëngadalë, të gjitha këto do t'ju bëhen zakon, ves... Do të filloni të përbuzni punën, këngët tonë, modën tonë. Sot janë vetëm flokët dhe këngët, po nesër do të duash që të bëhesh një grua si Ankusha, që jetën ta shkosh gjithnjë si ajo, gjoja në mënyrë «interesante». Do të mendosh: «Eh! sikur të jetë e gjithëjeta kështu: manjetofoni... muzika... kërcimet... modal» Puna në një fabrikë do të të duket e rëndë si një mal. Kështu, si të thash, nga vajzë punëtori do të kthehesë në vajzë borgjezi!

— E dini? Kjo éshtë pér të qeshur. Se kërcyem një herë ose se ndërruam formën e flokëve dhe hop... u bëmë borgjeze!

— Unë tē kam thënë! Nuk duhet t'ja zgjatim kaq shumië Ankushës — tha Teuta.

— Po pse? Ç'kemi bërë ne, xhanëm? Asgjë. Asgjë fare! Unë s'kuptoj... Ti, Drita, e ke inat atë, po mos na detyroni ta kemi edhe ne!

— Unë s'kam asnje inat me tē. Mënyra e jetesës së saj éshtë e huaj pér mua, duke u nisur që nga fakti që éshtë një grua pa punë e më tej.

— Uh po vonohemi në shkollë! — dredhoi Ana. — A nxitojmë?

Vajzat u larguan me nxitim.

Në trotuarë nxitonin njerézit tē mbështjellë me shalle tē leshta. Kishin nisur cingërimat e djmrit.

«Nuk e binda dot» murmuriti e pakënaqur Drita. «Po... do tē ishte keq sikur vajzat tē lidheshin me Ankushën. Po sikur tē flas një herë me babanë e tyre plak? Ç'mendon ai vallë?

* *

Turni i dytë doli nga farbika. Netët e dhjetorit ishin tē ftohta. Mbi qytet lundronte një, mjegull e përhershme, që kish errësuar dritat e rrugëve.

«Sikur tē jetë kthyer Besniku dhe, kur tē hap dritën, ta shoh...» mendoi Drita.

Portieri plak pëshpëriti si gjithmonë nëpër buzë natën e mirë». Fabrika mbeti aty mbrapa shpinës, si një sop i bardhë dritash. Në asfaltin e lagur dridheshin reflekset e zbeta tē llambave. Kështu dridheshin edhe mendime tē papritura në kryet e saj.

Ai nuk ishte kthyer. Dhoma ishte si gjithnjë e madhe, e lartë, e ftohtë. Një e qeshur e largët, sikur rrukulliseshin enë prej porcelani, i vengoi si nga një thellësi prej dhomës së Ankushës. Pastaj tinguj kitare...

«Qenkan mbledhur prapë! Po motrat a kanë shkuar vallë?»

Ndezi zjarrin. Në derë u ndie një trokitje e lehtë.
Ajo nxitoi ta hapë. Ishte Teuta.

— U ktheve? — pyeti me ndrojtje.

— Po! — tha Drita.

— Unë tē prisja. Ana éshë marrosur fare. Babai nuk e lejoi, kurse ajo priti sa fjeti ai dhe iku.

— E qortoi babai?

— Po! Në fillim ai dukej sikur nuk bëhej merak pér shoqërinë tonë me Ankushën. Po, që kur i folët ju, e shikon punën ndryshe. Unë tē prita ty. Ndotta ty do tē tē dëgjojë po ta thérresim!

— Prit — tha Drita. — Do ta thérresim, po më vonë. Duhet t'i japim fund një herë e mirë tē gjithave... manjetofonit... ahengjeve...

— Ç'do tē bëjmë?

— Do tē hyjmë brenda. Do t'ua pérplasim, tē gjitha në fytyrë!...

→ Mos na nxjerrin jashtë! — pëshpëriti Teuta.

— Nuk do tē guxojnë. Ata kanë frikë. Kanë shumë frikë nga fjala jonë. Kur t'i shohë kështu Ana jonë, do t'i njohë më mirë.

Heshtën. Drita hapi dritaren. Muzika vërshoi në dhomë. Si një murmurimë e mërzitshme u dëgjua zëri i zvargur i verdhacuqit:

— Dëgjoni? Ky éshë kompleksi «Rolling stons», që do tē thotë «rrukullisësit e gurëve». Ç'kompleks, ë? Në Angli ky kompleks dhe «Bitëlls» shkojnë rrotë më rrotë.

— Ç'emra, 'ë?

— Mua më pëlqeijnë edhe «Gjigantët». E ke inçizuar këngën e tyre «Tema?» — tha një zë i hollë.

— Jo!. më ka shpëtuar.

Disa çaste bubulloj manjetofoni me ritme tē shpejta, ndezëse. Pastaj u dëgjua kërcitja e derës, që hapej dhe menjëherë shpërthyen britma e thirrje si në kor: «erdhi..! erdhi..!»

— Sonte, ty, buzaç, do tē inçizojmë që tē tē mbetet zëri i pavdekshëm — tha Ankusha.

— Si i Tom Xhonsit — tha verdhacuqi.

— Je e mirë, kunadhe — tha berberi.

- A iku gruaja? — pyeti zëri i hollë.
 — Shkoji të bëjë normën.
 — Dhe fëmijkat e gjorë fjetën, ë?
 — Fjetën..
 — I gjori buaza! Sa zili i ke moshës e jetës sonë.
 Ja, të shoh në sy se si u pikëllove!
 — E pse u pikëllova?
 — Se je pesëdhjetë vjeç dhe ke katër fëmijë!
 — Dyzet e dy, kunadhe!
 — Ha...ha...ha...
 — C'dëgjoni kështu? A nuk merrni kitarën të këndojmë! Unë s'i duroj dot këto zvingjet bërr...bërr...bërr...si një kor me derkucë!
 — I gjori! Zemra e shtyn të jetë me ne, mosha dhe mendja e mbajnë në vargonjtë e këngëve të vjetra! — tha Ankusha.
 — Ku janë gotat? Kështu më të thatë si cinxëri këndoni ju?
 — Ke sjellë gjë?
 — Posi! Dy shishe konjak!
 — S'thonë kot që je berberi më popullor i qytetit!
 — E dini? Mbi pasqyrë më kanë ngjitur një parullë:
 «Mos na prishni ndërgjegjen me anë të bakshishit».
 — Ha...ha...ha!..
 — Mirëpo, meqë unë e kam ndërgjegjen të prishur që në vezë, s'kanë c'më prishin më!
 Në dhomën tjetër, e shtrënguar pas supit të Dritës, Teuta pëshpëriti:
 — Do të hyjmë?
 — Prit...Unë i kam urrver ata që përgjojnë, po sonte ky përgjimështë i dobishëm!
 — Si nuk e dëgjova një herë zërin e Anës?
 — Cudi!
 Në dhomën matanë vunë përsëri manjetofonin. Kish te muzikë vallëzimi. U dëgjuan zhurmat e këmbëve, që përplaseshin në dysheme. Dyshemeja tundej. Mbi gjithë zërat ngrihej basi i berberit si një gjëmim i largët. Berberi po vinte më qejf.
 — Ç'bukuri, moj kunadhe, ç'bukuri! Këtu tek ti eshtë parajsa!

— Kurse ti je shën Pjetri me kyçet. Po të duash, i fut njerëzit këtu, po të mos duash, jashtë... në anën tjetër.

— Kujt do t'ja mbyllte më parë derën Timua?

— Gruas së vet! — tha zëri i hollë i panjohur.

— Ha...ha...ha...!

— Mos bëni shaka të trasha ju të tjerët, se do t'ju godas me shishe! — tha zëri i rreptë i berberit.

— As unë, buzaç?

— Ti je ndryshe, kunadhe!.. me ty kam konfidencë.

— Po fqinjën... zeshkanen... do ta ndaloje të hynëtë në parajssë?

— Po të ishte vetëm... nuk e ndaloja.

— Shët... mund të dëgjojë!

— E çë? Ne bëjmë shaka! E ndaluar është edhe shakaja?

Vallëzimi mbaroi. Tingëlluan akordet e kitarës, pastaj basi i berberit mbi zërat e tjerë. Vunë manjetofonin. Në të u dëgjua zëri i berberit.

— Bre! Kaq të trashë e kam zérin unë, apo e ke të prishur atë hallatin? — tha Timua.

— Si zë gomari e ke!

— Pusho ti, qurravec. Dhe preje atë copë, ku flasim pér gruan; preje, të thonë, ndryshe ta theva hallatin!

— Çfarë njeriu! — tha me zë të dredhur Teuta.

— Ç'të jetë? Një i shthurrur. Pér këta tipa në qytetin tonë kanë njënofkë. E di? I quajnë «legene».

— Pse?

— Ndofta sepse legeni mban mbi vete shumë ievvere të ndyra,

— Si e fyen ashtu gruan e vet?

— Është i poshtër... — tha Drita.

Kaloi një copë herë. Matanë zërat krijonin një gjurulldi të tillë, që s'merrei vesh kush këndonte e kush bërtiste. Ndjenjëherë plakoste një qetësi e çuditshme dhe mezi ndihej një pëshpëritje e çuçurisje sikur gudulisej njeri.

— Po ti, moj ftuje e xhaxhi Timos, pse s'pi një gotë?

— Nuk dua! — tha zëri i Anës.

- Vetëm njëzë! Për shëndetin e xhaxhi Timos.
 — Pije, Ana, se s'është farmak! — tha Ankusha.
 — Shkojmë — tha Drita me zë të lartë.
 Dolën nga dhoma.
 — Do të trokasësh? — pyeti Teuta.
 Drita s'foli. I mëshoi dorezës së derës. Dera u hap.
 Berberi, që kishte kthyer shpinën, tha:
 — Dëgjo: regjistroje në atë hallatin edhe këtë këngë:

« I shastitur jam
 nga dashuria,
 përqafime, të puthura
 me mall!»

Dhe këndoi me zë të trashë, të ngjirur.
 Të tjerët nuk iu përgjegjën dhe shikonin diku më
 habi.

— C'patët që u nemitët kështu? — tha berberi
 dhe u kthyte me rrëmbim nga dera. Ana, që rrinte mbi
 divan pranë djaloshit që i binte kitarës, u ngrit më kë-
 mbë, e kuqe flakë. Konjaku u derdh mbi divan. Në try-
 ezë dy shoqe të Ankushes u zgërdhinë me nga një bu-
 zëqeshje të shtirë. Njëra, shumë e shëmtuar, me dhë-
 mbë të dalë e të mëdhenj si prej kali dhe me sytë pa qe-
 palla, nga hutimi e rrëkelleu gjithë gotën në fyt dhe u
 mbyt nga kolla. Tjetra, e shkurtër, bullafiqe, s'qëndroi
 dot gjatë më këmbë dhe u përplas në karrigë, që kri-
 si nga pesha. Djaloshi në divan, me xhakavento të zezë,
 gërvishisti telat e kitarës me përtesë. Verdhacuqi, me ma-
 njetofonin pranë, e vështroi Dritën me kureshtje me
 dy sy të mjegulluar. Ngriti një baluke si të lëpirë viçi
 nga balli dhe mbylli manjetofonin. U krijua një heshtje
 e çuditshme, sikur dikush të kish rrëzuar e thyer të gjitha
 enët prej biluri të dollapit të vjetër. Vështrimet bri-
 dhnin mbi dy ftyrat në prak të derës. Drita ishte e zbe-
 të. Teuta prapa shpinës së saj i bënte së motrës ca she-
 shenja pa kuptim. I pari e mbledhi veten berberi.

— Oj...? Kush na erdhi! — tha me një zë të zgja-
 tur, sikur përkëdhelte një kotele. — Kush na erdhi...
 kush na erdhi... — përsëriti.

Ankusha u ngrit nga tryeza. Kish veshur po atë rrobë nate vishnjë, të ngjitur pas trupit saqë i duke-shin format e kolme të gjymtyrëve dhe të gjive.

— Po të kini dëshirë, mund të na urdhëroni në këtë mbrëmje të thjeshtë familjare... — pëshpëriti me zë të ulët, sikur e shtrëngonte diçka në fyt. Në sytë e saj lëvriu një çast një shpresë e vakur se mos, kushedi, sqinja e pashtuar zbutej dhe hynte. Pastaj vendin e shpresës e zuri një frikë e habitshme, siç ndodh kur presim të ngjasë me doemës diçka. Të tjerët ishin ngritur më këmbë. Vetëm djaloshi mbi divan, nga indiferenca ose nga hutimi, bënte akoma akorde të thejshta në kitarë duke u munduar të përshtatte për kitarë melodinë e një marshi, që ishte shumë i njojur ato ditë.

Dritës iu duk aq neveritëse kjo skenë hutimi, sa vuri buzën në gaz me tallje. Po berberi mori zemër nga kjo buzëqeshje e papritur dhe u afroa me hapa të shkurtër drejt derës; bëri një përkulje sikur përcillte një klient të zgjedhur dhe tha:

— Urdhëroni e na zbuluroni tryezën tonë të varfér!...

— Mjaft, njeri i pacipë. — tha Drita. — Ne s'kemi ardhur këtu për ty, po për Anën. Ajo nuk duhet të rrijë më në këtë strofkë të molepsur.

Timua mbeti një çast si i ngrirë, pastaj i kërceu damari i ballit dhe bërtiti.

— Kujt i thua i pacipë ti? Si guxon?

— Jo vetëm që guxoj të ta them ty, por do t'ua them edhe këtyre të tjerëve, këtu. Jeni mbledhur në këtë shtëpi si ato zhabat në ujë të qelbur dhe kuakni gjithë natën. Le që vetë jeni një grup i rrezikshëm, si një çiban, në shoqërinë tonë, po dashkeni të bëni me vete edhe Anën! Dhe të gjithë këta i mbledh ti... ti... iu drejtua Ankushës.

— Ju lutemi... — pëshpëriti vajza e shëmtuar.

— Qenki e paturp që ndërhyjni kaq brutalisht... — tha e trasha.

— Po... pëshpëriti Ankusha. — Ju, e dashur kini një farë të drejtë, se jeni kthyer e lodhur nga puna. Ta-

ni është mesnatë, doni qetësi, kurse ne për një çast e shkelëm me këngët tona dhe ju shqetësuam. Duhet të kën-donim më qetë. Le të bjerë i gjithë faji mbi mua dhe më falni, ju lutem.

— E shqetësojnë këngët tona? — tha djaloshi me kitarë, i zbetë e me flokë si femër. — Kur dal unë për serenatë rrugëve, hapen grilat e dritareve nga nostal-gjia! . . .

— Dëgjo ti, artist... — tha Drita. — Unë s'të njoh fare; ti je edhe i ri. Po mua më duket se duhet të he-qësh dorë nga të gjitha këto dhe të mos shkelësh më në këtë shtëpi, sa s'është vonë.

— U bë me spec kjo punë — tha djaloshi i manjetofonit. — Ikim, o Lulo?

— S'kuptoj, fqinjë e dashur, q'të keqe gjen ti në këtë mes. Pse përzihesh në punët e mia? Unë a të nga-tërroj në marrëdhënjet që ke ti me burrin? Jo. Atëhere?

— Përzihem, sepse je ti ajo që i mbledh këtu, sepse ti je shtrati, ku ka zënë vend ky ujë i qelbur.

— Moj, po q'e kujton veten ti? Prokurore apo kry- etare të këshillit të lagjes? — tha berberi.

— S'do të ishte keq të ishin edhe ata të lagjes e të dëgjonin q'dëgjojnë veshët e mia!

— Ç'dëgjojnë, ë? Dale se po na fut në thekra të gjata — tha berberi. — Po na fut në thekra të gjata dhe nuk do dalëm dot pastaj se ju kështu jeni të gjitha, leshgjata e mendjeshkurtëra! Ne, përvëç një ahengu të vogël... veç këngëve, s'bëmë asgjë tjetër!

— Lulo, ikim! — tha verdhacuku. — U bë me spec kjo punë!

— Rri, mor, aty, qurro! Jo spec, jo patëllxhan, seç na llomotit aty! — tha berberi. E tërë puna është se Dritës iu prish rehati i vet, ja ku është!

— Nga këto këngë të neveritshme që këndon ti, edhe të prishet!

— Oj! Dëgjoje ç'thotë! Muzikës sonë i thotë e ne-veritshme! Po kur s'merr vesh njeriu ç'pret? — tha e trasha.

— Singerisht, e dashur Dritë, ju u shqetësuat kot.

Ne s'bëjmë asgjë të keqe. Buzaçi bën ngandonjë shaka të trashë, po ju ja dini hyqin. Mund të pyesni edhe Anën. Apo jo, Ana?

— Ana s'ka pér të shkelur më këtu tek ti. Edhe unë jam penduar që kam ardhur ... — tha Teuta.

— Si të doni! Kush ju detyron? Ju duket interesante, siç thoshit më parë, ejani; nuk doni prapë mirë. Unë vetë s'ndërhyj në punët e tjetrit si Drita. Ajo po. Ju mëson, ju edukon! Kush i thotë mos bëj kështu? Unë? Jo!

— Ti e ke gojën brisk dhe mund ta vërtitësh ashtu që e zeza të duket e bardhë, po mua nuk ma tregon dot ti të bardhën e të zezën! Në një vend si ky, në një shoqëri si kjo, unë do t'i ndaloj vajzat të shkelin. Do të bëj të pamundurën. Nuk do t'i lë edhe ato të futen në atë batak, ku je kredhur ti me gjithë shoqërinë tënde të qelbur. Ta dish! Nuk do ti lë.

— Oj! Të folur!

— Ç'na bëre ti ne? Zhaba? Ke një orë aty, jo bataku, jo kështu, jo ashtu! — tha Timua. — Në do të rrish, mirë, në mos po kthe krahët se s'kemi nevojë pér konferanca. E dimë kufirin ne! Pse, nuk e di unë që imperialistët dhe revisionistët janë të poshtër?

— T'i kam numëruar njëherë të gjitha ty! — tha Drita. — E ke mësuar mirë zantin e të shtirurit, s'kam ç'të them. Po unë erdha pér Anën. Ajo s'duhet të vinte këtu. Edhe ju të tjerët, megjithëse s'ju njoh, do të bënët mirë të hiqnit dorë nga këto ... nga kjo grua, nga mbrëmjet e saj të vogla.


— Ah! Ja, tani po e zbuloni veten — tha Ankusha. Buzët ju holluan, ju futën brenda. — Unë e di se pér të gjitha ju shtyn një ndjenjë tjetër: xhelozia! Jeni xhelozë pér burrin tuaj, që më shikon me bishtin e syrit dhe me buzëqesh! — dhe me një lëvizje të hijshme të kokës, i derdhi mbrapa shpine flokët e verdhë, të gjatë.

— E dija që je e poshtër! — tha Drita. — Po ti nuk ke fuqi ta përlyesh dashurinë time me Besnikun! Eja, Anë!

Ana doli kokëulur. Drita tërroqi me forcë dorezën e derës. Në dhomë ra heshtje. Drita u ngjit me të dy motrat

në katin e tretë. Pastaj zbriti shkallët. Nuk kuptohet në kishin iku apo jo miqtë e Ankushës, po në shtëpinë e vjetër kish rënë një qetësi e thellë, si qetësia pas bubullimave. U dëgjuan hapa në korridor, ca pëshpëritje dhe, më në fund, në dhomën fqinjë u ndjenë vetëm zërat e berberit dhe të Ankushës, që dukej sikur grindeshin për diçka. Dera u përplas. Në korridor kërciti çakmaku i Timos, zhurma e këmbëve të tij në shkallët, pastaj asgjë. Shtëpia e heshtur u kredh në natën e gjatë të dimrit.

Drita u shtri në shtrat. Shikoi orën. Ishte shumë vonë dhe dhoma ishte ftohur. Ndezi furnellën dhe shoi dritën. Ngërroga nëpër dritaren e gjerë hyri drita e bardhë e llambës, që vazhdonte të digjej për rrugicën, për mazgallat, për shtëpinë...



PASQYRA E LËNDËS

	Faqe
Mësuesi i vjetër i historisë	3
Pikojnë kokrrat e krimbura	26
«Kontrabandisti»	39
Një natë shiu	54
Ndërruesi i çative	64
Zbritja në bazë	70
Ushtari kthehet me leje	83
Hapat e fundit të «Shtërgut»	95
Rritësit e derrave	107
Lulishtja mbi varreza	112
Zëra në mjegull	124
Punëtori i xhadesë malore	135
Gërmadha.	143
Ujërat e ndenjura	160